



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/
AGENCY FOR GENDER EQUALITY

PROGRAMI I KOSOVËS PËR BARAZI GJINORE 2020-2024

Qershor 2020



**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government**

ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/
AGENCY FOR GENDER EQUALITY

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 dhe Plani i Veprimit

Qershor 2020

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 është hartuar në mbështetje të nismës së Agjencisë për Barazi Gjinore dhe në zbatim të Projektit “Forcimi institucional i Agjencisë për Barazi Gjinore dhe mekanizmave gjinor në Kosovë” financuar nga Qeveria Suedeze, Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar –Sida dhe zbatuar nga konsorciumi : Niras & CPM Internacional



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/34
 Datë: 23.05.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024.
2. Obligohen institucionet e Republikës së Kosovës të zbatojnë Programin nga pika 1. e këtij vendimi sipas aktiviteteve të parapara në planin e veprimt dhe në përputhje me fushat e veta të zbatimit.
3. Obligohet Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të monitoron zbatimin e tij, si dhe të raporton çdo vit tek Qeveria për zbatimin e tij.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Albin Kurti

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT// OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA
 AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/
 AGENCY OF GENDER EQUALITY

Të nderuar/a qytetarë/e

Në zbatim të Ligjit për Barazi Gjinore- Nenit 11, Qeveria e Republikës së Kosovës ka hartuar dhe miratuar Programin e Kosovës për Barazi Gjinore PKBGJ 2020 -2024 me vendimin Nr.01/34¹, nën udhëheqjen e Agjencisë për Barazi Gjinore – Zyra e Kryeministrit. Programi i parë i Kosovës për Barazi Gjinore u hartua nga ABGJ dhe miratuar nga Qeveria në periudhën kohore 2008-2013, dhe vlerësimi i zbatimit të tij² në vitin 2017-të i shërbeu ABGJ-se, ministrive të linjës, komunave, shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë, si dokument orientues për hartimin e Programit të ri.

PKBGJ është dokument ombrellë i planifikimit të veprimeve institucionale, sektorit publik dhe privat, i cili duhet të shërbejë si platformë referuese për ndërmarrjen e veprimeve të përcjella me alokimin e fondeve buxhetore të mjaftueshme për integrim të perspektivës gjinore në politikë -bërje, si një proces i kompleks, i domosdoshëm që ka për qëllim përmirësimin e jetës së vajzave dhe grave, djemve dhe burrave në Kosovë.

Procesi i hartimit të PKBGJ –së si dokument strategjik paraqet një model të veçantë, ku i tërë procesi i hartimit është realizuar me metodologji moderne të miratuar nga këshilli drejtues, një proces model gjithëpërfshirës dhe i paraprirë nga analiza sektoriale dhe ndër-sektoriale. Fillimisht është hartuar dokumenti i analizës së situatës për tre fushat relevante dhe janë realizuar 11 punëtori dy ditore me grupe punuese, ku morën pjesë rreth 370-të pjesëmarrës, afër 40-të institucione, organizata jo qeveritare, organizata donatore, partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë, si dhe ofruan komentet në dokumentin final të prezantuar për diskutim publik.

PKBGJ ka tre shtylla : **a) Fuqizimi ekonomik dhe mirëqenia sociale b) Zhvillimi njerëzor, rolet dhe marrëdhëniet gjinore, c) Të drejtat e grave, qasja në drejtësi dhe siguri.** Programi përfshin qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm që kanë të bëjnë me gjininë dhe janë integruar 40 indikatorët gjinorë të SDG-ve në objektivat dhe aktivitetet e programit të propozuar. Programi identifikon një vizion kombëtar, qëllimet dhe objektivat, dhe planin përkatës të veprimit, përfshirë përgjegjësitë, burimet dhe afatet kohore për aktivitetet relevante për avancimin e parimeve të

¹ Të datës 23.05.2020

² Vlerësimi i mbështetur nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar – SIDA, përmes projektit "Fuqizimi Institucional i Agjencisë për Barazi Gjinore dhe Mekanizmave Gjinorë në RKS" dhe i zbatuar përmes projektit të asistencës teknike NIRAS-CPM International

barazisë gjinore, përmbushjen e të drejtave të grave dhe arritjen e një shoqërie paqësore, të begatë dhe harmonike për gratë dhe burrat në Kosovë. Objektivat e parapara në këtë dokument janë udhërrëfyes në drejtim të zbatimit të Kornizës ligjore të RKS-së që garanton barazinë gjinore, në frymën e Konventës për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave – CEDAW e zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kosovë si dhe instrumenteve kryesore ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave si :Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa e të Drejtave Politike të Grave; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore ; Rezoluta 1325 dhe 1820 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi Paqen dhe Sigurinë e Grave dhe Dhunën ndaj Grave, etj.

Plani i veprimit synon të zbatojë integritetin gjinor në kornizat e politikave publike për të adresuar 'feminizimin e varfërisë' i cili si një koncept shumë i ndërlikuar është marrë parasysh gjatë analizës së situatës në kontekstin e Kosovës, ku edhe varfëria edhe paragjykimet gjinore janë të shumëllojshme dhe të rrënjësura thellë dhe i mbajnë gratë dhe vajzat larg zhvillimit. Varfëria e feminizuar është rritja në nivelet e varfërisë në mesin e grave dhe burrave. Rritja e pabarazive gjinore është si përcaktues të varfërisë, që karakterizonte një feminizim të shkaqeve të varfërisë, pasi që gratë dhe vajzat vazhdojnë të mos marrin pjesë në tregun e punës, nuk trashëgojnë, nuk përfitojnë njëjtë si burrat nga burimet financiare, dhe shërbimet e tjera në të mirë të mirëqenies sociale, qasjes në drejtësi, shërbime dhe pjesëmarrje të barabartë në vendimmarrje në jetën politike, publike, private sociale dhe kulturore . PKBGJ-ja e miratuar adreson të gjitha këto probleme të identifikuara tek analiza e situatës, dhe të cilat u adresuan në objektivat specifike dhe aktivitete përkatese.

Ky program paraqet dokumentin strategjik udhërrëfyes për orientimin e ndihmës dhe përkrahjes së donatorëve dhe partnerëve ndërkombëtarë në adresimin e mbështetjes së agjendës së barazisë gjinore në Kosovë.

Falënderojmë Qeverinë Suedeze/ Agjencinë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar- Sida për mbështetjen e jashtëzakonshme gjatë tërë procesit të hartimit të PKBGJ-së, për ndihmën e pa kursyer përmes grantit të drejtpërdrejtë për ABGJ-në. Po ashtu shprehim mirënjohjen për mbështetjen e Sidas, përmes projektit të asistencës teknike për ABGJ, të zbatuar nga "Konzorciumi NIRAS – CPM International"³, dhe udhëheqësen e projektit e cila ofroi metodologjinë, ekspertizën dhe asistencën profesionale gjatë tërë procesit .

Falënderojmë anëtarët/et e këshillit drejtues, të grupeve punuese, dhe të gjithë/a pjesëmarrësit/et në diskutime që me kontributin e tyre ndihmuan të kemi një program që përmes agjendës së barazisë gjinore sjellë në qendër të vëmendjes mirëqenien e grave dhe burrave në Kosovë.

Me respekt!
Edi Gusia
Kryeshefe Ekzekutive
Agjencia për Barazi Gjinore / Zyra e Kryeministrit

³ Projekti i Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar – SIDA, "Fuqizimi Institucional i Agjencisë për Barazi Gjinore dhe Mekanizmave Gjinorë në RKS" dhe i zbatuar përmes projektit të asistencës teknike NIRAS-CPM International

Përmbajtja

ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA

1. HYRJE.....	13
2. Metodologjia.....	15
3. Sfondi	19
SHTYLLA I: Fuqizimi ekonomik dhe mirëqenia sociale.....	19
SHTYLLA II: Zhvillimi Njerëzor, Rolet dhe Marrëdhëniet Gjinore.....	27
SHTYLLA III: Të Drejtat e Grave, Qasja në Drejtësi dhe Siguria	45
4. Objektivat e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore PKBGJ	56
5. Aranzhimet e zbatimit, monitorimit dhe raportimit:.....	65
6. Ndikimi buxhetor dhe zbatimi i PKBGJ-së	67
Referencat.....	68
Shtojcat.....	71
Shtojca 1: Vendimi i Qeverisë për emërimin e Komisionit Qendror dhe grupeve punuese për hartimin e PKBGJ-së	71
Shtojca 2: Plani i Veprimit për zbatimin e PKBGJ-së 2020-2022.....	75
Plani i veprimit: PKBGJ 2020-2022	76

Lista e tabelave

Tabela 1: Konsultimet gjatë procesit të hartimit të PKBGJ-së.....	17
Tabela 2: Shkalla e varfërisë në konsum në Kosovë, 2012-2015	19
Tabela 3: Shkalla e varfërisë, sipas gjinisë së kryefamiljarit: 2012-2015.....	19
Tabela 4: Treguesit e tregut të punës, 2017-Tremujori 2	20
Tabela 5: Treguesit e tregut të punës, 2012-2018	20
Tabela 6. Numri i institucioneve edukative-arsimore publike në Kosovë	29
Tabela 7. Lindjet sipas moshës dhe përkatësisë etnike në lindjen e parë, 2016	37
Tabela 8. Punëtorët e Radiotelevizionit të Kosovës sipas gjinisë për vitin 2014.....	42
Tabela 9 : Përfaqësimi në sistemin gjyqësor.....	49
Tabela 10: Kostoja e Planit të Veprimit për periudhën 2020-2022, në mijëra (000) Euro.....	67

Lista e figurave

Figura 1. Struktura gjinore e mësimdhënësve sipas niveleve në arsimin publik dhe privat 2015/2016 ...	28
Figura 2. Orientimi i studentëve në fusha të studimit sipas gjinisë 2014/2015.....	30
Figura 3. Shpenzimet për shëndetësi të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2014-2016, në Euro.....	35

Lista e shkurtesave

ABEF	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare
ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
AGK	Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
AP	Avokati i Popullit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPGJ	Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
IEBGJ	Instituti Evropian për Barazi Gjinore
IGjK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
KNKDHF	Koordinatori Nacional Kundër Dhunës në Familje
KPK	Kodi Penal i Kosovës
KPM	Komisioni i Pavarur për Media
LBGJ	Ligji për Barazi Gjinore
LGBT	Lesbikë, Gej, Biseksualë, Transgjinorë
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHt	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MATP	Masat Aktive të Tregut të Punës
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MIN	Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MM	Ministria e Mbrojtjes
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PK	Policia e Kosovës
PKBGJ	Programi i Kosovës për Barazi Gjinore
PSV	Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje
QAP	Qendrat e Aftësimit Profesional
QPS	Qendrat për Punë Sociale
RrGGK	Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës
ShC	Shoqëria Civile
ShKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
SIDA	Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim
SILC	Anketa e të Ardhurave dhe Kushteve të Jetesës
UN Women	Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizim të Grave
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

UNFPA	Fondi për Popullsi i Kombeve të Bashkuara
ZBGj	Zyrtari/ja për Barazi Gjinore
ZKM	Zyra e Kryeministrit të Kosovës
ZMNV	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave
ZPS	Zyra për Planifikim Strategjik-ZKM

Përmbledhje ekzekutive

Barazia gjinore është një e drejtë themelore dhe faktorë i rëndësishëm për rritje ekonomike, zhvillim dhe stabilitet. Barazia gjinore është një parim fundamental në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Përkushtimi për barazi gjinore thekson domosdoshmërinë për zhvillimin dhe zbatimin e politikave, përmes strategjive dhe programeve, kornizës ligjore, dhe ofrimin e të mirave dhe shërbimeve për të arritur qëllimin e përcaktuar për barazi gjinore.

Hartimi i Programit të Kosovës për Barazi Gjinore është obligim i përcaktuar në Ligjin për Barazi Gjinore 05/L-020. Specifikisht, Neni 11, obligon Agjencinë për Barazi Gjinore të bashkërendojë përgatitjen e Programit, të monitorojë zbatimin e tij, si dhe të raportojë çdo vit tek Qeveria për zbatimin e tij. Ky Nen po ashtu përcakton që Qeveria shqyrton dhe miraton Programin e Kosovës për Barazi Gjinore dhe raporton çdo vit në Kuvend për zbatimin e tij, dhe këto raporte bëhen publike. Programi i parë për Barazinë Gjinore në Kosovë ishte 2008-2013.

Qeveria e Republikës së Kosovës në programin e vet qeverisës 2020-2023 ndërlidhet me Programin e Kosovës për Barazi Gjinore si platformë e avancimit të barazisë gjinore në Kosovë, instrument i koordinimit të ndihmës në zhvillim, dhe si reflektim indikatorëve për zhvillim të qëndrueshëm

Program i Kosovës për Barazi Gjinore synon të sigurojë që barazia gjinore është në qendër të proceseve transformuese në Kosovë, në kuadër të të gjitha strukturave, institucioneve, politikave, procedurave, praktikave dhe programeve të qeverisë, agjencive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit të donatorëve. Ky Program është pesëvjeçar, përfshin periudhën 2020-2024, ndërsa Plani i Veprimit është hartuar për periudhën 2020-2023. Programi dhe Plani i Veprimit janë hartuar në përputhje me Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit dhe sipas. Programi është i organizuar në 3 shtylla strategjike Fuqizimi Ekonomik dhe Mirëqenia Sociale; Zhvillimi Njerëzor, Rolet dhe Marrëdhëniet Gjinore; dhe, të Drejtat e Grave, Qasja në Drejtësi dhe Siguria. Bazuar në analizën e gjendjes aktuale në Kosovë, problemi kryesor në shtyllën e Fuqizimit Ekonomik dhe Mirëqenies Sociale është prania e pabarazive dhe përjashtimi socio-ekonomiko-strukturo. Faktorët kryesorë që ndikojnë në këtë problem janë: mungesa e integritetit gjinor në strategji dhe politikat zhvillimore; mos zbatimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor; diskriminimi në punësim; niveli i ulët i shkollimit të grave në moshë pune (15-64); ndarja e profesioneve gjinore; ndarja e pabarabartë e obligimeve për përkujdesjen e fëmijëve dhe të moshuarve; pjesëmarrje e ulët e grave në menaxhimin e burimeve; mungesa e institucioneve për përkujdesjen e fëmijëve; dhe qasja e kufizuar në të drejtat pronësore dhe financa.

Problemi kryesor në fushën *Zhvillimi Njerëzor, Rolet dhe Marrëdhëniet Gjinore*, qëndron te pabarazia dhe përjashtimi struktural në arsim, shëndetësi dhe media, dhe mos shfrytëzimi adekuat i kapaciteteve njerëzore në fusha të ndryshme të jetës socio-kulturore dhe institucionale. Sfidat kryesore në sistemi arsimor janë qasja, mundësitë dhe shfrytëzimi i pabarabartë në vija gjinore në planifikim, menaxhim dhe financim të sistemit arsimor; diskriminimi gjinor në punësim dhe avancimin profesional dhe akademik; prania e stereotipeve gjinore mbi ndarjen e punës. Në fushën e shëndetësisë sfidat kryesore mbeten: mungesa e protokolleve dhe të dhënave për t'i identifikuar nevojat e veçanta të vajzave dhe grave; vajzat dhe gratë janë të diskriminuara sa i përket lirisë së vendimeve mbi planifikimin familjar, seksin dhe trupin e tyre në përgjithësi; mungesa e ndërgjegjësimit, qasja jo-profesionale e punëtorëve shëndetësor, dhe mungesa e infrastrukturës dhe kapaciteteve njerëzore kontribuojnë në brishtësinë e shëndetit riprodhues; ofrimi i mangët i shërbimeve perinatale dhe neonatale, por edhe i edukimit seksual dhe këshillimit për planifikim familjar; Skriningu për HPV nuk trajtohet nga Strategjia Sektoriale për Shëndetësi përkundër nevojës së evidentuar. Në fushën e medias, sfidat kryesore janë: mungesa e indikatorëve gjinor të cilët do të mundësonin monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të LBGJ dhe Ligjit Kundër Diskriminimit në RTK; mungesa

e politikave dhe rregulloreve të cilat do ta trajtonin diskriminimin gjinor, siguronin diversitet dhe mundësonin zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore; rrezikshmëria e ushtrimit të profesionit të gazetarisë nga ana e vajzave dhe grave; dhe mungesa e plotë të legjislacionit për mediat e reja.

Problemi kryesor për *Sigurimin e të Drejtave të Grave, Qasja në Drejtësi dhe Siguria* është qasja e brishtë në realizimin e të drejtave e cila pamundëson arritjen e barazisë gjinore. Sfidat kryesore në kuadër të kësaj fushe janë pjesëmarrja e kufizuar e grave në sektorin e sigurisë dhe drejtësisë në Kosovë; pjesëmarrje e ulët e grave në pozita vendimmarrëse; zbatueshmëria e dobët e sanksioneve dhe mungesa e zbatimit dhe numri i vogël i ankesave lidhur me raportimin e rasteve të diskriminimit në gjykatat e Kosovës; toleranca e dhunës si mënyrë e disiplinimit apo rritjes së fëmijëve apo kontrollit dhe mbajtjes së grave në pozitën e tyre shoqërore; raportim i kufizuar i dhunës seksuale, duke përfshi dhunimin, i cili ndodh brenda apo jashtë familjes; mungesa e një mekanizmi përcjellës për monitorimin e rasteve të dhunës në baza gjinore; shtyrja në zbatimin dhe lëshimin e urdhrave mbrojtës në rastet e dhunës në familje si dhe shqiptimi i dënimeve të ulëta nga ana e gjykatave ose kultura e mos-dënimit të rasteve të tilla fare; mungesa e programeve për trajtimin psiko-social të dhunuesve; dhe ri integrimi të viktimave të dhunës në familje.

Objektivi i përgjithshëm strategjik i Programit të Kosovës për Barazi Gjinore është të sigurojë që barazia gjinore të jete në qendër të proceseve transformuese në Kosovë, në kuadër të të gjitha strukturave, institucioneve, politikave, procedurave, praktikave dhe programeve të qeverisë, agjencive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit të donatorëve. Ky objektivi do të arrihet duke punuar në këto tri drejtime:

- Krijimin e mundësive të barabarta për të kontribuar dhe përfituar në /nga zhvillimi ekonomik, rritjen e gjithë përfshirjes dhe përmirësimin e mirëqenies sociale;
- Avancimin e barazisë gjinore, përmes arsimit dhe shëndetësisë cilësore, gjithë përfshirjes, dhe shfrytëzimit të kapaciteteve njerëzore si kontribuues në zhvillimin e qëndrueshëm njerëzor dhe zhdukjen e pabarazive dhe stereotipeve gjinore;
- Avancimin e realizimit të të drejtave në vendimmarrje, paqe, siguri dhe drejtësi garantues i arritjes së barazisë gjinore.

Për zbatimin e PKBGJ-së është hartuar plani trevjeçar i veprimit, ku janë përcaktuar masat e hollësishme që kërkohen për të arritur objektivat, orarin e tyre si dhe kërkesat e financimit të aktiviteteve.

Veprimet kryesore për të adresuar problemet e identifikuara në këtë dokument, sipas objektivave strategjike janë si në vijim:

Objektivi Strategjik 1: Krijimi i mundësive të barabarta për të kontribuar dhe përfituar në /nga zhvillimi ekonomik, rritjen e gjithë përfshirjes dhe përmirësimin e mirëqenies sociale, do të arrihet përmes: ngritjes së shkathtësisë të grave, në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke u fokusuar edhe në fushat deficitare adresimin e diskriminimit në baza gjinore në punësim, përmes ndryshimit të Ligjit të Punës, për të garantuar pushimin të barabartë prindëror dhe Direktivat e BE-së; ofrimin e qasjes së barabartë në shërbime sociale dhe familjare cilësore, qendra rezidenciale për përkujdesje ditore për të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara, duke lehtësuar kështu mundësitë e grave për tu aktivizuar në tregun e punës; ofrimin e mbështetjes financiare, qasja në programe mikrokreditore dhe financimi përmes bashkimeve kreditore, janë planifikuar për të rritur angazhimin e grave në ndërmarrësi dhe rritjen e bizneseve në pronësi të grave; zhvillimin e kornizës ligjore, udhëzuesve, dhe ngritjes së kapaciteteve për të mundësuar zbatimin e plotë dhe të saktë të Ligjit për Barazi Gjinore, në nivelin qendror dhe lokal; zhvillimi i treguesve të matshëm, të cilët duhet raportuar në intervale të rregullta kohore, për të përcjellë progresin dhe pengesat në arritjen e barazisë gjinore; integrimin e perspektivës gjinore në politikat publike, shpërndarjes së informatave, dizajnit të shërbimeve dhe mbështetjes në përputhje me kërkesat dhe nevojat e të dy gjinive; zgjerimin

dhe zhvillimin e Masave Aktive të Punësimit, duke iu përshtatur nevojave dhe kërkesave edhe të grave; realizimin i të drejtës në pronë dhe trashëgimi; dhe uljen e punësimit joformal dhe përmirësimit të kushteve në vendin e punës.

Objektivi strategjik 2: Avancimi i barazisë gjinore, përmes arsimit dhe shëndetësisë cilësore, gjithë përfshirjes, dhe shfrytëzimit të kapaciteteve njerëzore si kontribuues në zhvillimin e qëndrueshëm njerëzor dhe zhdukjen e pabarazive dhe stereotipeve gjinore, synohet të arrihet përmes këtyre veprimeve: organizimin e aktiviteteve vetdijësuese dhe politika publike për t'i kontribuar parandalimit të braktisjes së shkollimit; krijimin e mundësive dhe i qasjes në shërbime për kujdesin e fëmijëve dhe të moshuarve; krijimin e skemave mbështetëse për vajzat dhe gratë për t'u angazhuar dhe avancuar në punë; eliminimin e stereotipeve, gjuhës dhe praktikës pedagogjike diskriminuese nga plan programet dhe tekstet mësimore; ngritjen e kapaciteteve të sistemit arsimor për ti zbatuar mekanizmat ekzistues për arritjen e barazisë gjinore; përkrahje financiare për avancim profesional, infrastrukturë dhe ndërgjegjësim publik për ngritjen e pjesëmarrjes së vajzave grave në sport; hartimi i politikave të reja, përplotësuese, për përfaqësim të barabartë gjinor në organizata mediatike dhe politika editoriale; hartimin dhe akreditimin e programit të trajnimit për gazetarë në fushën e barazisë gjinore dhe luftimit të ekstremizmit të dhunshëm; monitorimi dhe vlerësimi në të tri fushat duke përfshirë: integrimin e të dhënave personale në SISHT për shëndetin e gruas, nënës dhe fëmijës (duke përfshirë edhe dhunën ndaj grave në të gjitha format); hulumtime mbi praktikën e planifikimit familjar; hartimi i programeve edukative dhe vetëdijësuese, me fokus të veçantë shëndetin riprodhues; hartimi i udhërrëfyeseve dhe protokolleve për trajtim dhe monitorim të indikatorëve të cilësisë, përmirësimi i qasjes në shërbime në vendet rurale; ngritja e kapaciteteve profesionale (për promovim dhe edukim shëndetësor, përfshirë shëndetin riprodhues dhe nevojat specifike shëndetësore të femrave dhe meshkujve; organizimi i aktiviteteve vetëdijësuese për shëndetin mendor (bullizmi, ngacmimi seksual, bulimia, anoreksia, seksualitetin, etj.); harmonizimi me trajnimin e mësimdhënësve në shkollat promovuese për informim, edukim dhe komunikim për shëndetin riprodhues dhe seksual; zgjerimi i vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijë, si dhe përfshirja e shtuar në këto vizita të nënave dhe fëmijëve të komuniteteve Rome, Ashkali dhe Egjiptase; dhe akreditim i programit të trajnimit për mësimdhënësit mbi shëndetin seksual (në të tri nivelet).

Objektivi strategjik 3: Avancimi i realizimit të të drejtave në vendimmarrje, paqe, siguri dhe drejtësi garantues i arritjes së barazisë gjinore, do të realizohet përmes këtyre aktiviteteve kryesore: harmonizimit të kornizës ligjore, përmes përfshirjes së normave jo diskriminuese gjinore në kuadrin ligjor të përgjithshëm të vendit, në përputhje dhe me kërkesat e Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të) të Kombeve të Bashkuara 2030; caktimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të profilizuar të cilët merren me raste familjare, të dhunës në familje, të dhunës seksuale gjatë luftës, konteksteve pronësore dhe të trashëgimisë; përmirësimit të të dhënave për viktimat dhe kryesit e dhunës në familje; sensibilizimit shoqëror për përmbushjen e të drejtave të grave të cilat janë të parapara me ligje por dhe luftimi i fenomeneve negative siç është dhuna në familje, stereotipet gjinore, mentaliteti patriarkal; fuqizimin e kapaciteteve të Komisionit qeveritar për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës dhe organizatave të licencuara në kuadër të këtij procesi për të rritur qasjen e grave në drejtësi; harmonizimin dhe plotësimin e ligjeve: me fokus tek ligji për zgjedhje, ligji për financimin e partive politike si dhe vet rregullorja e punës së Kuvendit të Kosovës në mënyrë që të jenë në përputhje me ligjin për barazi gjinore, mbi të gjitha të garantohet pjesëmarrja e barabartë gjinore në vendimmarrje; zbatimin e masave afirmative nga institucionet publike përfshirë ato të sigurisë; fuqizimit të grave asambleiste me anë të aktiviteteve për ndërgjegjësim dhe vetëdijësim për barazinë gjinore si dhe fuqizimi i grave deputete konsiderohet i rëndësishëm; organizimi i fushatave vetëdijësuese për të inkurajuar gratë për tu bërë pjesë e sektorit të sigurisë; lobimi dhe avokimi lidhur me përfshirjen e grave në procesin e negociimit të paqes dhe pajtimit; dhe organizimin e debateve publike për përfaqësimin e grave në proceset e negociimit, paqes dhe pajtimit.

1. HYRJE

Hartimi i Programit të Kosovës për Barazi Gjinore është obligim që del nga Ligji për Barazi Gjinore 05/L -020. Specifikisht, Neni 11, obligon Agjencinë për Barazi Gjinore të bashkërendoj përgatitjen e Programit, të monitoroj zbatimin e tij, si dhe të raportoj çdo vit tek Qeveria për zbatimin e tij. Ky Nen po ashtu përcakton që Qeveria shqyrton dhe miraton Programin e Kosovës për Barazi Gjinore dhe raporton çdo vit në Kuvend për zbatimin e tij, dhe këto raporte bëhen publike. Programi i parë për Barazinë Gjinore në Kosovë 2008-2013, ndërsa I njëjti, siç edhe kërkohet me Ligjin për Barazi Gjinore, është vlerësuar në vitin 2016 me një sërë të gjeturash dhe rekomandimesh edhe për Programin e ardhshëm të Kosovës për Barazi Gjinore. Hartimi i PKBGJ-së është aktiviteti I paraparë në kuadër të Programit të Qeverisë 2017-2021, ku theksohet se do të miratohet Programi i Kosovës për Barazi Gjinore me mjete adekuate financiare i cili do të jetë platformë pune për të gjitha institucionet, për të avancuar parimet e barazisë gjinore, përmbushjen e të drejtave të grave dhe arritjen e një shoqërie paqësore, të begatë dhe harmonike për gratë dhe burrat në Kosovë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përcakton konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut sikurse Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (njohur si CEDAW), Rezoluta 1325 e Kombeve të Bashkuara mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin vendor dhe në rast konflikti konsiderohet të ketë prioritet ndaj akteve dhe ligjeve të nxjerra nga institucionet publike.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (SKZH), ka për synim t'i adresojë pengesat kryesore për zhvillimin e Kosovës, duke synuar synon të zhvillojë kapitalin njerëzor, zbatoj sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë; mbështes zhvillimin e industrive konkurruese dhe zhvillimin e infrastrukturës. Parimi i dytë I Strategjisë është nevoja që paralelisht me rritjen ekonomike të sigurohet edhe kohezion shoqëror dhe gjithë përfshirje, gjë që nënkupton **përfshirjen e grupeve të caktuara të shoqërisë në përfitimet e rritjes ekonomike.** Kjo Strategji, përmes rritjes së përfshirjes së fëmijëve në institucione parashkollore, synon të mundësojë sukses më të madh në nivele më të larta të arsimit, uljen e pabarazisë dhe rritjen e pjesëmarrjes së femrave në tregun e punës. Në shtyllën 2 të Strategjisë-Sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë, parashikohen masa për garantimin dhe fuqizimin **e të drejtave pronësore për gratë.** Programi i Qeverisë 2020-2023, **fokuset specifikisht në fuqizimin e rolit të gruas e rolit dhe pozitës së grave dhe vajzave në shoqëri** (Kapitulli 2 pika 2.1 Te drejtat e njeriut, barazia gjinore dhe komunitetet), me qëllim të avancimit dhe fuqizimit të pozitës së tyre, hartimin dhe zbatimin e politikave adekuate për fuqizim ekonomik të tyre, me qasje ndër sektoriale të përcjella me resurse adekuate për zbatim. Qeveria do të vazhdoj me fuqizimin e mekanizmave institucional për barazi gjinore, si dhe mekanizmave institucional për mbrojtjen nga diskriminimi, përmes Zbatimit me rigorozitet të Ligji për Barazi Gjinore dhe rregulloreve përkatëse për forcimin e mekanizmave gjinorë në nivel vendi, ligjit kundër diskriminimit dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Në këtë dokument theksohet se do të të miratohet Programi i Kosovës për Barazi Gjinore, si dhe do të miratohet akti normativ dhe zbatimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinorë si metodë planifikimi të buxhetit bazuar në nevojat e grave dhe burrave në Kosovë për zhvillim të qëndrueshëm gjithëpërfshirës dhe mirë menaxhimin e burimeve njerëzore dhe financiare në përmbushje të parimeve të qeverisjes së mirë për efektivitet, efikasitet, llogaridhënie dhe transparencë.

Programi i Kosovës për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian (2017-2021), përmban një sërë të aktiviteteve të cilat duhet ndërmarrë institucionet e Kosovës, përfshi edhe respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut si dhe të drejtave të grave në kuadër të bllokut demokracia dhe sundimi i ligjit si dhe në respektimin e të drejtave themelore të njeriut. Programi i Kosovës për Reforma Ekonomike 2020-2022, synon në rritjen e qasjes së të rinjve dhe grave në tregun e punës (Masa 19- Përmirësimi dhe zgjerimi i shërbimeve publike të punësimit dhe rritja e punësimit të të papunëve afatgjatë, të rinjve, grave

dhe grupeve tjera të cënueshme); Masa e reformës #20: Përmirësimi i shërbimeve sociale dhe fuqizimi i grupeve të përjashtuara

Strategjia Sektoriale e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 2018-2022 synon të rrisë punësimin dhe përmirësojë mirëqenien sociale në vend. Strategjia synon në adresimin e pabarazive gjinore në tregun e punës, përmes dizajnit të shërbimeve dhe masave aktive të punësimit në përputhje me kërkesat e grave, adresimin e ndarjes së profesioneve në baza gjinore, dhe përfshin aktivitete për rritjen e mirëqenies sociale përmes zgjerimit dhe ngritjes së cilësisë së mbrojtjes dhe shërbimeve sociale e familjare, me fokus të veçantë në grupet në nevojë dhe barazinë gjinore. **Në vitin 2018, Qeveria e Kosovës ka aprovuar Planin e Veprimit për Punësimin e të Rinjve 2017-2020.** Ky Plan ka karakter ndërsektorial dhe përfshin aktivitete specifike për mbështetjen e punësimit dhe adresimit të ndarjes së profesioneve në baza gjinore të vajzave të reja. Në mesin a aktiviteteve përfshihen ofrimi i shërbimeve të punësimit, MATP-ve dhe programeve të përshtatshme dhe me efekt në punësimin e vajzave të reja dhe orientimin e vajzave në drejtime deficitare profesionale (përmes orientimit dhe këshillimit në karrierë dhe ofrimit të bursave studimore).

Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe, Egjiptian në Shoqërinë Kosovare 2017-2021 synon të promovojë dhe të sigurojë realizimin efektiv të të drejtave të këtyre komuniteteve, në veçanti qasjen në arsim, punësim, shërbime shëndetësore dhe banim. Për të rritur punësimin, në këtë Strategji është planifikuar të bëhet promovimi i rasteve të suksesit në tregun e punës të pjesëtarëve të këtyre, me fokus të veçantë tek gratë. Po ashtu janë planifikuar aktivitete për informimin e grave për skemat e mbrojtjes dhe shërbime sociale dhe shërbimet sociale për rastet e martesave së hershme.

Vizioni i Strategjisë Nacionale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2016-2020, është të krijojë një shoqëri që iu siguron të gjithë shtetasve të saj, të rritur dhe fëmijë, të jetojnë pa frikën apo kërcënimin e dhunës në familje, që mbron viktimat, vendos kryesit përpara përgjegjësisë dhe zvogëlon tolerancën e publikut ndaj veprimeve të dhunshme në familje. Në këtë Strategji, gratë klasifikohen si grupi më i prekur nga dhuna në familje, dhe si rrjedhojë, andaj edhe Strategjia përmes veprimeve konkrete synon të luftoj dhunën në familje dhe të gjitha format e tjera të dhunës ndaj grave.

Strategjia për Rregullim më të Mirë 2017-2021 synon të reformojë legjislacionin primar dhe sekondar dhe të rrisë efikasitetin e komunikimit dhe konsultimit publik. Strategjia thekson se Vlerësimi I Ndikimit Gjinor duhet të aplikohet si mjet për vlerësim ex-ante të politikave, për të parandaluar efektet negative të padëshiruara, dhe për të rritur efektet pozitive të dëshiruara të politikave të propozuara dhe bazës ligjore që ndikojnë në 'pabarazitë e pranishme ne mes te burrave dhe grave në shoqëri'.

2. Metodologjia

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore synon të sigurojë që barazia gjinore është në qendër të proceseve transformuese në Kosovë, është në kuadër të të gjitha strukturave, institucioneve, politikave, procedurave, praktikave dhe programeve të qeverisë, agjencive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit të donatorëve.

Si i vetmi program kombëtar i mandatuar me ligj, dokumenti i ri i PKBGJ-së duhet:

- Të shtojë efikasitetin e veprimeve të propozuara të Kosovës për të rritur më tej pajtueshmërinë dhe zbatimin e konventave dhe detyrimeve ndërkombëtare në kontekstin e vet,
- Të sigurojë një kornizë të vetme gjithëpërfshirëse për menaxhimin e PKBGJ-së së re për arritjen e qëllimeve të përcaktuara qartë brenda politikave të përgjithshme socio-ekonomike të Kosovës, platformës së integrimit evropian dhe agjendës së zhvillimit,
- Të bëjë prioritizimin e intervenimeve dhe afateve të tyre kohore si të identifikuar qartë dhe t'i lidh me analizën e zhvilluar të situatës,
- Të mundësojë zbatimin sa më të shpejtë të ndërhyrjeve të propozuara të PKBGJ-së dhe monitorimin e progresit,
- Të rrisë koordinimin në nivel kombëtar të të gjitha aktiviteteve të PKBGJ-së në të gjithë sektorët, duke mundësuar kështu përpjekjet e përbashkëta, grupimin e burimeve dhe parandalimin e dyfishimit joefikas dhe rivalitetit të panevojshëm,
- Nxisë dhe zhvillojë partneritete dhe lidhje të qëndrueshme brenda dhe jashtë,
- Demonstrojë ndikimin e PKBGJ-së që do të jetë i dobishëm për hartuesit e politikave, të cilët gjithmonë kanë nevojë për justifikim dhe bazën për caktimin e burimeve të pakta interesave dhe nevojave konkurruese,
- Të shërbejë si një burim legjitim dhe gjithëpërfshirës për hartimin e raporteve të Kosovës ndaj organeve ndërkombëtare dhe nismave globale.

Në dhjetor të vitit 2016, Agjencia për barazi Gjinore identifikoi këto tri shtylla strategjike të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore: Fuqizimi Ekonomik dhe Mirëqenia Sociale; Zhvillimi Njerëzor, Rolet dhe Marrëdhëniet Gjinore; dhe të Drejtat e Grave, Qasja në Drejtësi dhe Siguri. Pas definimit të fushave programore, me kërkesë të ABGJ-së, me datë 29 dhjetor 2016, me vendimin 069/2016, Kryeministri i Kosovës emëroi Ekipin Qendror dhe këtyre 4 nëngrupeve punuese për hartimin e PKBGJ-së: Fuqizimi ekonomik dhe mirëqenia sociale; Zhvillimi Njerëzor; Vendimmarrja dhe Përfaqësimi; dhe Gratë, Paqja dhe Siguria. Me vendim po ashtu u caktua Sekretaria e Ekipit, ndërsa Agjencia për Barazi Gjinore kryeson Ekipin Qendror. Duke pasur parasysh natyrën ndër-sektoriale të PKBGJ-së, në ekipet kryesore dhe punuese u caktuan përfaqësues nga: Zyra e Kryeministrit në përbërje të përfaqësues nga : Agjencia për Barazi Gjinore, Zyra Ligjore, Zyra e Planifikimit Strategjik, Zyra për Qeverisje të Mirë; dhe institucioneve : Zyra e Koordinatorit Nacional Kundër Dhunës në Familje; Ministria e Financave; Ministria e Integritetit Evropian; Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Ministria e Zhvillimit Ekonomik; Ministria e Tregtisë dhe Industrisë; Agjencia e Pronës; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal; Ministria e Administratës Publike- Departamenti i Administratës së Shërbyesve Civil; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Forcës së Sigurisë; Policia e Kosovës; Mbrojtësit e Viktimave; Universiteti i Prishtinës; Zyrtarë/e Komunale dhe Ministre për Barazi Gjinore, përfaqësues të shoqërisë civile dhe Agjencive Ndërkombëtare (Vendimi është i bashkëngjitur në Shtojcën 1).

Ky Programi është hartuar duke konsideruar instrumentet, kornizën ligjore dhe politikat kryesore ndërkombëtare dhe kombëtare për sigurimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin ekonomik të grave, më kryesoret janë të prezantuara në vijim.

Instrumentet kryesore Ndërkombëtare për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave

- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut,
- Konventa për të Drejtat Politike të Grave,
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore,
- Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW),
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve,
- Deklarata e Pekinit dhe Platforma e Veprimit të vitit 1995,
- Strategjia Zhvillimore e Vendi 2016-2020,
- Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje-Konventa e Stambollit, 2011
- Rezoluta 1325 dhe 1820 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë ,
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- Agjenda e Synimeve për Zhvillim të Qëndrueshëm e kombeve të Bashkuara 2030
- Deklarata e KB për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave.

Korniza ligjore dhe politikat vendore për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 7, 21 dhe 22
- Ligji për barazi Gjinore Nr. 05/L-020
- Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në familje Nr. 03/L-182
- Ligji për Trashëgimi Nr. 2004/26
- Ligji i Familjes Nr. 2004/32
- Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi. 05/L-021
- Ligji për Pronat dhe të Drejtat Pronësore Nr. 03/L-154
- Ligji i Punës Nr. 03/L-212

Korniza zhvillimore vendore dhe veprimet për promovimin e Barazisë Gjinore dhe fuqizimin e Grave:

- Programi i Kosovës për Barazi Gjinore,
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim,
- Programi i Reformave Ekonomike,
- Strategjia për Rregullim më të Mirë,
- Strategjia Nacionale dhe Plani i veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje,
- Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit,
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat Pronësore,
- Korniza Afatmesme e Shpenzimeve,
- Qarkorja Vjetore Buxhetore, dhe
- Strategjitë e tjera.

Metodologjia dhe udhëzuesi për hartimin e PKBGJ-së është zhvilluar nga Udhëheqësja e Projektit "Forcimi Institucional i Agjencisë për Barazi Gjinore dhe Mekanizmave Institucional" – financuar nga Qeveria Suedeze – Sida, zbatuar nga Konsorciumi Niras & CPM International –s. Metodologjia u aprovua nga Ekipi Qendror. Një ekip prej 6 ekspertëve të financuar nga Sida (2 për secilën shtyllë programatike) u angazhuan në grumbullimin dhe analizën e të dhënave, për të mbështetur diskutimet në grupet punuese dhe për të hartuar PKBGJ-në dhe Planin e Veprimit. Hartimi i Programit përfshiu këto faza kryesore:

- Mbledhja e të dhënave, shqyrtimi dhe analiza e problemeve;
- Hartimin e Programit dhe planit të saj të veprimit;
- Konsultimet ndërministrorë dhe publike

Duhet theksuar se konsultime janë bërë gjatë gjithë procesit të hartimit të PKBGJ-së dhe Planit të Veprimit. Qëllimi i konsultimeve ishte të validoheshin të gjeturat nga analiza e gjendjes; të ofrohej mundësi për të gjithë palët e interesit të propozonin veprime konkrete për të kontribuar në arritjen e objektivave të PKBGJ-së dhe Planit të Veprimit; dhe për të validuar dokumentin e plotë.

Parimet kryesore në hartimin e PKBGJ-së janë:

- Të drejtat e grave dhe të drejtat e njeriut,
- Barazia gjinore është kontribuues i rëndësishëm për zhvillim të qëndrueshëm të vendit,
- Institucionet e Kosovës janë të përkushtuara për të promovuar llogaridhënien përmes lidershit të grave, zërit të grave, pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave në vendimmarrje, politikë, qeverisje të mirë dhe siguri.
- Agjencia për Barazi Gjinore dhe të gjithë mekanizmat për arritjen e barazisë gjinore janë të pozicionuar mirë dhe duhet të posedojnë kapacitete për të integruar barazinë gjinore dhe avancuar fuqizimin e grave,
- Qeveria dhe të gjithë palët e interesit demonstrojnë ‘vullnet politik’ për të integruar perspektivën gjinore, dhe
- Gratë janë një grup heterogjen dhe diversiteti duhet të reflektohet në të gjitha intervenimet e qeverisë.

Mbledhja e të dhënave, shqyrtimi dhe analiza e problemeve: Për secilën shtyllë të PKBGJ-së, ekspertët e angazhuar identifikuan fushat përkatëse, llojin e të dhënave dhe burimin e tyre. Agjencia e Statistikave të Kosovës është përdorur si burim kryesor i të dhënave, sa herë që të dhënat kanë ekzistuar: ky orientim është përcaktuar për të siguruar disponueshmëri të të dhënave për përcjelljen e indikatorëve të synuar. Bazuar në të dhënat e grumbulluara, u hartua analiza e gjendjes/situatës, që shërbeu për definimin e problemit kryesorë në secilën shtyllë dhe faktorëve kontribuues në problem. Në përputhje me udhëzimet metodologjike, ekspertët po ashtu kanë analizuar strategjitë ekzistuese, kornizën ligjore relevante dhe po ashtu kanë analizuar praktikën e mira në fushat përkatëse-të cilat kanë shërbyer si informatë e vlefshme për hartimin e Planit të Veprimit. Gjetjet nga analiza e gjendjes janë diskutuar në grupe punuese, ku edhe është arritur pajtueshmëri për problemin dhe sfidat që duhet adresuar në kuadër të Planit të Veprimit.

Tabela 1: Konsultimet gjatë procesit të hartimit të PKBGJ-së

Numri	Datat e punëtorisë	Shtylla/t programore	Numri i pjesëmarrësve
1	16- 17. 10. 2017	Të drejtat e grave, qasja në drejtësi dhe siguria	43
2	18.10 2017	Fuqizimi ekonomik dhe mirëqenia sociale	25
3	26-27.10.2017	Zhvillimi Njerëzor dhe Rolet dhe Marrëdhëniet Gjinore	33
4	12-13.02.2018	Të drejtat e grave, qasja në drejtësi dhe siguria	36
5	22-23.03.2018	Të drejtat e grave, qasja në drejtësi dhe siguria	42
6	14 02.2018	Zhvillimi Njerëzor dhe Rolet dhe Marrëdhëniet Gjinore	30
7	19 -20.03.2018	Zhvillimi Njerëzor dhe Rolet dhe Marrëdhëniet Gjinore	28
8	28.02.2018	Fuqizimi ekonomik dhe mirëqenia sociale	26
9	28-29.03.2018	Fuqizimi ekonomik dhe mirëqenia sociale	31
10	28-29.08.2018	Sesioni plenar për rishikimin e Planit të Veprimit	56

Hartimi i Programit dhe planit të tij të veprimit. Bazuar në analizën e gjendjes, problemat të definuar dhe shkaktarëve kryesorë, në punëtoritë e organizuara për secilën shtyllë veç e veç, u definua Objektiva Strategjike dhe objektivat specifike. Për secilën nga këto, u përcaktuar indikatorët matës (bazuar në parimin SMART) dhe u shënua treguesi bazë. Për të gjithë indikatorët, u përcaktuan indikatorët e synuar për periudhë 5 vjeçare-sa edhe zgjat PKBGJ. Është e rëndësishme të theksohet që Indikatorët e Zhvillimit të Qëndrueshëm¹ janë përdorur si burim i rëndësishëm referues, në përcaktimin e indikatorëve në të tri shtyllat e PKBGJ-së. Pas validimit të gjetjeve, përcaktimit të problemit dhe shkaktarëve kryesorë, gjatë punëtorive, janë identifikuar aktivitete konkrete dhe njëkohësisht është llogaritur kostoja e secilit aktivitet. Plani i veprimit, përfshin aktivitete të Strategjive të tjera, e që janë relevante për adresimin e sfidave të identifikuar, e si rrjedhojë këto nuk reflektojnë shpenzime shtesë në kuadër të Planit. Po ashtu, u përcaktuan të dhënat e tjera të domosdoshme për secilin aktivitet, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ për hartimin e dokumenteve strategjike.

Konsultimet. Siç u prezantua më lartë, në grupet punuese ka pasur përfaqësim të gjerë të institucioneve qeveritare, shoqërisë civile dhe agjencive ndërkombëtare, dhe institucioneve donatore multilaterale dhe bilaterale të përfshira sipas natyrës së grupeve të punës në përputhje me synimet strategjike afatgjata të ndihmës në zhvillim për Kosovë si : Komisioni Evropian, UN Women, UNFPA; Sida, GIZ, USAID, Këshilli i Evropës, si dhe organizatat politike si OSBE; EULEX .

¹ Të miratuara nga liderët botërorë në Samitin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm të 25 shtatorit 2015, për t'i dhënë fund varfërisë, për të luftuar pabarazinë dhe padrejtësinë dhe për të adresuar ndryshimet klimatike deri me 2030.

3. Sfondi

SHTYLLA I: Fuqizimi ekonomik dhe mirëqenia sociale

Gjendja aktuale

Përkundër përmirësimeve nëpër vite, Kosova karakterizohet me shkallë të lartë të varfërisë. Sipas rezultateve të fundit të varfërisë në konsum (ASK, 2017²), në vitin 2015 shkalla e varfërisë në Kosovë ishte 17.6 përqind ndërsa shkalla e varfërisë e skajshme ishte 5.2 përqind (Tabela 1). Varfëria mbetet më e lartë në vendbanimet rurale, me 18.9 përqind të popullsisë në varfëri dhe 6.2 përqind në varfëri të skajshme, në krahasim me 15.5 dhe 3.6 përqind sa ishte në zonat urbane. Derisa rreth 60 përqind e popullsisë jeton në vendbanimet rurale, në vitin 2015, rreth dy të tretat e të varfërve dhe tre të katërtat e atyre në varfëri të skajshme jetonin në vendbanimet rurale.

Tabela 2: Shkalla e varfërisë në konsum në Kosovë, 2012-2015

Varfëria	2012	2013	2014	2015	Ndryshimi në %
Urbane	19.6	16.3	20.9	15.5	-5.4
Rurale	25.0	18.5	21.3	18.9	-2.3
Totale	22.9	17.6	21.1	17.6	-3.5
Varfëria e skajshme	2012	2013	2014	2015	Ndryshimi në %
Urbane	7.0	5.5	6.5	3.6	-2.9
Rurale	8.8	6.0	7.1	6.2	-1.0
Totale	8.1	5.8	6.9	5.2	-1.7

Burimi: ASK, 2017, Raporti i varfërisë 2012-2015

Shkalla e varfërisë tek familjet me kryefamiljare gra është më e lartë, respektivisht 23.7 përqind në krahasim me 17 përqind sa ishte në ekonomitë familjare me kryefamiljarë meshkuj (Tabela 2). Në nivel individual, në vitin 2015, 18 përqind e femrave në Kosovë jetonin në varfëri në krahasim me 17.2 përqind të meshkujve, pothuajse një përqind diferencë (Tabela 2).

Tabela 3: Shkalla e varfërisë, sipas gjinisë së kryefamiljarit: 2012-2015

Gjinia	2012	2013	2014	2015
Burra	22.6	17.5	20.8	17.0
Gra	26.2	18.4	26.0	23.7

Burimi: ASK, 2017, Raporti i varfërisë 2012-2015

Raporti i varfërisë për Kosovën, nuk raporton të dhëna të ndara sipas etnisë, por burime të tjera raportojnë se shumica e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve jetojnë në varfëri ekstreme³ dhe vazhdojnë të ndeshen me kushte të vështira të jetesës⁴. Situata është posaçërisht e vështirë për 20 përqind të të varfërve të këtyre komuniteteve që jetojnë në zonat rurale³⁴.

Gratë janë në pozitë të pafavorshme, në krahasim me meshkujt, në qasjen në tregun e punës. Përgjatë periudhës 2012-2018, të dhënat e ASK-së tregojnë se shkalla e pjesëmarrjes së grave në fuqi punëtore është dukshëm më e ulët sesa tek meshkujt. Përgjatë kësaj periudhe, norma e aktivitetit për gra sillet në interval prej 18-21 përqind, në krahasim me 55-65 përqind për burra. Në mesatare, vetëm dy në 10 gra kanë qenë aktive në tregun e punës, që do të thotë se 8 nga 10 gra nuk kanë qenë as të punësuarat e as duke kërkuar punë. Për 40 përqind të grave, kujdesi

² ASK, 2017, Varfëria në Konsum në Republikën e Kosovës në Periudhën 2012-2015: <http://ask.rks-gov.net/media/3186/stat-e-varferise-2012-2015.pdf>

³ World Bank, Kosovo Country Snapshot, 2015.

⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Komunitetet Rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës, Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë 2013-2014; Komisioni Evropian.

dhe përgjegjësitë familjare janë arsyt kryesore për jo-aktivitet, në krahasim me 3.8 përqind të meshkujve. Shkalla e dëshpërimit për punësim është po ashtu më e theksuar tek gratë: në vitin 2015, rreth 17 përqind të femrave nuk kanë kërkuar punë ngase nuk besojnë se mund të gjejnë punë, në krahasim me 11 përqind të meshkujve (ASK, 2016)⁵.

Gjatë periudhës 2012-2018, mesatarisht, vetëm 12 përqind e grave ishin të punësuar, në krahasim me rreth 42 përqind të burrave. Në numër absolut, në vitin 2018, të punësuar ishin vetëm 73,508 gra në krahasim me 271,623 burra, që do të thotë se gratë përbënin vetëm 21.1 përqind të të punësuarve, normë kjo përgjysmë më e ulët se pjesëmarrja e tyre në numrin e përgjithshëm të popullsisë.

Përkundër rritjes ekonomike pozitive, në krahasim me vendet e Ballkanit Perëndimor, tregu i punës në Kosovë karakterizohet me shkallën më të lartë të joaktivitetit dhe papunësisë dhe shkallës më të ulët të punësimit (Tabela 4).

Tabela 4: Treguesit e tregut të punës, 2017-Tremujori 2

	Raporti punësim ndaj popullsisë (shkalla e punësimit)-në%	Shkalla e papunësisë (%)	Shkalla e joaktivitetit (%)
Shqipëria	57.3	13.9	66.8
Kosova	30.6	30.4	44.1
Mali i Zi	50.5	22.6	65.4
Serbia	58.8	11.8	67.0
Bosnia dhe Hercegovina	54	15.1	63.8
Republika e Maqedonisë Veriore	43	20.5	54.5

Burimi: The Vienna Institute for International Economic Studies (wiiw), 2018

Përgjatë periudhës 2012-2018, në mesatare, rreth 38 përqind e grave aktive në tregun e punës, ishin të papuna, në krahasim me 29 përqind të burrave (Tabela 5). Në vitin 2018, 108,140 nga 144,972 të papunë ishin burra dhe 36,832 ishin gra-ku gratë përfaqësonin 25.4 përqind të të papunëve, që vjen si rezultat i shkallës së lartë të joaktivitetit të tyre.

Tabela 5: Treguesit e tregut të punës, 2012-2018

	2012		2013		2014		2015		2016		2017		2018	
	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
Shkalla e joaktivitetit	44.6	82.2	39.8	78.9	38.2	78.6	43.3	81.9	41.7	81.4	34.7	80.0	36.7	81.6
Raporti punësim ndaj popullsisë (shkalla e punësimit)	39.9	10.7	44.0	12.9	41.3	12.5	38.7	11.5	43.0	12.7	46.6	12.7	45.3	12.3
Shkalla e papunësisë	28.1	40.0	26.9	38.8	33.1	41.6	31.8	36.6	26.2	31.8	28.7	36.6	28.5	33.4

Burimi: ASK, 2019

Në Kosovë, të rinjtë karakterizohen me normë të lartë të papunësisë: në vitin 2018, 64.7 përqind e të rejave ishin të papuna, në krahasim me 51.5 përqind e të rinjve meshkuj. Në vitin 2018, 101,600 të rinj (të moshës 15 deri 24 vjeçare) në Kosovë nuk ndiqnin shkollimin, nuk ishin të punësuar apo në trajnim, duke përbërë 30.1 përqind të popullsisë së re. Pjesa e grave të kategorizuara si NEET është 30.0 përqind krahasuar me 30.2 përqind të meshkujve ndërsa më shumë se gjysma e të rinjve në këtë kategori janë të gjinisë femërore 54.6 përqind.

⁵ http://askdata.rksgov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/askdata__Labour%20market__02%20Annual%20labour%20market/lfs23.px/table/tableViewLayout1/?rxid=56ed0e33-d38b-4e0a-b5a8-5fddb5a31811

Nuk ekzistojnë të dhëna zyrtare për shkallën e papunësisë tek minoritetet, por siç raportohet në Strategjinë për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, norma e papunësisë tek këto komunitete është më e lartë sesa tek komunitetet e tjera.⁶ Shkaqet për dallimet gjinore në punësim, tek këto komunitete, përfshijnë martesat e hershme tek vajzat, nivelin më të ulët të shkollimit (në krahasim me meshkujt), dhe stereotipet gjinore ku gruaja konsiderohet si përgjegjëse për kujdesin ndaj shtëpisë dhe familjes (faqe 43).

Në vitin 2018, pjesa dërmuese e grave kanë statusin e punonjësit (80.6përqind), me vetëm 13.8 përqind si të vete punësuar dhe 5.6 përqind (për qind) të angazhuara si punëtore familjare të papaguara. Sipas të dhënave të vitit 2014 (KIESA), vetëm 13 përqind e bizneseve aktive të vogla dhe të mesme kanë qenë në pronësi të grave dhe tre përqind të tjera kanë qenë në bashkëpronësi të grave. Të dhënat e ASK-së për vitin 2016 dhe 2017, tregojnë për një trend në rritje, të numrit dhe përqindjes së bizneseve të regjistruara në pronësi ose bashkëpronësi të grave: në tremujorin e parë të vitit 2017, 30.2 përqind e bizneseve të regjistruara ishin në këtë kategori, në krahasim me 22.5 përqind sa ishte në tremujorin e katërt të vitit 2016 ose me 24.1 përqind sa ishte në tremujorin e tretë të po këtij viti. Si numër, në tremujorin e parë të vitit 2017, u regjistruan 339 në pronësi të grave dhe 237 ndërmarrje me gruan si bashkëpronare. Këto të dhëna tregojnë se pjesëmarrja e grave në aktivitete ndërmarrëse është e kufizuar, e që tërthorazi ndikon edhe në numrin e femrave të punësuar në sektorin privat.

Ekziston ndarje gjinore e profesioneve: gratë janë kryesisht të punësuar në sektorin e arsimit, tregtisë dhe kujdesit shëndetësor (përbëjnë 48.4 përqind të grave të punësuar). Sektorët kryesorë të punësimit të burrave janë prodhimi, ndërtimtaria dhe tregtia (duke përbërë 45.8 përqind të meshkujve të punësuar). Të dhënat nga AFP, po ashtu tregojnë se sektori publik preferohet nga gratë, si një sektor që ofron punësim të qëndrueshëm.

Kryesisht për shkak të angazhimeve familjare, punësimi me orar të pjesshëm është më i shprehur tek gratë: në vitin 2018, 5.4 përqind e grave punojnë me orar të pjesshëm në krahasim me 4.2 përqind të burrave (ASK, 2018). Arsye për punësim të pjesshëm tek gratë janë ato personale dhe familjare (28.5përqind) ndërsa kjo është arsye për vetëm 0.8 përqind të burrave.

Angazhimi në tregun joformal është një tjetër karakteristikë e tregut të punës së Kosovës. Sipas AFP-së, në vitin 2017⁷, 21.5 përqind e të punësuarave punon pa kontrata. Nga këta, një anketë në mbarë Kosovën ka treguar se në sektorin privat, rreth 30përqind e grave punojnë pa kontratë.⁸ Sipas AFP-së, meshkujt kanë më shumë gjasa të mbajnë punë të paqëndrueshme 24.1 përqind kundrejt 18.8 përqind të femrave në këtë lloj punësimi konsiderohet se një numër i grave janë të punësuar në tregun joformal, të angazhuara në përkujdesjen e fëmijëve dhe mirëmbajtjen e shtëpive. Një studim i kohëve të fundit i shfrytëzimit të kohës ka zbuluar se burrat, mesatarisht, kalojnë 400 përqind më shumë kohë (3.9 orë në ditë) në punë sesa gratë (0.9 orë në ditë). Ndërkaq, gratë kalojnë 300 përqind më shumë kohë në aktivitete shtëpiake dhe kujdes familjar (7.1 orë) sesa burrat (2.3 orë).⁹ Sipas sektorëve, konsiderohet se shkalla e informalitetit është më e theksuar në bujqësi dhe në ndërtimtari. Përderisa sipas AFP-së, në vitin 2014¹⁰, të punësuar në sektorin e bujqësisë ishin 8,600 (7,500 meshkuj dhe 1,100 gra), bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë në po këtë vit, numri i përgjithshëm i personave të angazhuar në bujqësi ishte 362,700.¹¹ Sipas po këtij burimi, gjysma e fuqisë punëtore e angazhuar në punët e bujqësisë janë anëtarë të familjes, nga të cilët 58.2 përqind janë gra. Këto të dhëna tregojnë se gratë përbëjnë pjesë të rëndësishme të fuqisë punëtore në këtë sektor, e që kryesisht vepron jo formalisht. Si pasojë e punësimit joformal, gratë përfitojnë më pak të ardhura, dhe dëmtojnë të ardhmen, duke mos kontribuar në fondin e kursimeve pensionale.

Niveli i shkollimit tek meshkujt mbetet më i lartë sesa tek femrat: në vitin 2015, rreth gjysma e femrave të moshës 15-64 vjeçare kishin të përfunduar vetëm shkollën fillore në krahasim

6 http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Draft_Strategjia_per_integrimin_e_komuniteteve_2016-2020_.pdf

7 Raporti i vitit 2018 nuk ka raportuar informalitetin sipas gjinisë.

8 Rrjeti i Grave të Kosovës, Nga fjalët në vepra?, 2017.

9 Rrjeti i Grave të Kosovës, Analiza gjinore e Kosovës, 2018, në: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20181003170921410.pdf>

10 Referenca në këtë vit, për të bërë krahasim direkt në mes të dy burimeve.

11 ASK, 2015, Regjistrimi i Bujqësisë 2014 - Rezultatet përfundimtare: <http://ask.rks-gov.net/media/1374/rezultatet-perfundimtare.pdf>

me 27 përqind të meshkujve (ASK, 2016). Mirëpo, në vitet e fundit, sipas statistikave të arsimit të MASHT-it, shkalla bruto e regjistrimit për vajza dhe djem ishte pothuajse e njëjtë: ishte 94.9 përqind për vajza dhe 94.5 përqind për djem. Vijueshmëria në arsimin parashkollor në Kosovë është e ulët në përgjithësi për shkak të institucioneve të pamjaftueshme parashkollore që janë të përballueshme, larg nga Objektivat e Barcelonës të BE-së.¹² Mbase më pak vajza sesa djem dërgohen në institucione parashkollore për shkak të qëndrimeve stereotipike gjinore, dhe kuptimit të dobët, veçanërisht jashtë Prishtinës, se arsimi parashkollor është i rëndësishëm.¹³ Një raport gati i barabartë i vajzave ndaj djemve që marrin asistencë sociale vijnë arsimin para universitar, veçanërisht arsimin parashkollor dhe atë fillor/të mesëm të ulët. Gjatë shkollës së mesme të lartë, vijueshmëria në radhët e vajzave që marrin asistencë sociale bie dukshëm, duke sugjeruar që ato largohen nga shkolla, pasi vijimi më nuk është i detyrueshëm.¹⁴ Shkalla e regjistrimit në arsimin e mesëm të lartë, për vitin shkollor 2015/16 ishte 84.9 përqind, 83.4 për femra dhe 86.3 për meshkuj. Sa i përket arsimit të lartë, pjesëmarrja e vajzave është më e lartë se e djemve: në vitin akademik 2014/2015, 50.2 përqind e femrave në grup moshën 18-25 ishin duke studiuar në arsimin e lartë, normë kjo më e lartë se pjesëmarrja e përgjithshme prej 43.5 përqind.¹⁵

Shkalla e vijueshmërisë së nxënësve në arsimin parauniversitar, e zbërthyer sipas përkatësisë etnike, është relativisht proporcionale me demografinë e Kosovës. Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë nuk janë në dispozicion. Shkalla e braktisjes së shkollës mund të jetë veçanërisht e lartë për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë të cilët u riatdhesuan. Megjithatë, të dhënat për vijueshmërinë arsimore të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë, të zbërthyer sipas gjinisë, nuk janë të disponueshme. Kjo paraqet vështirësi në kuptimin e dallimeve midis vajzave dhe djemve.¹⁶

Kosova ka pesë Qendra Burimore dhe dy shkolla për fëmijët me nevoja të veçanta. Më shumë djem (59përqind) se vajza (41përqind) me nevoja të veçanta vijnë arsimin e detyrueshëm.¹⁷ Sfidat për edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara përfshijnë thyerjen e stigmës shoqërore rreth aftësisë së kufizuar ashtu që prindërit t'i edukojnë fëmijët e tyre.¹⁸ Vajzat me aftësi të kufizuara përballen me më shumë sfida sesa djemtë.

Në Kosovë ekziston një ndarje gjinore sa i përket fushës së studimit, me ç'rast gratë dhe burrat zgjedhin profesione të cilat perceptohen tradicionalisht si më të përshtatshme për gjinitë e tyre (UNDP, 2017)¹⁹. Të njëjtat të dhëna vërtetohen edhe nga të dhënat e MASHT-it për vitin shkollor 2015/2016²⁰, ku 56 përqind të nxënësve në gjimnaze dhe vetëm 39 përqind në ato profesionale ishin femra. Ndarje e konsiderueshme gjinore vihet re edhe në arsimin e lartë (UNDP, 2017): gratë janë të mbi përfaqësuara në drejtimet e edukimit, filologjisë, filozofisë dhe mjekësisë, ndërsa burrat dominojnë në edukim fizik dhe sport, bujqësi, inxhinieri mekanike, inxhinieri kompjuterike, ndërtim dhe arkitekturë. Faktorë kontribuues në këtë ndarje, vlerësohet të jetë mungesa e këshillimit dhe orientimit në karrierë në sistemin arsimor. MASHT-i ka hartuar draftin e Strategjisë së Orientimit dhe Këshillimit në Karrierë e cila mbulon periudhën 2015-2019, por që ende nuk është aprovuar. Kjo Strategji adreson të gjitha nivelet e arsimit nga këndvështrimi i edukimit për karrierë, i ofrimit të shërbimeve këshilluese dhe zhvillimit të kapaciteteve për të ofruar këto shërbime. Aktualisht ky shërbim nuk ofrohet as nga Zyrat e Punësimit, por që është një prioritet i reflektuar në Strategjinë Sektoriale 2018-2022 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Gratë në Kosovë, përfitojnë dukshëm më pak nga fondet publike. Duke qenë se historikisht, norma e punësimit tek gratë ka qenë dukshëm më e ulët se e meshkujve, një numër i kufizuar

12 RrGK, Kush kujdeset? Kërkesat, ofertat dhe opsionet për rritjen e mundësive të kujdesit të fëmijëve në Kosovë, RrGK, 2016, në: <http://www.womensnetwork.org/documents/20161103153827479.pdf>.

13 RrGK, Analiza gjinore e Kosovës, 2018, at: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20181003170921410.pdf>

14 MASHT, Statistikat e arsimit në Kosovë 2015/ 2016

15 Pupovci, D, 2015, Të arriturat dhe sfidat e arsimit të lartë në Kosovë (kontribut për vlerësimin e Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016).

16 RrGK, Analiza Gjinore e Kosovës, 2018

17 ASK, Platforma e ASK-së.

18 RrGK, Analiza Gjinore e Kosovës, 2017 (Interviste)

19 http://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/KHDR/UNDP_HDR_ALB_web.pdf?download

20 MASHT, 2016, Statistikat e Arsimit në Kosovë: <http://masht-smia.net/0a.pdf>

i grave gëzojnë pension kontributiv. Në tremujorin e katërt të vitit 2016, nga gjithsej 41,315 përfitues të pensionit kontributivë, vetëm 13 përqind ishin gra. Pjesa më e madhe e përfituesve direkt nga subvencionet dhe grantet e qeverisë për bujqësi janë burra. Në vitin 2017 gratë morën 17 përqind të granteve të Agjencisë Kosovare për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve (KIESA) për ndërmarrjet e tyre, dhe burrat 83 përqind. Ndërmarrjet e zotëruara nga gratë morën 25 herë më pak fonde si subvencione, ndonëse raporti i ndërmarrjeve në pronësi të grave ndaj atyre në pronësi të burrave është një me gjashtë, gjë që sugjeron se ndarja e fondeve është jo proporcionale.²¹ Në vitin 2015, vetëm 18.7 përqind e përfituesve të granteve për bujqësi ishin gra ose vetëm 17.7 përqind e vlerës së granteve (2.9 milionë nga 16.5 milionë, sa ishin në total). Ngjashëm, të dhënat tregojnë se përgjatë periudhës 2014-2016, në mesatare, vetëm 10 përqind të përfituesve nga pagesat direkte (subvencionet) për bujqësi kanë qenë gra, e që ndërlikohet edhe me përfaqësimin e vogël të grave si pronare të tokave (vetëm 4.9 përqind e tokës bujqësore).

Gratë kanë pjesëmarrje më të vogël si përfituese nga shërbimet e punësimit dhe masat aktive të tregut të punës. Deri në fund të vitit 2016, numri i përgjithshëm i të papunëve të regjistruar në Zyrat e Punësimit (ZP) ishte 101,773 persona, ku prej tyre femra janë 45,061 ndërsa meshkuj 56,712 persona (MPMS, 2017). Shkalla e punësimit përmes Zyrave të Punësimit për gratë është më e vogël se për burra: në vitin 2016, 3.4 përqind e grave të papuna u punësuan përmes ndërmjetësimit të rregullt në krahasim me 4.4 përqind të burrave. Dallimet janë të dukshme edhe për sa i përket përfitimit nga Masatë Aktive të Tregut të Punës (MATP). Në vitin 2016, gratë përbënin 35 përqind të përfituesve të MATP-ve dhe vetëm 27 përqind e të trajnuarve në Qendrat e Aftësimit Profesional (QAP).

Problemi dhe faktorët kryesorë

Sipas raportit të Bankës Botërore (2011), fuqizimi i grave më së shpeshti lidhet me gjenerimin dhe menaxhimin e të ardhurave, të dyja të lidhura ngushtë me nivelin e shkollimit. Literatura thekson se ekzistojnë një mori faktorësh që ndikojnë në fuqizimin e grave, të cilët faktorë në kontekste të ndryshme kulturore dhe zhvillim të ndryshëm ekonomik mund të ndikojnë ndryshe dhe në masë të ndryshueshme. Bazuar në analizën e gjendjes aktuale, *problemi kryesor në fushën e fuqizimit ekonomik dhe mirëqenies sociale është prania e pabarazive dhe përjashtimi socio-ekonomiko strukturor*. Ky problem shkaktohet nga një mori faktorësh, të diskutuar në vijim.

Mungesa e integritimit gjinor në strategji dhe politikat zhvillimore kontribuon në shkallën e kufizuar të përfitimit të grave nga fondet publike. Nga analiza e dokumenteve strategjike, në kuadër të zhvillimit të këtij dokumenti, është gjetur se shumica e dokumenteve strategjike nuk kanë të integruar perspektivën gjinore, tek analiza e gjendjes dhe aktivitetet. Këtë anashkalim e ka lejuar edhe Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2012 për Procedurat, Kriteret dhe Metodologjinë e Përgatitjes dhe Miratimit të Dokumenteve Strategjike dhe Planeve për Zbatimin, duke mos obliguar institucionet të integrojnë aspektin gjinorë as tek analiza e gjendjes por as tek matja e efektit të strategjive. Aktualisht, Udhëzim Administrativ Nr 07/2018 për Planifikim dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit ka adresuar këtë mangësi. Megjithatë ende nuk ka evidencë për shkallën e përfshirjes së perspektivës gjinore në kornizën ligjore.

Përkundër përparimeve, obligimi ligjor për Buxhetim të Përgjegjshëm Gjinor, përcaktuar në Ligjin për Barazi Gjinore të amandamentuar në vitin 2015 nuk po zbatohet. Pika 1.5 e Nenit 5 obligon përfshirjen e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve. Sipas këtij neni të gjitha institucionet publike duhet të përfshijnë integrimin gjinor në institucionet dhe buxhetet e tyre. Kjo kërkon që Ministria e Financave duhet të bëjë procesin e buxhetimit gjinor të detyrueshëm për të gjitha institucionet qeveritare. Ligji Nr. 03 / L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, përcakton se si fondet publike nga qeveria të shpërndahen nëpër ministri, komuna dhe agjencitë shtetërore, por nuk obligon për zbatimin e BPGJ. Aktualisht, në Qarkoren Buxhetore, Ministria e Financave obligon ministrinë, komunat dhe organizatat buxhetore të bëjnë të dukshme efektet e shpenzimeve publike në

barazinë gjinore, por kjo kërkesë mbetet në nivel raportimi dhe kjo mundëson vetëm raportim por nuk obligon institucionet të planifikojnë ndarjen e buxhetit në përputhje me nevojat dhe kërkesat specifike të të dy gjinive.

Duke mos qenë të përfaqësuara në proceset vendimmarrëse, kërkesat dhe nevojat e tyre specifike nuk merren parasysh, as në nivel lokal dhe as në atë qendror. Investimet orientohen në fushat intensive në punën e meshkujve (p.sh. ndërtimi i rrugëve) dhe të cilat më shumë përmirësojnë jetën dhe punën e burrave. Për më shumë, investohet më pak në përmirësimin e kushteve që ndihmojnë gratë (për shembull në rrugë lokale dhe furnizim me ujë) dhe në sektorët me potencial për punësimin e grave (siç është turizmi dhe disa degë të bujqësisë).

Niveli dhe fushat e studimit: Edhe pse në vitet e fundit, pjesëmarrja e vajzave në arsim është pothuajse e njëjtë me atë të djemve, shkalla e arsimit tek gratë e moshës së punës 15-64 vjeçare është dukshëm më e ulët sesa e meshkujve, duke ndikuar negativisht në gjasat e tyre për punësim. Ngjashëm me trendët botërore, fushat ku studiojnë vajzat dhe djemtë janë shumë të ndryshme. Përderisa djemtë studiojnë në inxhinieri ndërsa vajzat vazhdojnë të preferojnë fushën e edukimit dhe shëndetësisë. Kjo vjen si rezultat i normave gjinore (Banka Botërore, 2011), por edhe në mungesë të orientimit dhe këshillimit të hershëm në karrierë. Profesionet që zgjidhen nga vajzat, lidhen më shumë me sektorin publik dhe në sektorë me paga më të ulëta. Për shembull, vajzat janë më pak të interesuar për sektorin e TIK, edhe pse ky sektor ofron mundësi shumë të mira për punësim, siguron të ardhura mbi mesataren e vendit, është një sektor më shumë potencial për eksportim të shërbimeve, dhe punësim nga shtëpia. Vetëm 22 përqind e punonjësve të sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë gra.

Të dhënat për Kosovën, por edhe ato të fundit për vendet e Bashkimit Evropian²², tregojnë se shkalla e punësimit është më e lartë tek të diplomuarit në shkollat profesionale sesa të atyre të përgjithshme (gjimnazet). Shkollimi profesional do të mundësonte që vajzat qysh në moshën 18 vjeçare, të posedojnë shkathtësi në një profesion, duke iu mundësuar atyre tranzicion të hershëm nga shkolla në punësim, duke ndihmuar fuqizimin e tyre ekonomik. Pjesëmarrja e ulët e grave në disa profesione nuk ka efekt vetëm në ato që duan të punësohen në këto profesione por edhe ndikon në performancën e atyre që tani më janë të punësuar në këto profesione, posaçërisht në rastet kur rrjetëzimi është i rëndësishëm (Banka Botërore, 2011). Për më tepër, orientimi i femrave në profesione si në fushën e energjisë, ujit, ambientit e të tjera, do të rrisnin pjesëmarrjen e tyre në institucionet relevante, duke rritur gjasat që politikat gjinore të konsiderojnë dhe adresojnë dallimet dhe pabarazitë gjinore.

Të dhënat nga Agjencia e Punësimit tregojnë, se në vitin 2016, gratë përbënin vetëm 44 përqind të të papunëve të regjistruar, 27 përqind e të trajnuarve në Qendrat e Aftësisimit Profesional (QAP) dhe vetëm 35 përqind të përfituesve nga MATP-të. Kjo qasje e pabarabartë mund të jetë si **rezultat i mungesës së informacionit**, me qasjen në transport (ngase QAP-at janë të vendosur vetëm në regjione jo lehtësisht të qasshme për zonat rurale), mungesës së informimit dhe diversitetit të këtyre masave, për t'iu përshtatur karakteristikave dhe nevojave të grave.

Diskriminimi në punësim. Sipas Ligjit të Punës në Kosovë-Neni 49, nëna e punësuar gëzon të drejtën prej dymbëdhjetë (12) muajve, të pushimit të lehonisë ndërsa baballarët kanë të drejtë në dy ditë pushim me pagesë dhe dy javë pa pagesë, me rastin e lindjes ose adoptimit të fëmijës. Ky Ligj promovon ndarje të pabarabartë të përgjegjësisë familjare, duke kufizuar baballarët të kalojnë shumë pak kohë në përkujdesjen e fëmijëve si dhe ka prodhuar efekte negative në punësim dhe karrierën e nënave. Ekziston evidencë që për shkak të pushimit të lehonisë, gratë shtatzëna përjashtohen nga puna²³, sidomos ato të punësuar në sektorin privat; i humbin të drejtat që i kanë pasur më herët në vendin e punës (si përshtatshmëria dhe kohëzgjatja e llojeve të tjera të pushimit, akumulimi i pensionit, dhe zvogëlimin e mundësive për promovim (RrGGK, 2016)²⁴. Me lindjen e fëmijës, dhe në mungesë të pushimit prindëror, gratë e punësuar

22 http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Employment_rates_of_recent_graduates

23 Arian Zeka and Visar Hapciu, American Chamber of Commerce Kosovo, Position Paper on the Maternity Leave Provision of Law on Labour Problems and Possible Solutions, 2012. Në dispozicion <http://studylib.net/doc/18703334/position-on-maternity-leave---may-2012>

24 Iliriana Banjska, Gresa Rrahmani, dhe Nicole Farnsworth, Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, Arritja e ekuilibrit: Opsionet e politikave që synojnë të informojnë amandamentimin e Ligjit të Punës në Kosovë, 2016, f.23. Në dispozicion <http://www.womensnet.org/documents/20160504154201554.pdf>

përjetojnë ndërprerje në karrierë, duke ndikuar negativisht në zhvillim profesional dhe avancim në vendin e punës (Banka Botërore, 2011). Kjo sepse, për çdo nënë të punësuar, punëdhënësi obligohet të paguaj 70 përqind të pagës për gjashtë muaj, dhe në të njëjtën kohë të punësoj një person të ri për së paku 6 deri në 12 muaj. Gratë e moshës 25-34 vjeçe kanë shkallën më të lartë të pjesëmarrjes në tregun e punës në krahasim me të gjitha grup moshat tjera, mirëpo ato karakterizohen me shkallën më të lartë të papunësisë dhe më të ulëta të punësimit, duke sugjeruar se ato përballen me pengesa që kanë të bëjnë me moshën e tyre riprodhuese dhe perceptimin e përgjithshëm për rolin e tyre tradicional në ekonomi dhe familje (UNDP, 2017). Përfaqësimi i kufizuar i grave në sindikatat e punëtorëve, pengon lobimin dhe avokimin për të drejtat e grave të punësuar dhe adresimin e diskriminimit në punësim.

Një studim i realizuar nga Instituti GAP (2017)²⁵, po ashtu ka gjetur evidencë se në Kosovë gjuha e konkurseve kontribuon në pabarazinë gjinore, duke dekurajuar gratë të aplikojnë në ato vende të punës ku konkursi përmban gjuhë jo të ndjeshme gjinore. Ky studim ka gjetur se konkursat për pozita të larta në institucionet publike përmbajnë gjuhë me stereotipa mashkullor (kupto: stereotipe gjinore), kurse për pozita më të ulëta, konkursat përdorin stereotipa femëror. Gjuha është edhe më diskriminuese, për pozitat në sektorin privat. Për ilustrim, konkursat e pozitat si: asistente, shitëse, recepcioniste, pastruese, kërkohen gra, ndërsa për pozitat si menaxher, drejtor ekzekutiv, inxhinier, kryesisht kërkohen burra.

Në mungesë të institucioneve për përkujdesjen e fëmijëve deri në moshën 5 vjeçare, posaçërisht për gratë që jetojnë në fshatra, gratë detyrohen të qëndrojnë në shtëpi. Sipas të dhënave zyrtare nga MASHT, në vitin shkollor 2015/16 në Kosovë vepronin vetëm 43 institucione për përkujdesjen e fëmijëve. Në mesatare, i bie që ekziston një çerdhe në një komunë, por që në 11 nga 38 komunat e Kosovës nuk ka institucione të tilla fare²⁶. Në vitin shkollor 2015/16, Shkalla Bruto e Regjistrimit (SHBR) në arsimin parashkollor (0<5 vjeç) ka qenë vetëm 3.5 përqind, ndërsa ishte rreth 31 përqind për nivelin e grup-moshës 3 deri nën 6 vjeç.²⁷ Kjo pjesëmarrje e ulët, në Planin Strategjik të Arsimit 2017-2021 vlerësohet si sfida serioze për zhvillimin e fëmijëve. Për më tepër, kjo është edhe pengesë serioze për punësimin e nënave²⁸. Një pohim i tillë tregon edhe mos-përmbushje të objektivave të Barcelonës të cilat po ashtu pohojnë se në mungesë të institucioneve parashkollore rezultatet arsimore janë më të ulëta, gjithashtu pengon edhe pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore, duke marrë parasysh rolin e tyre mbizotërues shoqëroro-kulturor si ofruese të kujdesit. Mungesa e institucioneve për kujdesin e fëmijëve pas mësimit, paraqitet si pengesë, posaçërisht për familjet me të ardhura të ulëta, që nuk kanë mundësi të përballojnë koston në institucione private. Kjo është edhe më e vështirë për nënat vet-ushqyese, për fëmijët e të cilave, baballarët në shumë raste nuk realizojnë obligimin për pagesën e alimentacionit.

Emigrimi i burrave, ka ndikuar që gratë e mbetura në Kosovë të kujdesen për fëmijët, duke mbetur kështu të varura financiarisht nga burrat dhe duke humbur mundësitë për zhvillim në karrierë. Për më tepër, duke pasur të hyra të rregullta, paga rezervë (paga minimale për të cilën do të pranonin një punë) më tej zvogëlon interesimin dhe mundësitë e tyre për punësim (UNDP, 2017)²⁹.

Mungesa transportit publik vlerësohet si një pengesë e rëndësishme për aktivizimin e grave në tregun e punës, posaçërisht për gratë që jetojnë në zona rurale dhe në periferi të qyteteve. Sipas AFP-së së vitit 2016, 93 përqind e grave kanë theksuar se nuk punojnë natën, në krahasim me 85.3 përqind të burrave. Të dhënat nga Anketa e Mozaikut të Kosovës (AMK), ka gjetur se në vitin 2015, rreth gjysma e kosovarëve (54.1 përqind) se nuk kanë qenë të kënaqur me transportin publik në komunën e tyre, ndërsa trendi i kënaqshmërisë ka shënuar rënie drastike gjatë tri viteve të fundit. Banimi në zonat rurale, ka efekt negative në pjesëmarrjen e grave në tregun e punës.

Një faktorë kontribuues në qasjen në tregun e punës mund të jetë mungesa e sigurisë në rrugë, që mund të matet edhe me shkallën e ndriçimit të rrugëve. AMK e vitit 2015 ka gjetur se 45 përqind e femrave dhe 53 përqind e meshkujve nuk kanë qenë të kënaqur me ndriçimin publik të rrugëve dhe shesheve publike në komunën e tyre. Megjithatë, kur janë pyetur nëse

²⁵ http://www.institutigap.org/documents/48043_Raporti-Final%20analize%20punesimi%20i%20grave.pdf

²⁶ <http://masht-smia.net/0a.pdf>

²⁷ <http://masht-smia.net/28.pdf>

²⁸ ASK, 2013-2016; Gashi dhe Rizvanolli, 2015.

²⁹ Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2014.

ndihen të sigurt gjatë natës me ndriçimin publik në komunën e tyre, 65.2 përqind të grave kanë pohuar se ndihen deri diku të sigurt krahasuar me 67.4 përqind të burrave.

Gratë janë dukshëm më pak të angazhuara si ndërmarrëse, dhe në masë të vogël të bashkuara në kooperativa ose shoqata. Kjo jo vetëm rezulton në numër të vogël të pronareve gra, por vlerësohet se ndikon edhe në numrin e përgjithshëm të grave të punësuar në sektorin privat. Shkaktarët kryesorë të pjesëmarrjes së vogël të grave në aktivitete ndërmarrëse konsiderohen të janë *qasja e kufizuar në pronë dhe financa, mungesa e shkathhtësive ndërmarrëse dhe atyre financiare* (e që vjen edhe si rezultat i pjesëmarrjes së kufizuar në vendimmarrje në familje) dhe *perceptimi i grave për mungesën e aftësive për të menaxhuar një biznes* (që ndikohet nga role tradicionale gjinore) (Banka Botërore, 2011). Qasja e kufizuar në pronë vjen si rrjedhojë e mos realizimit të së drejtës në trashëgimi nga familja biologjike, regjistrimi i pronës në të shumtën e rasteve vetëm në emrin e burrave dhe mundësive të kufizuara financiare të grave për të blerë pronë. Edhe pse dispozitat ligjore mbi trashëgiminë në Kosovë garantojnë të drejtën e barabartë të burrave dhe grave në trashëgimi, gratë në Kosovë përjashtohen apo heqin dorë nga e drejta për të trashëguar, në mes tjerash edhe për shkak të presionit social. Gratë përjashtohen nga e drejta në trashëgimi të pasurisë nga familja ku kanë lindur, për shkak se në disa raste nuk përfshihen në aktin e vdekjes dhe trashëgimia vendoset vetëm për personat të cilët në këtë dokument deklarativ të trashëgimisë, përfshihen si anëtar trashëgues të familjes-zakonisht djemtë. Në disa raste, vajzat refuzojnë të kërkojnë trashëgimi, duke besuar se mund të rrezikojnë raportet me familjarët e tyre.

Sipas një studimi të vitit 2014, 23 përqind e meshkujve dhe 21 përqind e femrave ndërmarrëse në Kosovë janë kategorizuar si *ndërmarrëse 'për mbijetesë'* që do të thotë kanë nisur biznesin ngase nuk kanë pasur mundësi më të mira për të siguruar të ardhura, e jo për shkak të mundësive për ndryshim/zhvillim³⁰. Në këtë raport, theksohet se niveli i ulët i shkollimit dhe mungesa e shkathhtësive është në mesin e faktorëve kyç për këtë orientim. Ndërmarrjet e grave kryesisht janë të fokusuara në sektorin e shërbimeve, që lidhen më shumë me rolin e grave dhe që nuk karakterizohen me vlerë të shtuar, siç janë përgatitja e ushqimit, sallonet e bukurisë/floktari e të ngjashme, që karakterizohen edhe me mundësi të kufizuara për gjenerim të vendeve të reja të punës. Orientimi në këta sektorë mund të ndodhë për shkak se këta sektorë kërkojnë investime më të vogla fikse, në mungesë të guximit, por edhe në mungesë të programeve nxitëse për diversifikim të aktiviteteve ndërmarrëse të grave.

Normat kulturore pengojnë gratë të realizojnë të drejtën në pronë duke përfshirë edhe trashëgiminë, e që si rrjedhojë kufizon qasjen e tyre në financa dhe dobëson gjendjen e tyre ekonomike. Edhe pse ligjërisht, prona e krijuar gjatë jetës bashkëshortore duhet të regjistrohet në emrin e të dy bashkëshortëve, sipas të dhënave, në praktikë, kjo nuk zbatohet. Sipas Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare, në vitin 2016, vetëm 11 përqind të grave kishin në pronësi shtëpi/banesa ndërsa sipas të dhënave nga Regjistrimi i Bujqësisë, në vitin 2014, vetëm 4.9 përqind e tokave bujqësore ishin në pronësi të grave, përkatësisht vetëm 6,388 nga 130,436 pronat³¹.

Përkundër zvogëlimit të normave të kamatës, në Kosovë **qasja në kredi nuk është e lehtë**, kryesisht për shkak të praktikave konservative që bankat aplikojnë për kolateral (Banka Evropiane për Investime, 2016). Sipas Anketës me Ndërmarrje, të realizuar nga Banka Botërore, në vitin 2013, kërkesat për kolateral ishin 299.3 përqind e vlerës së kredisë. Për më tepër, institucionet financiare, kryesisht kërkojnë asete të palëvizshme e rrallë herë të lëvizshme, duke e vështirësuar qasjen në kredi posaçërisht për gra të cilat nuk kanë në pronësi tokë, banesa ose shtëpi,

Në Kosovë, menaxhimi i burimeve bëhet kryesisht nga burrat. Edhe pse gratë përbëjnë një pjesë të rëndësishme të fuqisë punëtore në sektorin e bujqësisë, ato punojnë tokën të cilën nuk e posedojnë dhe për të cilën nuk vendosin vet. Si rezultat, ka mundësi që grantet dhe subvencionet e qeverisë mbështesin sektorë dhe fusha që vlerësohen në nevojë nga burrat, e që me shumë gjasë, lehtësojnë punën e tyre e më pak të grave të angazhuara në këtë sektorë. Në përgjithësi,

30 Global Entrepreneurship Monitor 2014 Global Report

31 ASK, 2016, Gratë dhe Burrat në Kosovë: 2014-2015: <http://ask.rks-gov.net/media/2581/grate-dhe-burrat-shqip-2014-2015.pdf>

trajnimet, informimet dhe këshillimet u ofrohen pronarëve të tokave, e që në masë dërmuese janë meshkuj³². Si pasojë, produktiviteti i punës së burrave rritet, ndërsa gratë punojnë me kosto më të lartë për njësi (matur me kohën e shpenzuar dhe inpute).

SHTYLLA II: Zhvillimi Njerëzor dhe Rolet dhe Marrëdhëniet Gjinore

Gjendja Aktuale

Në këtë pjesë prezantohet situata aktuale në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe mediave në veçanti, dhe marrëdhëniet e përgjithshme socio-kulturore, ekonomike dhe politike të cilat nënvizojnë apo e pengojnë potencialin për zhvillimin njerëzor dhe barazinë gjinore në Kosovë. Marrëdhëniet gjinore nuk trajtohen veçanërisht por trajtohen si praktike shoqërore, politike dhe ekonomike, si dhe qëndrime, të strukturuar dhe të dala nga mundësitë, si dhe mungesa e mundësive, në tri fushat të cilat trajtohen në këtë dokument. Andaj rekomandimet e dala nga analiza e situatës bëjnë ndërlidhje mes tri fushave përbrenda masave të propozuara. Bazuar në analizën e gjendjes aktuale, problemi kryesor për avancimin e barazisë gjinore qëndron te pabarazia dhe përjashtimi strukturor në arsim, shëndetësi dhe media, dhe mos shfrytëzimi adekuat i kapaciteteve njerëzore në fusha të ndryshme të jetës socio-kulturore dhe institucionale, ku që të gjitha e cenojnë arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm njerëzor.

Arsimi

Një numër i marrëdhënieve socio-kulturore, politike dhe ekonomike vazhdojnë të strukturojnë qasjen e pabarabartë sa i përket mundësive të arsimit për vajzat dhe gratë, avancimin në karrierë në sektorin e arsimit, si dhe zhvillimin e planeve mësimore/kurrikulave dhe programeve arsimore që do të identifikonin paragjykimet gjinore dhe do të krijonin një mjedis që mbështet fuqizimin në arsim, por edhe atë shoqëror-politik dhe ekonomik të vajzave dhe grave.


Përkundër normave ligjore për përfaqësimin gjinor në arsimin para-universitar, gjetjet faktike tregojnë se 99.6përqind të edukatoreve në institucione parashkollore janë gra. Me përqind je pak më të lartë në krahasim me burrat në shkollimin fillor të ultë 52.8përqind janë gjithashtu gra. Pjesëmarrja e mësimdhënësve gra bie në vetëm 39.3përqind në shkollimin e mesëm dhe 34.3përqind në atë universitar. Këto të dhëna na shpjen të konkludojmë se **mungesa e zbatimit të ligjit përforcon por edhe përforcohet nga pritjet stereotipike shoqërore dhe vlerat kulturore për gratë dhe burrat për rolet e tyre shoqërore dhe arsimore/edukative**. Si shembull në rrafshin e politik-bërjes dhe vendimmarrjes, MASHT deri me tash (2017) nuk ka pasur asnjë grua ministre. Sipas ASK (Gratë dhe Burrat në Kosovë 2015-2016), në vitin 2014 në postin e ministrit ka qenë 1 burrë dhe 3 të tjerë në postin e zëvendësministrave. **Në MASHT gratë nuk e mbajnë asnjërin nga tetë (8) pozitat vendimmarrëse, ndërsa 15 gra dhe 49 burra kanë poste udhëheqëse (23 përqind gra).**³³ Gjithashtu, burrat marrin 60 përqind të kategorisë ekonomike të mëditjeve dhe pagave nga MASHT-i.

Ligji për Arsimin e Lartë, Neni 2, garanton mundësi të barabarta për personelin në institucionet e arsimit të lartë pa diskriminim. Megjithatë, gjetjet të Statistikat e Arsimit në Kosovë 2015/2016 MASHT shfaqin pabarazi gjinore të stafi akademik ku nga **gjithsej 959 sa janë staf akademik në Universitetin e Prishtinës vetëm 331 (34.3 përqind) janë gra**. Tri Fakultete, ai i Filologjisë, Mjekësisë dhe Edukimit, kanë pjesëmarrje po thuaj të barabartë, (33 nga 70, 124 nga 279, dhe 28 nga 61 janë gra respektivisht). Megjithatë, **burrat dominojnë në pozita më të larta akademike dhe menaxheriale**.

32 Sipas Raportit të Gjelbër të MBPZHR, në vitin 2016, 5,247 fermerë janë trajnuar. Të dhënat nuk janë të ndara sipas gjinisë.

33 Raporti i Hulumtimit: Pjesëmarrja, roli dhe pozita e grave në institucione qendrore, lokale dhe parti politike. ABGJ: 2012, 23.

Figura 1. Struktura gjinore e mësimdhënësve sipas niveleve në arsimin publik dhe privat 2015/2016



Burimi: Statistikat e Arsimit në Kosovë 2015/2016. MASHT: 2016, 38. Të dhënat nuk i përfshijnë të gjitha IAL private.

Sa i përket **veprimtarisë kërkimore-shkencore**, gjithashtu hasim në mungesë të zbatimit të ligjeve përkatëse (Ligji për Veprimtari Kërkimore Shkencore Nr. 04/L-135; Ligji për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020). Përveç dispozitave të dala nga LBGJ, Neni 42 i Ligjit Nr. 04/L-135 për përbërjen dhe zgjedhjen e Këshillit Kombëtar për Shkencë (me përbërje 15 anëtarësh), nën Parimet dhe Objektivat, specifikon se parimet udhëzuese në përkrahjen e shkencës dhe hulumtimeve për organizimin e institucioneve shkencore janë trajtimi i barabartë i meshkujve dhe femrave (Neni 1 Pika 7). Të dhënat tregojnë se përkundër normave ligjore, **gratë në përgjithësi nuk arrijnë të zgjidhen apo përfitojnë nga mundësitë për pjesëmarrje në strukturat e sistemit arsimor.**

Sipas ASK-së shkalla e analfabetizmit në Kosovë në popullsinë e moshës mbi 15 vjeç në vitin 2015 ishte 6.1përqind.³⁴ **Vlerësimi i PKBGJ 2008-2013 tregon se është arritur progres në zvogëlimin e analfabetizmit nga 9.1përqind në vitin 2005 në 5.9përqind në vitin 2013 për vajzat 7-15 vjeçare, dhe nga 14përqind në 7.3përqind për gratë (mbi moshën 15 vjeçare) në zonat rurale.** Të dhënat tregojnë se **përqindja e qytetarëve me arsim të mesëm dhe të lartë ende është e pakënaqshme, e veçanërisht ai i vajzave dhe grave.** Specifikisht, 84.4përqind e vajzave të moshës 15-17 vjeçare janë të regjistruara në shkollë të mesme; **8.8 përqind e vajzave/grave nuk regjistrohen në arsim të mesëm në krahasim me 1.2 përqind të djemve/burrave.** Gjithashtu, **përqindja e grave të moshës 25-64 vjeçare që ka përfunduar arsimin e lartë (terciar) ka mbetur në 8 përqind, ndërsa e burrave 14.3 përqind.**³⁵

Shkalla e **tranzicionit në arsimin e mesëm të ulët** për vitin 2015/15 ka qenë 97.8përqind dhe është për 1përqind më e ulët se në vitin paraprak. Ndërsa, dallimi gjinor është më i vogël, nga 1.3përqind ka rënë në 0.6përqind.³⁶ Mirëpo, **ka rënie të përgjithshme të shkallës së tranzicionit nga arsimi i mesëm i ulët në atë të mesëm të lartë nga 97.5 përqind në 92.5 përqind.**

Përfshirja e fëmijëve të moshës 0-6 vjeç në Kosovë në programe arsimore është e krahasueshme me nivelin e përfshirjes në rajon por nën synimin prej 95 përqind të BE-së për vitin 2020; në Kosovë 74 përqind e fëmijë ndjekin arsim parafillor (5-6vjeç). **Shkalla bruto e regjistrimit (SHBR) në arsimin parashkollor (0-5 vjeç) është 3.5përqind (3.6përqind djem dhe 3.4përqind**

³⁴ Gratë dhe burrat në Kosovë. ASK: 2016, 6.

³⁵ Vlerësimi i PKBGJ 2008-2013. ABGJ:2016, 32.

³⁶ Raport Vjetor Statistikor me Tregues Arsimor 2015/16. ASK: 2017.

vajza). SHBR në arsimin parafillor (0-6 vjeç) është 16.43 përqind (rritje për 0.7 përqind nga viti 2014) - 16.66 përqind djem dhe 16.19 përqind vajza.³⁷ Dallime të mëdha ekzistojnë ndërmjet zonave urbane dhe rurale, ku në zona rurale përfshirja është shumë e ulët. Një nga faktorët të cilët ndikojnë në numrin e vogël të fëmijëve në arsimin parashkollor është **mungesa apo numri i vogël i institucioneve publike para-shkollore.** Megjithatë, ky faktor ndërthuret edhe me shkallën e lartë të papunësisë tek gratë, buxhetin e vogël shtetëror dedikuar arsimit (2.7përqind të buxhetit të Kosovës)³⁸, si dhe mos zbatimin e buxhetimit gjinor ndër sektorët e ndryshëm, posaçërisht atij në nivel komunal. Gjithsejtë, 4.7përqind e fëmijëve mbesin jashtë arsimit fillor dhe të mesëm të ulët; 4.6 përqind e vajzave dhe 4.9 përqind e djemve.

Tabela 6. Numri i institucioneve edukative-arsimore publike në Kosovë

Niveli	Amë	Par. ndar	Gjithsej	
Parashkollor/Çerdhe		36	7	43
Fillore/mesme e ulte		633	336	969
I mesëm i lartë		104	15	119
Shk. Speciale		6	0	6
Gjithsej		779	358	1,137

Përmbledhje e Raportit të Punës së Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për Vitin 2015. MASHT: 2016, f.35

Në arsimin parafillor vetëm 4.3 përqind e fëmijëve të regjistruar kanë qenë të etnisë jo-Shqiptare, ndërsa vetëm 1.6përqind nga komunitetet Rome, Ashkali dhe Egjiptas. Në arsimin fillor-të mesëm të ulët, për vitin 2015/2016, nga 258, 464 nxënës në total 5,331 janë të komuniteteve Rome, Ashkali, dhe Egjiptase, ose 2.06 përqind nga përqindja e përgjithshme.³⁹ Një numër i madh i vajzave, posaçërisht i atyre nga komunitetet e marginalizuara si ato Rome, Ashkallike dhe Egjiptase, mbesin jashtë institucioneve shkollore në të gjitha nivelet, e veçanërisht në arsim të lartë. Në përputhshmëri me Planin Strategjik për Arsim në Kosovë 2017-2021 (rezultati 1.4) përfshirja e fëmijëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas në arsimin fillor planifikohet të rritet për 10 përqind, ndërsa në arsimin e mesëm të ultë dhe të lartë për 20 përqind.

Sa i përket përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta të dhënat ende konsiderohen të pakompletuara (nuk është kryer vlerësimi i të gjithë nxënësve), mirëpo raportohet se shkalla bruto e përfshirjes së vajzave me nevoja të veçanta në nivelet e arsimit fillor dhe mesëm të ulët (klasat 1-9) është 37 përqind ndërsa në arsimin e mesëm të lartë (klasat 10 - 12) bie në 18 përqind. Vajzat me aftësi e kufizuara hasin në më shumë vështirësi se sa djemtë.

Gjithashtu, vijueshmëria e vajzave/grave në studime universitare krahasuar me vijueshmëri ne shkollimin para universitar shënon rënie. Në arsimin e lartë ekziston një pabarazi në regjistrimin e studentëve në baza gjinore (Tabela 8), si dhe në përfaqësim në fushat e ndryshme të studimit. Megjithatë, të dhënat sipër tregojnë se më shumë gra se burra diplomojnë në të dyja nivelet.

Edhe pse në Universitetin e Prishtinës regjistrohen më shumë gra se burra, në përgjithësi universitetin e ndjekin 49përqind gra dhe 51përqind burra, dallim i dukshëm gjinor vërehet në kolegjet dhe universitetet private ku 59.69 përqind janë meshkuj dhe 40.31 përqind femra. Shihet se ka preferencë gjinore ndaj djemve në financimin privat të arsimit të fëmijëve. Mungojnë të dhënat sipas gjinisë për shpërndarjen e bursave.


³⁷ Raport Vjetor Statistikor me Tregues Arsimor 2015/16. ASK: 2017, 9.

³⁸ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, marrë nga: <https://mf.rks-gov.net/sq-al/Buxheti/Buxheti-i-Republikes-se-Kosoves/Buxheti-qendrore>. Ndërsa, si PSAK ashtu edhe Plani i Cilësisë i referohen shumë nga viti 2012 për të treguar rritje (buxheti I atëhershëm ishte 4.1%).

³⁹ Ibid, 32.

Gjetjet e paraqitura poshtë tregojnë se **85përqind e studenteve janë të orientuara në studime të edukimit, dhe me përqindje më të lartë në shëndetësi (75 përqind), si dhe studime humanistike dhe arte (69përqind).** Në fushat tjera, si shkencat natyrore, teknike, et., burrat janë të një përqindjeje më të madhe. Nga analizat ekzistuese kuptohet se **vajzat dhe gratë preferojnë sektorin publik të punësimit** (punësim afat-gjatë dhe mundësi për menaxhim të detyrimeve të jetës publike/private) gjë që njëjtë kontribuon në përzgjedhjen e fushës së studimit.

Figura 2. Orientimi i studentëve në fusha të studimit sipas gjinisë 2014/2015



Tekstet shkollore janë të dominuara nga autorë burra, ndërsa ekspertet gra, të fushave të ndryshme, rrallë herë konsultohen. Studimet ekzistuese tregojnë se për vitin 2007, nga 14 autorët e librave 12 ishin burra; nga 323 tekste të analizuar 72 përqind janë të shkruara nga burrat dhe vetëm 7 përqind nga gratë (të tjerat ishin pa autorë). Nga 128 ilustrimet, 120 ishin të personazheve burra dhe vetëm 8 gra. Në 323 njësitë mësimore, vetëm 45 përshkruajnë gra në profesione të ndryshme (duke përfshirë këtu edhe amvisërinë) ndërsa 187 përshkruajnë burra në profesione.⁴⁰ Sipas QKSGJ, nga të gjitha tekstet e analizuar, autorët e tyre janë 74 përqind burra dhe vetëm 26 përqind gra, gjithashtu, “ushtrimet e teksteve shkollore favorizojnë më shumë burrat se gratë. Prej 2.292 figurave gjinore, vetëm 885 janë femra të paraqitura në ilustrimet e teksteve shkollore dhe 1.407 figura të meshkujve.”⁴¹

Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Para-Universitar në Republikën e Kosovës, Neni 2.5. cek përgatitjen e nxënësit për jetesë të përgjegjshme në frymën e mirëkuptimit, të paqes, tolerancës, barazisë gjinore dhe në miqësi me pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës, e më gjerë. **Formulimi tek Neni 2.5 për qëllimet e ligjit po edhe nenet tjera kanë mangësi gjuhën me ndjeshmëri gjinore;** hasim i nxënësit, mësimdhënësit, kandidatët, etj. Ngjashëm, është tek Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional Nr. 04/L-138, Neni 2, “1.1. Arsimi dhe aftësimi profesional (AAP) - synon të pajisë nxënësit/kandidatët me njohuri, aftësi praktike.” i njëjti Ligj, nuk përfshinë gjininë si kategori të grupeve të cenuara në mbrojtje ligjore dhe i referohet vetëm moshës.

40 Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), Barazia gjinore në librat e leximit në arsimin e detyruar nëntëvjeçar në Kosovë, 2007.

41 Auditimi i Çështjeve Gjinore në Sistemin Arsimor. QKSGJ: 2007, f. 6.

Sfidat të cilat duhet adresuar në fushën e arsimit

Sfidat kryesore në sistemi arsimor të evidentuara janë të përmbledhura në vijim: qasja, mundësitë dhe shfrytëzimi i pabarabartë në vija gjinore është i dukshëm dhe strukturohet nga planifikimi, menaxhimi dhe financimi i sistemit arsimor; diskriminimi gjinor evidentohet në punësim dhe avancimin profesional dhe akademik, në plan programet dhe materialet arsimore, si dhe në zbatimin e tyre; mungesa e infrastrukturës (specifikisht institucioneve parashkollore, transportit) dhe e sigurisë (dhuna në shkollë, ngacmimi seksual) i kontribuon pozitës së marginalizuar të vajzave dhe grave (braktisje e shkollimit, mungesë e shkathtësive për punë, varësi ekonomike); dhe arsim formal profesional që reflekton stereotipat ekzistuese gjinore mbi ndarjen e punës dhe nuk përmban zgjedhje për marginalizimin e vajzave dhe grave në tregun e punës, ndërsa mungojë politika mbi arsimin joformal. Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë qasje të kufizuara në arsim. Ata përballen me stigmë shoqërore rreth aftësisë së kufizuar, me mungesë të mësimdhënësve mbështetës (të paraparë me ligj) dhe me mungesë të shërbimeve mbështetëse për nevojat e tyre specifike.

Në arsim mungesa e zbatimit të ligjit, specifikisht Ligji për Barazi Gjinore (LBGJ) Nr. 05/L-020, evidentohet në përzgjedhje të stafit në të gjitha nivelet, përbërjen e komisioneve apo njësive dhe pozitive tjera në marrjen e politikave dhe vendimeve. Përkundër mekanizmave për integrim dhe përfaqësim gjinor, si dhe politikave që synojnë monitorim dhe llogaridhënie në cilësi, barazia gjinore nuk konsiderohet si parim formësues dhe dispozitat ligjore nuk zbatohen, dhe rezultojnë në sistem arsimor të kualitetit të ulët. **Përbrenda institucioneve ka mungesë të kapaciteteve për ti zbatuar mekanizmat ekzistues për arritjen e barazisë gjinore.** Barazia gjinore shpeshherë keqkuptohet apo anashkalohet andaj ekziston nevoja për ta përkthyer në vazhdimësi barazinë gjinore si qasje të domosdoshme në krijimin e cilësisë (së vetë institucioneve, praktikave arsimore, dhe përmbajtjes) dhe avancimin demokratik shoqëror. Përveç kësaj, plan-programet dhe tekstet mësimore vazhdojnë të përmbajnë dhe ruajnë stereotipa gjinore, gjuha dhe praktikat pedagogjike janë diskriminuese, gjë që legjitimon pabarazitë ekzistuese.

Arsimi i lartë është gati tërësisht i verbër ndaj studimeve gjinore dhe obligimeve ligjore për të krijuar mundësi të barabarta përkundër nevojës së tregut për ekspert të gjinisë në lëmi të ndryshme (ekonomi, TIK, politik-bërje, shoqëri civile, edukim, burime njerëzore, bujqësi, ndërmarrësi). Njëjtë, shpërndarja gjinore sipas niveleve në arsim në institucione publike dhe private nuk dallon pasi që burrat janë ata që dominojnë me numër si staf akademik. Mungesa e zbatimit të normave dhe mekanizmave ligjore, relacionet dhe vlerat socio-kulturore diskriminuese jo-formalisht të institucionalizuar, bëjnë që **burrat të favorizohen gjatë pjesëmarrjes dhe përzgjedhjes së stafit. Universiteti i Prishtinës nuk posedon politika specifike të zbatueshme që synojnë të përmirësojnë pozitën e grave** – pjesëmarrja në vendimmarrje, avancimi i stafit, agjenda e hulumtimit, parandalimin e ngacmimit seksual – dhe si rrjedhojë edhe pabarazinë gjinore në përgjithësi. E njëjta vlen edhe për MASHT.

Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional Nr. 04/L-138, nuk përfshinë gjininë si kategori të grupeve të cenuara në mbrojtje ligjore dhe i referohet vetëm moshës: “Mundësi të barabarta për të gjithë studentët dhe personelin në institucionet e arsimit të lartë pa diskriminim...Nuk do të ketë kufizim moshe për t’u regjistruar apo për të fituar kualifikim të arsimit të lartë.”

Indeksi gjinor për mësimdhënës që marrin pjesë në programe të zhvillimit dhe marrin licencë synon paritet. Sa i përket menaxhimit të sektorit nuk janë përcaktuar indikator për arritje e paritetit të përcaktuar me Ligjin për Barazi Gjinore. Njëjtë **nuk përcaktohen synime apo aktivitete për arritje të barazisë gjinore në mekanizmat e punësimit dhe zhvillimit të karrierës.**

Të gjitha shifrat flasin për vazhdim të **braktisjes së shkollimit të fëmijëve të marginalizuar për nga kushtet ekonomike, etnike, dhe aftësive të kufizuara.**⁴² **Gjinia është shpesh shënjesuesi**

⁴² Evaluation Report: Kosovo Education Strategic Plan 2011-2015. MASHT: 2015.

i përbashkët për arsyet e braktisjes, përfshirë çështje të sigurisë, mungesës së transportit (largësia nga shkolla), pritjeve shoqërore (angazhimi në punë të shtëpisë apo ekonominë familjare në përgjithësi), dhuna në baza gjinore në shkolla. Andaj, dështimi për të mbledhur të dhëna në bazë të gjinisë figuron si një nga rreziqet e parapara në zbatimin e Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017.

Te rezultati 6.3. (Shkollat kanë krijuar mjedise të sigurta, miqësore dhe të shëndetshme për të gjithë), **nuk përfshihet edukimi seksual i cili do të mund të trajtohej si pjesë e promovimit të shëndetit, dhe të trajtoj shëndetin riprodhues dhe dhunën në baza gjinore.** Gjinia figuron në planin e veprimit si pjesë e Objektivit 1. Pjesëmarrja dhe Gjithë përfshirja dhe Objektiv 6 Arsimit dhe Aftësimi Profesional (AAP) dhe Arsimit i të rriturve. Rezultati 1.8. konsideron gjininë si vlerë të sigurimit të diversitetit por **nuk i trajton barrierat të cilat e ndalojnë integrimin gjinor në rritjen e zhvillimit të përgjithshëm njerëzor.** Plani i veprimi synon të “rritet për 30përqind regjistrimi i nxënësve në drejtimet deficitare dhe për 20përqind numri i femrave në drejtimet teknike.” Gjuha e tillë është tregues i konceptimeve dominuese mbi gjininë, ku djemtë/burrat/meshkujt janë kategori normative ndërsa vajzat/gratë/femrat janë tjetri i marginalizuar. Ky binaritet, i cili biologjizon gjininë dhe e barazon atë me konceptimet mbi seksin, është heteronormativ por edhe përjashtues (karakteristikë jo vetëm e këtij dokumenti por edhe praktikave të përgjithshme shoqërore). PSAK parasheh që në kuadër të aktiviteteve për ndërtimin e kapaciteteve do t’i kushtohet kujdes **dhunës së bazuar në gjini brenda shkollave, grumbullimit të dhënave në baza gjinore** dhe të mbështetjet në përdorimin e tyre në arritjen e objektivave të përcaktuara (zhvillimi i indekseve të paritetit në aftësimin profesional të mësimdhënësve, të pjesëmarrjes në AAP, dhe fushatave për vetëdijesim).

PSAK përqendrohet në **rritjen e vijueshmërisë në nivelin parafillor por jo atë parashkollor.** Argumenti është se kufizimet buxhetore nuk lejojnë ngritjen e institucioneve të nevojshme publike parashkollore. Duke kujtuar se kujdesi për fëmijët në mungesë të institucioneve parashkollore shndërrohet në barrë të grave kjo politikë do ta pengoj rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës apo avancimin e tyre në karrierë, kontribuon në përforcimin e dallimeve socio-ekonomike dhe qasjes në shërbime në baza socio-ekonomike (një shtresë e vogël mund ti shfrytëzojë institucionet private), dhe të varësive të grave nga strukturat kulturore patriarkale. Ky synim bie ndesh me Objektivat e Barcelonës dhe SKZH i cili synon “që të rritet numri i fëmijëve që ndjekin arsim parashkollor për 5,000 fëmijë në vit deri në vitin 2021” me ndërtimin e kopshteve publike dhe rritjen e përfshirjes në institucione private.⁴³

Nuk ka ndonjë analizë nga perspektiva gjinore mbi planet mësimore dhe tekstet shkollore të prodhuar nga institucionet përkatëse. MASHT prodhon analiza statistikore dhe përdor gjininë si matës të progresit por kryesisht është e fokusuar në **përfaqësimin numerik.** Në të kaluarën MASHT ka angazhuar me anë të projekteve ndërkombëtare ekspert nga fusha e arsimit dhe gjinisë por **nuk ka krijuar kapacitete institucionale për draftim, vlerësim, trajnim, planifikim dhe politik-bërje, përveç zyrtareve për barazi gjinore të cilat e kanë mandatin e përkufizuar me Ligjin për Barazi Gjinore Nr. 05/L -020.** Organizatat jo-qeveritare, njësitë akademike të fokusuara në studime gjinore, si dhe organizata mediale kanë cekë dhe publikuar analiza për paragjykimet dhe stereotipat gjinor, si dhe **tekste diskriminuese në plan-programet shkollore.** Megjithatë, përveç auditimit të çështjeve gjinore në sistemin e arsimit të kryer nga QKSGJ (2007) dhe KEC (2007), nuk është prodhuar ndonjë analizë mbi përfaqësimin gjinor nga aspekti i përmbajtjes.⁴⁴ Në tërë Universitetin e Prishtinës, mund të identifikohen vetëm shtatë lëndë të cilat e adresojnë gjininë në mënyrë specifike.

Nuk ka ndonjë studim kualitativ mbi faktorët të cilët ndikojnë mbi përzgjedhjen e fushave të studimit nga aspekti gjinor, apo edhe mbi krijimin e mundësive për pjesëmarrje dhe

43 Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021. Qeveria, Republika e Kosovës: 2016, f. 12.

44 QKSGJ. Auditimi i Çështjeve Gjinore në Sistemin Arsimor. QKSGJ: 2007. BIRN gjithashtu ka publikuar një analizë të teksteve të klasave VI-IX në vitin 2013, ku del që gratë janë ose të papranishme ose të prezantuara sipas normave dhe stereotipeve patriarkale. Problemet dhe të Metat e Teksteve Shkollore: Analizë e teksteve shkollore të Kosovës të ciklit të Shkollës së Mesme të Ulët (klasat VI, VII, VIII dhe IX). BIRN: 2013. http://jetanekosove.com/repository/docs/Tekstet_ANALIZA_shqip_339320.pdf

avancim të vajzave dhe grave në sistemin arsimor (si studente, mësimdhënëse, udhëheqëse, krijuese). MASHT në dhjetor 2015 ka fuqizuar Udhëzimin Administrativ për Ndarjen e Bursave. Studimi i RrGK (2018)⁴⁵, thekson se **stereotipat gjinorë profesionalë dhe pagat më të ulëta duket se frenojnë gatishmërinë e burrave që të studiojnë në universitet për mësimdhënës të ciklit të arsimit parauniversitar. Perceptimet kulturore të roleve zakonisht mashkullore dhe femërore (p.sh. burrat si profesorë, gratë si ofruese të kujdesit) përforcohen nga brezi në brez, duke u konfirmuar nga mungesa e shëmbëlltyrave mashkullore në arsimin e hershëm dhe mësimdhënëset femra në shkollat e mesme.**

Kosova gjithashtu ka edhe **Ligjin për Botimin e Teksteve Shkollore, Mjeteve Mësimore, Lekturës Shkollore dhe të Dokumentacionit Pedagogjik Nr. 02/L-67**. Ky ligj cakton disa parime dhe norma të barazisë por të cilat **nuk janë të përcjella me mekanizma për zbatim**. Neni 3.2. i këtij ligji cekë se “Nuk lejohen tekstet shkollore, mjetet mësimore, lekturat shkollore dhe dokumentacioni pedagogjik që bëjnë propagandë kundër Kosovës, që cenojnë të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore dhe që nxisin urrejtje politike, nacionale dhe fetare.” **Kjo mundësi ligjore, në bazë të raporteve të pavarura, nuk është shfrytëzuar për të gjitha kategoritë që janë listuar posaçërisht sa i përket barazisë gjinore.**

SKZH-ja adreson përfshirjen e fëmijëve në institucione parashkollore si masë për të sfiduar papunësinë e femrave. Gjithëpërfshirja në shkollimin parafillor ka rol vendimtar në performancën më të mirë në fazat e tjera të arsimit. Ajo gjithashtu ka efekt pozitiv në rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, teksa mungesa e institucioneve parashkollore bën që ato të detyrohen të mbeten në shtëpi. Mirëpo, **vendosja e kujdesit dhe arsimit të fëmijëve vetëm në relacion me punën e grave më tutje i përforcon, dhe institucionalizon, normat ekzistuese patriarkale**

Ligji për Barazi Gjinore Nr. 05/L -020 obligon institucionet e Kosovës të sigurojnë që të gjitha politikat, duke përfshirë buxhetet, të përfshijnë analizën gjinore. “Kjo do të thotë se organizatat buxhetore duhet të kryejnë analiza gjinore për të vlerësuar shkallën në të cilën programet e tyre i kanë plotësuar nevojat e grave, burrave, djemve dhe vajzave ndryshe në të kaluarën, dhe për ta përdorur këtë informacion më pas për ta përfshirë në planifikimin buxhetor për të ardhmen.”⁴⁶ Krahas dispozitave tjera **Neni 21 Edukimi për barazinë gjinore**, i Ligjit për Barazi Gjinore, cekë: Në shkolla dhe institucione të tjera arsimore mjetet mësimore të përdorura duhet të bazohen në barazinë gjinore dhe edukimin për barazinë gjinore duhet përfshirë në kurrikulat shkollore në të gjitha nivelet. 2. Përgatitja, miratimi dhe zbatimi i programit arsimor – edukativ, hartimit të materialeve, teksteve shkollore dhe rishikimit të materialeve dhe teksteve ekzistuese duhet të bëhet me përfshirjen e perspektivës gjinore dhe eliminimin e stereotipeve negative, paragjyqimeve, praktikave zakonore dhe praktikave tjera, që janë në kundërshtim me parimin e barazisë gjinore. 3. Përfshirja në programet e shkollave aktivitete edukative dhe trajnuese që synojnë sensibilizimin.

Shëndetësia

Përderisa shëndetësia përbën sferë të rëndësishme ekonomike (konsideruar kosto efikasitetin si parim strukturues të Strategjisë Sektoriale për Shëndetësi 2017-2021) ajo nuk mund të trajtohet pa e adresuar ndërlidhjen e shëndetësisë me të drejtat dhe zhvillimin njerëzor. Në të vërtetë, Kombet e Bashkuara si dhe agjenci tjera ndërkombëtare konsiderojnë se politikat shëndetësore dhe arsimore janë themel për zhvillim. Pa politika të cilat synojnë ti zvogëlojnë pabarazitë në shëndetësi edhe zhvillimi i gjithmbarshëm do të jetë i pamundur. Kjo paraqet sfidë për sistemin shëndetësor në Kosovë ku qeverisja dhe menaxhimi i sistemit shëndetësor - me efikasitet dhe produktivitet të ulët dhe informalitet të lartë - vazhdon të jetë tejet i dobët. Të gjitha këto sfida i prekin vajzat dhe gratë, si dhe minoritetet etnike, në mënyrë të veçantë, dhe si pasojë e pozitës së tyre socio-ekonomike i vendos ato në pozitë të pafavorshme.

⁴⁵ RrGK, Analiza Gjinore e Kosovës, 2018, at: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20181003170921410.pdf>

⁴⁶ Donjeta Morina dhe Nicole Farnsworth. Buxhetimi drejt një arsimit më të mire: Analizë e përgjithshme e shpenzimeve dhe shërbimeve në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. RrGGK 2016: Prishtinë, 10.

Jetëgjatësia në Kosovë ende mbetet e shkurtë (76.7 vite; në vitin 2011 ishte vlerësuar të jetë 74.1 vite për meshkuj, kurse për femra 79.4 vite). Kjo është pjesërisht pasojë e varfërisë, por gjithashtu edhe e pasojë e faktorëve ambiental (e reflektuar në prevalencë të lartë e sëmundjeve të frymëmarrjes).⁴⁷ **Kostoja e ndikimit të faktorëve të mjedisit në shëndet**, përfshirë ujin dhe kanalizimin, është 222.9 milion € në vit. Përveç koston financiare (5.3përqind të BPV në vitin 2010) kjo kosto përkthehet edhe rënie të kualitetit të jetës. Ndotja e ajrit në natyrë konsiderohet si faktori me ndikimin më të madh shëndetësor (97,6 milion € në vit) duke shkaktuar 852 vdekje të parakohshme, 318 raste të reja të bronkitit kronik, 605 pranime spitalore dhe 111,900 vizita emergjente (ndotja nga plumbi është faktori i dytë, i vlerësuar të kushtoj 67.9 milion €). **E gjithë kjo përbën kosto që është më e lartë se sa të gjitha investimet që bëhen për shëndetin në Kosovë çdo vit.**⁴⁸

Sipas Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë, nga Buletini vjetor i IKSHPK-së i sëmundjeve ngjitëse janë raportuar 127,449 (7374.5/100,000 banorë) raste me sëmundje ngjitëse në vitin 2015 në Kosovë, të cilat janë kërcënim permanent për popullatën.⁴⁹ **Sëmundjet që përhapen me ujë dhe ushqim vazhdojnë të prijnë me numrin më të lartë të rasteve dhe kërkojnë hulumtim të mëtutjeshëm të faktorëve të riskut. Sa i përket imunizimit në përgjithësi ka arritje të konsiderueshme (mbi 95 përqind) mirëpo imunizimi te komuniteti Roma, Egjiptas dhe Ashkali mbetet i ulët dhe është përcjellë me vaksinin plotësues. Gjithashtu, këto komunitete janë posaçërisht të privuara nga qasja në infrastrukturë (ujë, kanalizim, energji elektrike), të prekura nga ndotja e ambientit, duke krijuar rrezikshmëri të lartë për shëndetin e tyre.**

Rrjeti publik i institucioneve shëndetësore përbëhet nga gjithsejtë 429 institucione, ku secila komunë e Kosovës ka Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) si njësi kryesore, me njësi të saj përbërëse: Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF).⁵⁰ **Ministria e Shëndetësisë konsideron se Kosova posedon infrastrukturë të mjaftueshme por e cila do të plotësohet sipas prioriteteve të përcaktuara afatmesme.**⁵¹ Vlerësimet ekzistuese (përveç ato të OJQ-ve) nuk tregojnë për qasshmërinë apo edhe cilësinë e shërbimeve për qytetarëve që jetojnë në zonat rurale, **mirëpo ngritja e nivelit të shërbimeve është evidentuar si e nevojshme.**

Nga buxheti i përgjithshëm publik për shëndetësi vetëm 28 përqind është buxhet i drejtpërdrejtë i lidhur me pacientin, me vetëm 23 € në vit që janë në dispozicion për diagnostikim dhe trajtim për kokë banori. Pjesa më e madhe e shpenzimeve është për kosto fikse dhe vetëm 32 përqind është për mallra dhe shërbime. Pjesa më e madhe e pacientëve, 88.4 përqind e atyre që kërkojnë kujdes në institucione shëndetësore, kanë paguar nga xhepi. Nuk ka të dhëna të ndara sipas gjinisë, moshës, vendbanimit, etj. të cilat do të mundësonin planifikim dhe veprim strategjik.

Sa i përket shpërndarjes së konsumit në Kosovë pjesa më e madhe e buxhetit të ekonomive familjare në periudhën 2014-2016 ka shpenzuar në ushqim dhe banim. Mirëpo, **shpenzimet për shëndetësinë në vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 dukshëm kanë pasur rritje në total, posaçërisht në vendbanime rurale** (në total 10përqind dhe në vendbanime rurale 26përqind), ndërsa në vendbanime urbane vërehet rënie konstante gjatë viteve 2014-2016. **Nuk është e qartë nëse shkak i rritjes ka të bëjë me nevojën e shtuar** (edhe pse konstatohet se gjendja e përgjithshme e popullatë konsiderohet si e mirë) **apo vetëdijesim. Nga vlerësimet ekzistuese këto të dhëna flasin edhe për shfrytëzim të ulët të shërbimeve parandaluese.**

Gjithashtu, banorët e zonave rurale shpenzojnë më shumë për transport, gjë që mund të

47 Consumption: Poverty in the Republic of Kosova 2011. World Bank: 2011, f. 9.

48 Ibid: 24


49 Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021. MSh 2017: 21.

50 Ibid: 29.

51 "Ministria e Shëndetësisë në Periudhën afat mesme ka prioritet fuqizimin e shërbimeve emergjente, pediatrike, onkologjike/radiologjike, ortopedike dhe traumatologjike, kardiologjike, kardiologjike invazive si dhe kardiokirurgjike për të rritur dhe fëmijë, kapaciteteve në mikrobiologji klinike, shërbimeve fiziatrike dhe atyre të mjekësisë sportive si dhe inicimin e zhvillimit të kapaciteteve biomjekësore." Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021. MSh 2017: 39.

konsiderohet si faktor që ndikon në vendimet për t'iu qasur shërbimeve shëndetësore. Sipas një vlerësimi, në mesin e banorëve të zonave rurale me sigurim private vetëm 20përqind janë gra. **Gratë në zonat rurale ballafaqohen edhe me norma socio-kulturore të cilat e pengojnë qasjen e tyre në shërbime shëndetësore** (marrja e lejes, aftësia për të udhëtuar, mospranimi i marrjes së shërbimeve). Kjo gjithashtu ndikon në marrjen e **shërbimeve pediatrike** meqë gratë janë kryesisht të obliguara të kujdesen për shëndetin e fëmijëve.

Figura 3. Shpenzimet për shëndetësi të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2014-2016, në Euro



Burimi: ASK, 2018, Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare 2017

Në përgjithësi, gratë dhe burrat përballen me pengesa të ngjashme në qasjen në kujdesin shëndetësor. Mirëpo, **gratë përjetojnë më shumë barrierë socio-kulturore.** Gratë në zonat rurale ballafaqohen më tepër me pengesa financiare, kulturore dhe marrëdhënie pacient-ofrues të shërbimit në qasjen tek shërbimi shëndetësor se burrat apo gratë në zonat urbane. Gratë boshnjake dhe turke kanë më tepër tendencë të ballafaqimit me pengesa se burrat e kombësisë së njëjtë, ndërsa gratë dhe burrat Rom, Ashkali, Egjiptas dhe Goran ballafaqohen më tepër me pengesa etnike, gjeografike, financiare dhe kulturore në qasjen në kujdes shëndetësor.⁵² Ekzistojnë dallime në shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore në bazë të përkatësisë etnike dhe gjinisë⁵³. Serbët dhe goranët kanë tendencë të shfrytëzojnë shumicën e shërbimeve, ndërsa shqiptarët dhe boshnjakët i shfrytëzojnë më së paku. Burrat goranë shfrytëzojnë më shumë shërbime sesa gratë gorane. Gratë shqiptare dhe turke shfrytëzojnë më shumë shërbime sesa burrat e të njëjtës përkatësi etnike. Në këtë drejtim nuk ekzistojnë dallime të konsiderueshme në mes të grave dhe burrave romë, ashkali dhe egjiptianë. Disa nga nënat rome, ashkalie dhe egjiptiane lindin në shtëpi, shpesh në kushte jo sanitare. Si rezultat, shumë fëmijë nuk janë të regjistruar nga shteti. Kjo ndikon në qasjen në kujdesin shëndetësor më vonë në jetë, pasi personat e paregjistruar nuk mund të marrin asistencë sociale ose të kenë qasje në shërbimet shëndetësore publike.

Vlerësimet e OJQ vë dëshmojnë se gratë e zonave rurale dhe ato me më pak arsim formal kanë **marrëdhënie më të dobëta me ofruesit e shërbimeve sesa gratë e zonave urbane.** Vlerësimet ekzistuese përfshijnë nevojat e personave me aftësi të kufizuara dhe adresohen në politika, mirëpo komuniteti i LBGTI është tërësisht i përjashtuar. Mungesa e përkrahjes për grupet e ndjeshme (posaçërisht adoleshentët dhe personat LGBTI), i kontribuon marginalizimit të mëtejshëm të tyre përfshirë dëmet në gjendjen e tyre shëndetësore.

Sipas vlerësimit të kryer për hartim të Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë 2017-2021, shkalla ende e lartë e sëmundjeve që kanë të bëjnë me gjendjet perinatale është shqetësuese, duke pasqyruar faktin se shumica e vajzave dhe grave janë të moshës riprodhuese. Gjithashtu

⁵² Farnsworth, Nicole, Dr. Katja Goebels dhe Rina Ajeti. Qasja në Kujdesin Shëndetësor në Kosovë. RrGGK: 2016.

⁵³ RrGGK, Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë, 2016, në: <http://www.womensnetwork.org/documents/20170206150329907.pdf>.

për vajzat dhe gratë në moshën 15-49 vjeç, shkalla më e lartë e sëmundje-shmërisë ishte për sëmundjet e sistemit uro gjenital me 10.9përqind.⁵⁴ Sa i përket **infeksioneve seksualisht të transmetueshme (IST) dhe numrit të vogël të rasteve të raportuara**, sfidë mbetet paraqitja e rasteve nga të gjitha institucionet shëndetësore si publike ashtu edhe private. **Skriningu për HPV nuk trajtohet nga Strategjia Sektoriale për Shëndetësi përkundër nevojës së evidentuar.**

Shkalla e **vdekshmërisë perinatale** për vitin 2015 ishte 12.13përqind (për të porsalindurit me peshë ≥ 500 g apo ≥ 22 javë të gestacioni) dhe tregon rënie të ndjeshme krahasuar me vitin 2000, ku shkalla e vdekshmërisë perinatale ka qenë 29.1përqind (në vitin 2012 ishte 17.34përqind, në vitin 2013 ishte 16.26përqind, në vitin 2014 ishte 11.99përqind). **Prematuriteti vazhdon të jetë shkaku më i shpeshtë i vdekjeve të hershme neonatale me 56 përqind, pasuar nga anomalitë kongjenitale me 15përqind dhe asfiksioni me 13 përqind, kurse infeksionet janë përgjegjëse për 7përqind të vdekjeve të hershme neonatale.**⁵⁵ Sa i përket **vdekshmërisë maternale**, bazuar në të dhënat e Raportit Perinatal 2015, nga Institucionet shëndetësore janë raportuar gjithsejtë 65 vdekje prej vitit 2000 deri në vitin 2015. **Prej vitit 2000-2014 shkalla e vdekjeve maternale ka qenë 14.3 për 100,000 lindje, përdërisa në vitet 2013 dhe 2014, nuk ka pasur raportim të vdekjeve maternale. Kjo pasqyrë e situatës tregon për përmirësim të limituar të situatës.**

Sipas **Ligjit për Shëndetin Riprodhues Nr. 02/L-76, neni 3**, Ministria e Shëndetësisë organizon dhe koordinon veprimtaritë në fusha të ndryshme të shëndetit sikurse **veprimtari edukimi dhe këshillimi mbi shëndetin seksual dhe riprodhues** përgjatë gjithë ciklit jetësor seksual përfshi edhe kategori të veçanta (e adoleshente) mirëpo këto **shërbime nuk arrijnë në shkolla dhe nuk trajtohen në politikat e sektorëve të tjerë (p.sh. arsim).** Numri i rasteve të lindjeve në moshë adoleshente, 14-19 vjeç, (761 raste për vitin 2017) mund të duket i vogël por nëse përkthehen në numër të paraleleve shkollore ato përbëjnë 25 klasë me nga 30 nxënës.⁵⁶

Adoleshentët përbëjnë kategori posaçërisht të ndjeshme ku është observuar ushtrimi i presionit për të pasur marrëdhënie seksuale, martesat e hershme dhe të dhunshme, dhe presioni për të mos përdorur kontraceptiv. Në mungesë të kujdesit adekuat dhe shërbimeve këshillëdhënëse, por edhe edukative, si dhe normave patriarkale në familje, vajzat adoleshente shpesh herë nuk e gjejnë përkrahjen e duhur.

Gjithashtu, siç është dëshmuar, **dhuna në familje** përbën edhe problem shëndetësor duke përfshirë shërbimet për **identifikim, trajtim dhe referim të viktimës, si dhe përkrahjen për shëndetin mendor.** Mungojnë shërbime të specializuara shëndetësore për viktimat e dhunës seksuale.

Kosova cilësohet **me shkallë të lartë mesatare të lindshmërisë.** Koeficienti mesatar i natalitetit për periudhën 2006-2011 ishte 17.9 përqind, me një rritje mesatare në vit prej 0.5 përqind. Kjo vlerë ishte 16,3 përqind në vitin 2006 dhe 19.8 përqind në vitin 2011. Numri i lindjeve të gjalla në vitin 2015 ishte 24.594 (lindje të ndodhura vetëm në Kosovë). Te dhënat lartë tregojnë se **koeficienti i gjinisë mashkullore në lindje është më i lartë se mesatarja botërore** prej 105 por që në Kosovë është 110.3 (110 djem për 100 vajza të lindura). Përveç një hulumtimi të UNFPA, tema nuk është trajtuar nga institucionet e vendit. Hulumtimi tregon se në Kosovë, siç është edhe trendi në rajon, preferenca për fëmijë mashkull rezulton në disa praktika të caktuara të planifikimit familjar. Seleksionimi gjinor është vështirë të vërtetohet mirëpo **vendimet për të pasur fëmijën e tretë e tutje janë të ndikuara nga gjinia e fëmijëve në familje.**

Mosha mesatare e nënave që kanë lindur në vitin 2016 ishte 28 dhe ndikon rritje të moshës mesatare në krahasim me vitet e kaluara. Megjithatë, **numri më i madh i nënave të reja kanë pasur vetëm arsim të mesëm, 39.4 përqind, dhe 29 përqind vetëm atë fillor.** Gjithashtu, shkalla e mos aplikimit të drejtë të gjinorisë (65 përqind) është e konsiderueshme. Ligji Nr. 05-

⁵⁴ Ibid: 17.

⁵⁵ Farnsworth, Nicole, Dr. Katja Goebels dhe Rina Ajeti. Qasja në Kujdesin Shëndetësor në Kosovë. RrGGK: 2016, 13.

⁵⁶ Seria 5: Statistikat e Lindjeve 2017. ASK: 2018, 34.

L023 për Mbrojtjen e të Ushqyerit me Qumësht Gjiri u garanton grave punonjëse të drejtën për dy orë pushim me pagesë për gjidhënie gjatë orarit të punës. Mirëpo, kjo e drejtë zbatohet vetëm pasi të jenë shfrytëzuar gjashtë muajt e parë të pushimit të lehonisë, duke lënë boshllëk në mbrojtje për gratë që kthehen në punë më herët. Pas vitit të parë dhe deri në dy vjet, kjo reduktohet në një orë pushim me pagesë çdo ditë.

Ofrimi adekuat i shërbimeve perinatale dhe neonatale, por edhe edukimi seksual dhe këshillimi për planifikim familjar, mbesin të domosdoshëm për përmirësimin e gjendjes së përgjithshme të shëndetit të fëmijëve dhe grave.

Tabela 7. Lindjet sipas moshës dhe përkatësisë etnike në lindje e parë, 2016

Moshë e vetme e nënës	Gjithsej në lindjen e parë	Lindja e parë Përkatësia etnike e nënës				
		Shqiptare	Serbe	Turke	Rom, Ashkali dhe Egjiptian	Të tjera
14 e më pak	1	0	0	0	0	0
15	16	8	0	0	0	0
16	39	23	3	0	0	0
17	93	76	2	1	1	0
18	155	128	10	0	5	0

Burimi: ASK, 2018, Statistikat e Lindjeve 2017

Vlerësimet ekzistuese gjithashtu tregojnë për relacione gjinore të cilat drejtpërdrejt ndikojnë negativisht në shëndetin e vajzave dhe grave. Në mungesë të hulumtimeve nga institucionet, konsultimi i hulumtimeve ekzistuese të OJQ-ve vendore dhe agjencive ndërkombëtare dëshmojnë për vlera dhe norma gjinore të cilat **vajzat dhe gratë i vendosin në pozitë të diskriminuar dhe të dominuar sa i përket lirisë së vendimeve mbi planifikimin familjar, seksin, dhe trupin e tyre në përgjithësi.**⁵⁷

Sipas Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2016-2020, gjatë vitit 2014, **7përqind e Kosovareve kanë thënë se partnerët, e tyre, u kanë bërë presion që të kenë marrëdhënie seksuale pa pëlqimin e tyre (përdhunim).**⁵⁸ Vajzat dhe gratë gjithashtu ushtrojnë vendimmarrje të limituar në lidhje me përdorimin e kontraceptivëve dhe në planifikim familjar në përgjithësi. Format e ndryshme të dhunës në baza gjinore dhe dhunës në familje kanë pasoja të shumta në shëndetin e vajzave dhe grave, si dhe fëmijëve, të cilët edhe janë viktimat më të shpeshta të dhunës. Shpesh herë kjo ju pamundëson qasjen dhe trajtimin adekuat, posaçërisht në rastet e pa raportuara.

Duket gjithashtu të ceket se sipas IKSHPK Kosova ka shkallë të ulët të epidemisë (klasifikimi i UNAIDS) të HIV/AIDS por me potencial të rritjes. Prej vitit 1986 deri në vitin 2016 në Kosovë janë raportuar 111 raste të HIV dhe AIDS (69 me AIDS dhe 42 me HIV infeksion; 46 kanë vdekur si pasojë e AIDS-it). **Gjatë vitit 2016 janë raportuar 11 raste të reja,** dhe 3 raste mortaliteti si pasojë e AIDS-it. Në aspektin gjinor, 70përqind janë meshkuj, 30përqind femra, kurse grupmosha më e përfshirë është ajo 25-34 vjeç (32 përqind) dhe 35-44 vjeç (29 përqind).⁵⁹ Rruga me e shpeshtë e përhapjes është heteroseksuale (52 përqind). Sipas hulumtimeve të IKSHPK-së faktorë e riskut janë: rritja e përdoruesve të drogave injektuese; punëtorëve të seksit komercial; përqindje e lartë e të rinjve në mesin e popullatës së përgjithshme të cilët po i ndryshojnë normat sociale e veçanërisht ato seksuale; prania e madhe të popullatës mobile; pamundësia e sektorit shëndetësor t'i përgjigjet nevojave e të gjitha grupacioneve të popullatës në Kosovë.

⁵⁷ Basha, Vlora dhe Inge Hutter. Shtatzënia dhe Planifikimi Familjar në Kosovë. UNFPA, University of Groningen, INDEX Kosova: 2006; Exploratory Research on the Extent of Gender Based Violence in Kosovo and its Impact on Reproductive Health. KWN: 2008.

⁵⁸ Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2016-2020. Qeveria e Kosovës: 2016, f. 24.

⁵⁹ Gashi, Luljeta. Ecuria e HIV-it dhe AIDS-it në Kosovë. IKSHPK: 2017.

Sfidat që duhet të adresohen në fushën e shëndetësisë

Janë identifikuar tri sfera ku PKBGJ-ja mund të intervenojnë në mënyre strategjike ndaj sfidave të identikuara: 1. Parandalimi, Mjedisi dhe Edukimi; 2. Qasja në shërbime me fokus zonat rurale dhe grupet e marginalizuara; 3. Shëndeti riprodhues dhe planifikimi familjar. Kombinimi i gjendjes së dobët, nëse jo të rrezikshme, ekonomike dhe mjedisore, si dhe të dhënat demografike, tregojnë për nevojën e qasjes së integruar në trajtimin e shëndetësisë (ndër sektoriale). Pa një qasje të tillë të dhënat ekzistuese tregojnë se më së shumti mund të pësojnë vajzat dhe gratë. Sfidat kryesore diskutohen në vijim.

Varësia e vajzave dhe grave, e formësuar nga relacionet patriarkale socio-ekonomike, njëjtë të transformuara nga ribërja e strukturave ekonomike, i marginalizon ato në qasjen e tyre në shërbime, shpesh herë pa nevojat e pacientit në qendër, dhe i kontribuojnë rrezikshmërisë për shëndetin e tyre. Në të njëjtën kohë, përveç faktorëve “dytësorë”, siç është përkeqësimi i vazhdueshëm i ambientit, kujdesi dhe trajtimi shëndetësor ndaj vajzave dhe grave lë shumë për të dëshiruar.

Sistemi i informimit shëndetësor (SISH) mbetet dobët i aplikuar dhe i pazhvilluar. SISH është detyrim ligjor për MSh, ku kërkohet nga që të gjitha institucionet shëndetësore të regjistruara të grumbullojnë të dhëna dhe raportojnë tek Ministria e Shëndetësisë. Pa SISH pengohet zhvillimi i politikave të bazuara në dëshmi dhe monitorimin dhe implementimi i tyre. **Mungesa e protokoleve, por edhe e të dhënave të cilat kishin për t’i identifikuar nevojat e veçanta të vajzave dhe grave, si dhe grupeve tjera vulnerable, i kontribuon pasigurisë** të cilën ato e përjetojnë për shëndetin e tyre. Kjo më së shumti vërehet në fushën e shëndetit riprodhues. Gjithashtu, **mungon përkujdesje ndaj grupeve të marginalizuara** të cilat ballafaqohen me barriera të ndryshme në qasje ndaj shërbimeve shëndetësore (gratë, minoritetet etnike, personat me aftësi të kufizuara dhe popullsinë në zonat rurale, komuniteti LGBTI).

Vajzat dhe gratë janë të diskriminuara sa i përket lirisë së vendimeve mbi planifikimin familjar, seksin, dhe trupin e tyre në përgjithësi. Sipas të dhënave ekzistuese, 7 përqind e Kosovarëve kanë thënë se partnerët, e tyre, u kanë bërë presion që të kenë marrëdhënie seksuale pa pëlqimin e tyre (përdhunim). Vajzat dhe gratë gjithashtu ushtrojnë vendimmarrje të limituar në lidhje me përdorimin e kontraktivëve, planifikim familjar në përgjithësi, dhe qasje në shërbime mjekësore.

Sistemi i mbrojtjes shëndetësore në Kosovë është i organizuar dhe i administruar nga niveli qendror - Ministria e Shëndetësisë (MSh). Në MSh, **43 përqind e punëtorëve janë gra ndërsa 57 përqind burra.** Te punësuarit në Institucionet e Shëndetësore sipas gjinisë sipas Publikimit e Shëndetësisë 2015, në total janë evidentuar 14,033 prej të cilëve 8.251 janë gra. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në përbërjen e fundit të Kuvendit të Kosovës, kishte një grua si koordinatorë, ndërsa në përbërjen e vitit 2014 në total ishin nëntë deputet nga të cilët 4 gra dhe 5 burra. Në të kaluarën MSH ka pas një ministre. **Përfaqësimi gjinor në shëndetësi del të jetë i mirë mirëpo pjesa më e madhe e shefave të klinikave dhe spitaleve janë burra.** Gjithashtu, **gjinia mungon në programet mësimore në Fakultetin e Mjekësisë (apo edhe integrimi gjinor) si në studimet bazike dhe të integruara ashtu edhe në programin e Infermierisë dhe trajnimin e mamive.**

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 25 [E Drejta për Jetën], garanton: 1. Secili individ gëzon të drejtën për jetën. Neni 26 [E Drejta e Integritetit Personal] Secili person gëzon të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij/saj, që përfshin: (1) të drejtën që të marrë vendime lidhur me riprodhimin, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me ligj; (2) të drejtën që të ketë kontroll mbi trupin e saj/tij në pajtim me ligjin; (3) të drejtën që të mos i nënshtrohet trajtimit mjekësor kundër vullnetit të tij/saj në pajtim me ligjin; Neni 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtësues] Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtësues.

Te Ligji për Shëndetësi, 2012/04-L-125, përfshihen ndërprerja e shtatzënisë dhe sterilizimi artificial, si dhe frytnimi i asistuar. Sipas këtij ligji, neni 85. 1. Ndërprerja e shtatzënisë nuk lejohet pas javës së dhjetë të shtatzënisë përveç në rastet e përcaktuara me paragrafin 2 të këtij neni; 85.2. Ndërprerja e shtatzënisë pas javës së dhjetë lejohet vetëm në rastet kur ekzistojnë implikime serioze shëndetësore për nënën dhe/ose frytin ose kur shtatzënia është rezultat i dhunimit ose incestit të vërtetuar nga organet e autorizuar me ligj. **Neni 5, paragrafi 1.2. i këtij ligji garanton edhe gjithë përfshirjen dhe jo diskriminimin, ndërsa te Neni 12. Masat dhe Veprimet 1.10.** Listohet: “sigurimi i kushteve për ruajtjen e shëndetit të shtatzënave dhe të lehonave; fillimin e shëndoshë të jetës; si dhe zhvillimin e shëndoshë të fëmijëve dhe të rinjve.” **Ligji Nr.02/L-76 për Shëndetin Riprodhues (ShR)** garanton që “Çdo individ ka të drejtë në jetë të shëndoshë seksuale dhe riprodhuese që zgjedh me vullnetin e saj/tij”. Mirëpo, “parandalimi, zbulimi i hershëm dhe trajtimi i sëmundjeve malinje të sistemit riprodhues dhe karcinomës së gjirit është i përcaktuar si fushë e ShR nuk është fare i rregulluar në përmbajtje me ligj. Aktualisht në Kosovë nuk ka program parandalimi (depistimi) të organizuar për kancerin cervikal (të qafës së mitrës) dhe të gjirit. Për ta realizuar këtë program nuk ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore, pajisjeve dhe materialit shpenzues.”⁶⁰ **Në tërësi, praktikat ekzistuese kulturore, mungesa e ndërgjegjësimit, qasja jo-profesionale e punëtorëve shëndetësor, dhe mungesa e infrastrukturës dhe kapaciteteve njerëzore kontribuojnë në brishtësinë e shëndetit riprodhues.**

Ligji për Ndërprerjen e Shtatzënisë, Nr. 03/L-110, Neni 5, përcakton se secila shtatzëne mbi moshën 18 vjeçare mund të kërkojë ndërprerje të shtatzënisë së saj. Kjo formë e abortit mund të performohet deri në javën e dhjetë të shtatzënisë. **Ligji gjithashtu u lejon grave të cilat janë të “pjekura në moshën 16 vjeçare” të kërkojnë ndërprerje të shtatzënisë me lejen e prindërve apo kujdestarit të saj.** Kuptimi i saktë i fjalës ‘pjekur’ në këtë rast nuk është definuar, dhe nuk është e qartë nëse “kujdestari” nënkupton vetëm kujdestarin mashkull. Nga ky lexim del që të drejtat e vajzave të reja nën moshën 16 vjeçare në lidhje me abortimin nuk janë definuar qartë.⁶¹ Deri në javën e 22-të të shtatzënisë, ndërprerja e shtatzënisë lejohet nën rrethanat e veçanta. Këtu përfshihen arsyet shëndetësore, siç është kërcënimi i jetës së nënës nga ajo shtatzëni ose formësimi i keq që ndikon në jetën e fetusit; ose shtatzëni e shkaktuar si rezultat i dhunimit, incestit apo eksploatimit seksual. Neni 21 i këtij ligji kërkon që çdo institucion të raportojë të dhëna statistikore në lidhje me përfundimin e shtatzënisë. Mirëpo,

Neni 2, Përkufizimet, e përkufizon abortin si “ndërprerje e shtatzënisë me dhunë.” Duke i marrë parasysh predispozitat tjera të këtij ligji ky përkufizim duhet të largohet dhe zëvendësohet me “ndërprerje e sigurte dhe ligjore e shtatzënisë.” Gjithashtu, ka konfuzion shtesë meqë ndërprerja e shtatzënia është e rregulluar me dy ligje (Ligji për shëndetin riprodhues neni 3 përcakton fushat e shëndetit riprodhues përfshirë edhe ndërprerjen e shtatzënisë dhe Ligji për ndërprerjen e shtatzënisë Nr.03/L-110). Ndonëse janë të paligjshme dhe rrallë shpalosen, statistikë e popullsisë sugjerojnë se abortet selektive sipas seksit ende ndodhin; raporti sipas seksit në lindje është 110 djem me 100 vajza, që është një dallim më i madh sesa mesatarja botërore.⁶²

Te dhënat gjithashtu lartë tregojnë se **koeficienti i maskulinitetit në lindje është më i lartë se mesatarja botërore** prej 105 por që në Kosovë është 110.3 (110 djem për 100 vajza të lindura). Përveç një hulumtimi të UNFPA, tema nuk është trajtuar nga institucionet e vendit.

Në veçanti duhet marrë parasysh që **përdorimi i metodave moderne të kontracepsionit është tepër i ulët, dhe nevojat dhe shprehjet e reja të adoleshentëve, qasja në abort dhe kujdesin pas abortit është shpesh e limituar, duke e bërë limitin 10 javor për ndërprerje të shtatzënisë vështirë të aplikueshëm në Kosovë.** Duke konsideruar mungesën e konfidencialitetit dhe privatësisë (shpesh e shkelur nga punëtorët mjekësor), si dhe kushtet socio-ekonomike por

60 Koncept Dokument për Fushën e Shëndetit Riprodhues dhe Fertilizimin e Asistuar. MASH: shkurt 2018, f. 3.

61 Donjeta Morina dhe Nicole Farnsworth. Buxhetimi drejt një arsimimi më të mire: Analizë e përgjithshme e shpenzimeve dhe shërbimeve në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. RrGGK 2016: Prishtinë.

62 Christophe Z. Guilmo and UNFPA, Gender Bias in Kosovo, UNFPA, 2016.

edhe ndërgjegjësimin, vajzat dhe gratë shpesh i kryejnë abortet në **klinika të pa licencuara dhe me kujdes më të dobët**. Në të njëjtën kohë, hulumtimet gazetareske por edhe ato të OJQ-ve dëshmojnë për trajtim diskriminues dhe gjykues ndaj vajzave dhe grave të cilat kërkojnë shërbime në klinikat e licencuara.

Ofrimi i mangët i shërbimeve perinatale dhe neonatale, por edhe i edukimit të seksualitetit dhe këshillimit për planifikim familjar, ndikojnë në gjendjen e përgjithshme të shëndetit të fëmijëve dhe grave. Sipas të dhënave të fundit numri më i madh i nënave të reja kanë vetëm arsim të mesëm, 39.4përqind, dhe 29përqind vetëm atë fillor. **Arsimimi dhe ndërgjegjësimi i mangët ndikojnë në shëndetin e nënave dhe foshnjave, siç vërehet te shkalla e mos aplikimit të drejtë të gji dhënies (65përqind).**

Sa i përket **infeksioneve seksualisht të transmetueshme (IST)** dhe numrit të vogël të rasteve të raportuara, sfidë mbetet paraqitja e rasteve nga të gjitha institucionet shëndetësore si publike ashtu edhe private. **Skriningu për HPV nuk trajtohet nga Strategjia Sektoriale për Shëndetësi përkundër nevojës së evidentuar.**

Sipas një vlerësimi të **Ombudspersonit**, Kushtetuta e Kosovës duhet të amandamentohet dhe të përfshijë **Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventën mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Kartën Sociale të Evropës** në mënyrë që të jenë drejtpërdrejt tëaplikueshme në ligjin vendor në Kosovë.⁶³ Gjithashtu duhet marrë parasysh se **shumica e politikave mbi shëndetin riprodhues dhe seksual kanë skaduar dhe duhet zëvendësuar.**

Si përgjigje për problemet në sektorin e shëndetësisë Kuvendi i Kosovës ka miratuar në vitin **Ligjin për Sigurimet Shëndetësore në Kosovë (2013/04-L-249)**. Ky ligj rregullon themelimin, organizimin, funksionimin, dhe financimin e sistemit publik të sigurimeve shëndetësore; si dhe të drejtat dhe obligimet e palëve të përfshira. MSH ka objektivë themelimin e **Fondit për Sigurime Shëndetësore mirëpo ky ende nuk është funksionalizuar. Ligji Nr.04/L-249 për Sigurime Shëndetësore, neni 7 paragrafi 1.3 ka përcaktuar që shërbimet esenciale për shtatzënat janë shërbime të garantuara shëndetësore.** Për zbatimin e nenit 7 të Ligjit për sigurime shëndetësore është paraparë lista e shërbimeve themelore të përcaktohet me propozim të Bordit drejtues të miratuar me Vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës (Neni 14). Neni 8 i Ligjit për Shëndet Riprodhues ka specifikuar shërbimet shëndetësore që ju ofrohen shtatzënave para dhe gjatë shtatzënisë, ndër të tjera si ndjekja periodike dhe kujdesi shëndetësor në shtatzëni, kujdesi shëndetësor gjatë lindjes etj. **Mirëpo Neni 8 i ligjit për shëndetin riprodhues duhet të harmonizohet me nenin 7 të Ligjit për Sigurime Shëndetësore.**⁶⁴

Mediat

Në mungesë të monitorimit të vazhdueshëm të medias dhe specifikisht praktikave (institucionale, ligjore) të cilat do ti mbanin ato përgjegjëse dhe llogaridhënëse, mediat mbasin pothuajse të paprekura nga kërkesat për drejtësi shoqërore dhe adresim të diskriminimit. Gjithashtu, ndërhyrja e vazhdueshme politike është vlerësuar si faktor pengues në Kosovë, si në krijimin e hapësirave për shprehje të lirë ashtu edhe në krijimin e shoqërisë dhe mediave demokratike. Në këtë kontekst, krijohet qasje e cila gjininë nuk e konsideron si temë relevante të trajtimit. Andaj, politikat publike janë të domosdoshme për të caktuar kritere, etike dhe profesionale, të cilat do ti kontribuonin shprehjes së lirë, pjesëmarrjes së barabartë qytetare dhe zhvillimit të profesionalizmit në media.⁶⁵

Në përgjithësi **mungon monitorimi dhe raportimi i vazhdueshëm dhe rrjedhimisht treguesit të cilët do ta mundësonin njohjen më të mirë të situatës sa i përket mediave dhe gjinisë në**

63 Të Drejtat në Shëndetin Seksual dhe Riprodhues në Kosovë: Një Realitet Përtej Ligjit? OMBUDSPERON Kosovë: 2016.

64 Koncept Dokument për Fushën e Shëndetit Riprodhues dhe Fertilizimin e Asistuar. MASH: shkurt 2018, f. 8.

65 Freedom of the Press: Kosovo. Freedom House: 2016. <https://freedomhouse.org/report/freedom-press/2016/kosovo>

Kosovë. ABGJ ka prodhuar dy hulumtime mbi imazhin e grave në mediat e shkruara, ndërsa ekzistojnë një numër i vogël vlerësimesh nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare.⁶⁶

Në vitin 2012 të dhënat nga raporti vjetor i **Komisionit të Pavarur Mediave (KPM)**, rregullator publik për media elektronike në Kosovë dëshmojnë për numër të paktë të grave që udhëheqin politikatat editoriale apo nivelin më të lartë menaxherial në media (150 të licencuara nga ky institucion). Megjithatë, Kosova gjithsejtë ka trembëdhjetë (13) operatorë televiziv të licencuar: një TV publike, dy TV nacionale, dhe nëntë (9) regjionale/lokale. Dy gra janë pronare të dy operatorëve nacional të licencuar (Koha Vizion dhe RTV 21). Një prej nëntë (9) operatorëve regjional/lokal udhëhiqet nga një grua (TV Mitrovica), ndërsa te të tjerët në cilësinë e pronarit/drejtorit janë burra, përfshirë operatorin publik RTK-në.⁶⁷ Nga 85 radio operatorë, dy janë publik (ato të RTK-së) dhe dy nacional (RTV 21 dhe Radio Dukagjini), shtatëdhjetë e nëntë (79) janë lokal/regjional. Dy (2) radio nacionale janë në pronësi të grave. Nga 83 radio me mbulueshmëri regjionale/lokale njëmbëdhjetë (11) kanë gra si drejtore/pronare.⁶⁸

KPM udhëhiqet nga Kryeshefja Ekzekutive dhe një nga tre anëtarët e Bordit është grua, mirëpo nuk ofron të dhënat mbi burimet njerëzore të zërthyer sipas gjinisë, dhe nuk ka të dhëna të zërthyer për përfaqësim të grave në organizata mediale në vija horizontale dhe vertikale të vendimmarrjes. Përfaqësimi i ultë i grave në menaxhim dhe në borde, si organ më i lartë, është dukuri edhe në TV publike. Kjo pasqyron mosrespektimin e normave ligjore dhe programit kombëtar për barazi gjinore nga KPM por edhe Kuvendi i Kosovë (institucioni themelues i KPM-së). Gjithashtu, kjo gjendje ndikohet edhe nga qasja e grave në pronë dhe arsim profesional, e cila e vështirëson ndërmarrësin e grave në biznesin e mediave, sikurse dhe në çdo sektor tjetër.

Sa i përket pjesëmarrjes së grave në të gjitha programet, **Departamenti i Monitorimit dhe Analizave të i KPM**, gjatë monitorimit një javor (Mars 2012) kishte “mbledhur të dhëna të cilat ofrojnë informacion mbi numrin e temave, intervistave e debateve dhe frekuencën e prezantimit të tyre në 3 televizionet e monitoruara nacionale.” Gjetjet e këtij monitorimi ishin këto: në KTV gruaja ishte prezantuar me 7.72 përqind në të gjitha programet, TV 21 – 4.20 përqind të programit, RTK – 5.21 përqind. Njëjtë, mediat edhe kur trajtojnë çështje ‘dedikuar grave’ KPM konstaton se gjatë monitorimit një javor në vitin 2012 në të tri mediat kombëtare, “ka pasur edhe storie të cilat i dedikoheshin çështjeve dhe problemeve të tyre [grave] por për të cilat janë prononcuar burrat dhe janë anashkaluar këndvështrimet [e grave].”⁶⁹

Vështrimet e KPM-së për vitin 2012 nuk ndryshojnë nga ato të paraqitura në publikimin e ABGJ-së **Reprezentimi i Grave në Mediat e Shkruara 2014-2015**. Ky publikim përmban hulumtim të ndërmarrë me qëllim të vlerësimit të prezantimit sasior dhe cilësor të grave në media të shkruara ku konstatohet se në Kosovë, në përgjithësi, gratë në numër të konsiderueshëm ushtrojnë profesionin e gazetarisë. Te operatori publik gratë gjinden në pozitë të redaktoreve të lajmeve mirëpo thuhet se pushtetin e vendimmarrjes kryesisht e ushtrojnë burrat, pasi që ata bartin pozitën më të lartë, si ato të redaktorit përgjegjës apo kryeredaktorit. Përgjithësisht është redaktorja përgjegjëse për emisionet e minoriteteve dhe një ish-zëvendësdrejtore she gjenerale. Ky publikim gjithashtu konkludon se rezultatet e hulumtimit tregojnë për progres në raportim të çështjeve gjinore sa i përket përfaqësimit të grave udhëheqëse dhe të suksesshme dhe përzgjedhjes së imazheve. Mirëpo, thuhet edhe se “përkatësia gjinore e individëve në pozitë kyçe redaktoriale nuk është indikator i cilësisë më të lartë të raportimeve nga perspektiva gjinore” dhe “mungesa e njohurive për konceptet bazike të barazisë gjinore dhe raportimit

66 Reprezentimi i Grave në Mediat e Shkruara 2014-2015. ABGJ: 2017; Jeta Abazi. Media Situation in Kosovo: Gender Representation. Konrad Adenauer Stiftung: 2014; Prezantimi i Treguesve të Ndjeshëm Gjinor në Media të Kosovës. QMG: 2013; Prezantimi i Grave në Mediat e Shkruara 2010-2011. ABGJ 2012: Image of Women Politicians in the Kosovo Media. KCGS: 2009.

67 Adresari i Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale: Ofruesit e Shërbimit Medial Audio dhe Audio-Vizual. KPM: 2017. <http://www.kpm-ks.org/?faq=419&gjuha=1>

68 Gjetjet e sipërme janë llogaritur duke e analizuar adresarin e KPM-së. Lista është publikuar pas licencimit dhe nuk figurojnë disa TV (KLAN KOSOVA, etj.).

69 <http://www.kpm-ks.org/?mod=njoftimet&id=400>

përmes perspektivës gjinore është ende e theksuar në mesin e gazetarëve.”⁷⁰ Edukimi dhe arsimit medial, si dhe angazhimi i shoqërisë civile dhe trupave apo shoqatave profesionale mediale, rezulton të jetë një nevojë e menjëhershme. Programi i degës së Gazetarisë në UP Hasan Prishtina aktualisht nuk përmban lëndë bazike ose zgjedhore që i adresojnë çështjet gjinore.

Krahasimi i shtatë gazetave ditore tregon se Koha Ditore me 28.9përqind është gazeta me më së shumti shkrime që kanë të bëjnë me gratë, pasuar nga Kosova Sot me 25.8përqind, Bota Sot me 17.9përqind, Zëri me 12.9përqind, Epoka e Re me 6.9përqind, Tribuna me 4.7përqind, dhe Lajmi me 2.9përqind. **Gazetat me tirazhin më të lartë, Koha Ditore dhe Kosova Sot u japin hapësirë më të madhe artikujve që kanë të bëjnë me gratë, në krahasim me gazetat tjera me tirazh më të ulët. Gratë në politikë është tema për të cilën ndahet më së shumti hapësirë në gazetat ditore në sferën e gjinisë, përkatësisht 28 përqind.** Pas saj, me radhë vjen hapësira e ndarë për tema që kanë të bëjnë me dhunën ndaj grave (17.4 përqind), sportin (12.7 përqind), kulturën (10.9 përqind), jetën sociale (7.5 përqind), gjyqësorin (4.6 përqind), barazinë gjinore (4.1 përqind), gratë e suksesshme (3 përqind), shëndetësinë (2.7 përqind), dhunën në familje (2.6 përqind), ekonominë (2.1 përqind), ekstremizmin fetar (1.8 përqind), dhunën ndaj fëmijëve (1.3 përqind), institucionet (0.9 përqind) dhe korrupsionin (0.4 përqind).

Nga ana tjetër “pjesa më e madhe e artikujve që kanë të bëjnë me dukuri negative të cilat cenojnë sigurinë dhe integritetin e grave...informacioni i dhënë është i nivelit **përshkrues**,” ku mungon zbërthimi i problemit “gjë që shpeshherë rezulton në prezantimin e vajzave dhe grave ekskluzivisht përmes prizmit të **viktimës**.” Gratë shpesh herë paraqiten edhe me **gjuhë dhe imazhe** të cilat ato i përkuftizojnë si **labile dhe emocionale**, apo **objekte të seksit**. Hulumtimi ishte i fokusuar në reprezentimin e grave dhe **nuk përmbante analizë gjinore mbi burrat dhe maskulinitetin**. Një gjë e tillë do të mundësonte njohje më të mirë se si relacionet gjinore paraqiten dhe riprodhohen me atë të mediave.

Vendimarrja me përfaqësim të barabartë gjinor, sikurse përmbajtja programore, në kuadër të operatorit publik të TV-së (RTK-së) njëjtë është e mangët. Sipas **Statutit të RTK në nenin 10 dhe 11 për Veprimtarinë dhe Misionin e RTK**, për përmbajtjen dhe standardet programore, veçohet se: “4. RTK nuk do të transmetojë asnjë material, i cili me përmbajtjen, nëntekstin, dykuptimësinë, aludimin ose edhe me tonin, nxit diskriminim në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.” **Mirëpo barazia gjinore nuk gjen vend tek Neni 12 të Standardet Programore.** Përzgjedhja e stafit menaxherial, kryeredaktorëve, e bordit të RTK-së, po edhe Grupi Këshillues i Publikut, sipas këtij statuti nuk priret nga normat ligjore, specifiku përfaqësim adekuat gjinor në pozita vendimmarrëse sipas LBGJ-së. Shembull për përzgjedhje të anëtareve të bordit merret në konsideratë përfaqësimi nga komunitetet etnike pakicë por jo edhe ai gjinor.

Në menaxhment e lartë të RTK-se nga numri i përgjithshëm i punëtorëve 653, gra janë 221 ose 33 përqind. Edhe themeluesi i RTK-së, Kuvendi i Republikës së Kosovës/Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media ka përfaqësim të ulët të deputeteve (nga 11 anëtarë në total vetëm tri janë deputete gra).

Tabela 8. Punëtorët e Radiotelevizionit të Kosovës sipas gjinisë për vitin 2014

Pozita	Gra	Burra	Total
Redaktorë lajmesh	8	5	13
Gazetarë	10	4	14
Të gjithë punonjësit	221	432	653
Pjesëmarrja në %	33.8 %	66.2 %	

Burimi: RTK, 2014, Punëtorët e Radiotelevizionit të Kosovës sipas gjinisë për vitin 2014

⁷⁰ Reprerentimi i Grave në Mediat e Shkruara 2014-2015. ABGJ: 2017, 9.

Hulumtimi “Gratë dhe Burrat” raporton se punësimi sipas aktiviteteve në **fushën e artit, zbavitjes dhe rekreacionit, për gratë është në 16.7 përqind kundrejt burrave me 88.3 përqind**, ndërsa në aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike 26.5 përqind janë gra dhe 73.5 përqind janë burra. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që nga viti 2007 dhe deri më tani ka pasur pesë (5) ministra, të gjithë burra. Në MKRS, 64 përqind e burrave zënë pozitë udhëheqëse. Përveç Galerisë së Arteve, në institucione vartëse të MKRS, sikurse Filarmonia, Teatri, Biblioteka, AKKV Shota, Muzeu i Kosovës, të gjithë drejtorët janë burra.

Në sektorin e kulturës legjislacioni nuk është i harmonizuar me LBGJ ndërsa mungon legjislacioni për veprimtarinë artistike.

Shoqëria civile, festivalet, ekipet sportive, etj. janë hapësira ku njëjtë ka aktivitet të limituar nga aspekti gjinor (mund të përmendet festivali FemArt me fokus të veçantë mbi gjininë). **Në mungesë të përgjithshme të vlerësimeve të këtyre fushave** (Forumi Kulturor, rrjet i organizatave të kulturës dhe artit, ka prodhuar disa vlerësime për sistemin e artit, kulturën dhe mediat, edukimin artistik, për politikën kulturore, fondet publike, instrumentet e Besë) **dhe politikave shtetërore për art dhe kulturë, për qëllimet e këtij dokumenti, fokusi është në krijimin e praktikave të cilat do të gjeneronin njohje më të mirë të situatës.**

Sfidat që duhet adresuar në fushën e mediave

Me gjithë kornizën legjislative për mediat, siç thekson Indeksi i Qëndrueshmërisë së Mediave për Kosovë 2017 (për vitin 2016), IREX, zbatimi mbetet i varfër. Në mungesë të monitorimit dhe raportimit mbi zbatimin e mekanizmave ligjor është e pamundur të bëhet edhe vlerësimi i tyre. **Zbrazëtirat duhet të identifikohen së bashku me një vlerësim të thellë të situatës. Probleme krijohen edhe nga mungesa e dispozitave ligjore. Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi** Nr. 05/L-021, parasheh zbatim për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore qendrore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës.⁷¹ **Mirëpo, ky ligj nuk ka trajtim të specifikave të sektorit të mediave për të garantuar diversitet gjinor, etnik, të orientimit seksual, aftësisë. Gjithashtu, nuk i përfshinë specifikat të cilat dalin nga përdorimi i mediave të reja.**

Me rëndësi të veçantë është **Ligji për RTK- në**, Nr. 02/L-46. Neni 4 specifikon se Objektiva e RTK-së është që të sigurojë transmetim të programeve me standarde të larta profesionale në interes të publikut. Për të bërë këtë, RTK do të informojë me saktësi publikun, të mbështesë proceset demokratike, vëzhgimin publik të autoriteteve dhe të sigurojë një proporcion adekuat të lajmeve të paanshme, programeve kulturore, artistike, sportive, edukative, zbavitëse dhe programeve për fëmijë. Me gjithë misionin demokratik që i m’vishet në legjislacion, dhe është nën ombrellën e Kushtetutës edhe si vartëse e Kuvendit të Kosovës, **RTK-ja nuk del ti përmbush detyrimet ligjore.** ASK Gratë dhe Burrat në Kosovë 2014-2015, publikuar më 2016, thekson se “...në realitet gratë nuk i gëzojnë të drejtat e tyre sikurse burrat. Kjo pabarazi është e evidente në shumë rrafshet sociale dhe ekonomike të jetesës...[përfshirë]...6) **pjesëmarrje dhe përfaqësimi në kulturë dhe media.**” Megjithatë nuk u gjeten gjetjet për kapitullin 6 sikurse ceket në këtë publikim të ASK-se.

Disa OJQ që veprojnë në fushën e barazisë gjinore dhe media, kanë publikuar hulumtime, reagime dhe vlerësime të hapura **për punën dhe diskriminim si në rrafshin programor ashtu**

⁷¹ Veçanërisht ceken: 1.1. kushtet për qasje në punësim, vetëpunësim dhe punësimin në profesion, përfshirë këtu kushtet e punësimit, kriteret e përzgjedhjes, pa marrë parasysh aktivitetin në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, përfshirë avancimet; 1.2. qasje në të gjitha llojet dhe nivelet e udhëheqjes profesionale, trajnimeve profesionale, trajnimit të avancuar profesional dhe rikualifikimit përfshirë edhe përvojën e punës praktike; 1.3. kushtet e punësimit dhe të punës, përfshirë shkarkimin apo ndërprerjen e kontratës dhe pagesës; 1.4. anëtarësimin dhe përfshirjen në organizata të punëtorëve ose të punëdhënësve apo në çdo organizatë tjetër anëtarët e së cilës ushtrojnë një profesion të caktuar, përfshirë edhe përfitimet që mundësohen nga organizatat e tilla; 1.6. përparësitë sociale; 1.8. arsimin; 1.12. qasje dhe pjesëmarrje në shkencë, sport, art, shërbime dhe aktivitete kulturore; 1.13. sigurinë personale; 1.16. çfarëdo të drejte tjetër të paraparë me legjislacionin në fuqi.

edhe atë përmbajtjesore të RTK-së. Gjithashtu, kanë raportuar edhe për raste të menaxhimit jo të drejtë të burimeve njerëzore dhe financiare të RTK-së. **Mungojnë indikatorët gjinor të cilët do të mundësonin monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të LBGJ dhe Ligjit Kundër Diskriminimit në RTK. Mungojnë politika dhe rregullore të cilat do ta trajtonin diskriminimin gjinor, siguronin diversitet dhe mundësonin zbatimin e LBGJ.**

Ngjashëm qëndron situata sa i përket komuniteteve pakicë. Sipas Nenit 59, Komunitetet dhe Pjesëtarëve të Tyre kanë të drejtë të krijojnë dhe të përdorin mediet e tyre vetjake, përfshirë këtu ofrimin e informacioneve në gjuhën e tyre, ndër të tjera, përmes gazetave ditore e shërbimeve kabllore, dhe përdorimin e një numri të rezervuar të frekuencave për mediet elektronike, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare; të themelojnë shoqata të kulturës, artit, shkencës dhe arsimit, si dhe shoqata të studiuesve e shoqata të tjera për shprehjen, avancimin dhe zhvillimin e identitetit të tyre. Mirëpo, pjesëmarrja dhe reprezentimi i grave te komuniteteve pakicë në media asnjëherë nuk është trajtuar me ndonjë analizë.

Një ndër institucionet më të rëndësishme për krijimin e mjedisit të duhur për zhvillimin demokratik të mediave do duhej të jetë **Komisioni i Pavarur i Mediave, i cili rregullohet me Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave Nr. 4/L-44.** Misioni i KPM-së është: 1. Të nxisë dhe të mbajë një sistem të drejtë dhe të hapur për licencimin dhe rregullimin e shërbimeve mediale audio-vizuele dhe për menaxhimin e spektrit të frekuencave të transmetimit në pajtim me standardet më të mira ndërkombëtare. 2. Të kontribuojë në profesionalizimin e shërbimeve mediale audio-vizuele. 3. Të mbështes lirinë dhe pluralizmin e shërbimeve mediale audio-vizuele.

Sipas Ligjit Nr. 04/L44 Komisioni i Pavarur i Mediave është organ i pavarur që rregullon spektrin e Frekuencave Transmetuese në Republikën e Kosovës, licencon transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj. Mirëpo **KPM nuk ka mandat në aspektin përmbajtësor të mediave (gjithnjë duke pas parasysh lirinë e shprehjes).**

Organizatat e shoqërisë civile dhe mediat kanë raportuar për rrezikshmërinë e ushtrimit të profesionit të gazetarisë nga ana e vajzave dhe grave. Shumë nga këto raste nuk publikohen dhe mbesin të hulumtohen nga institucionet publike. Përveç **mungesës së veprimit institucional, dominon qasja ligjore (paditë) për ti heshtur gazetarët, mungesa e respektimit të qasjes publike në informata dhe e njohjes nga gjyqësori për frymën e shtypit të lirë.**⁷²

Mediat e reja përbëjnë sfidë po ashtu edhe mundësi për fuqizimin e vajzave dhe grave. Rrjetet sociale, blogjet, etj. konsiderohen të rëndësishme për “feminizëm kibernetik” dhe në Kosovë gjejmë shfrytëzim të konsiderueshëm. Mirëpo, e njëjta vlen edhe për shfrytëzimin e tyre për të nxitur urrejtje, ekstremizëm, dhe shovinizëm. **Në mungesë të plotë të legjislacionit për mediat e reja, portalet e lajmeve dhe platformat tjera shihen si ndër kontribuuesit më të mëdhenj në shkeljen e etikës profesionale.** KPM, në Raportin për Aktivitete për Vitin 2015, ka prezantuar lidhjen e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM) dhe United Nations Children’s Fund in Kosovo (UNICEF). Në kuadër të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, KPM ka arritur marrëveshje bashkëpunimi me UNICEF-in. Këtë marrëveshje bashkëpunimi me UNICEF-in, KPM e ka nënshkruar në mënyrë që të promovoj dhe mbrojtë të drejtat e fëmijëve në Republikën e Kosovë gjatë prezantimit të tyre në media si edhe karshi ekspozimit të tyre ndaj përmbajtjeve programore që cilësohen të dëmshme.

Nga vlerësimet ekzistuese bëhet të kuptohet se sfidë, përveç sigurisë, në media janë **redaktorët dhe gjykatësit në mos-ndëshkimin e praktikave të rregulluara me Ligjin Civil Kundër**

⁷² Media Sustainability Index: Kosovo 2017. IREX: 2017. <https://www.irex.org/sites/default/files/pdf/media-sustainability-index-europe-eurasia-2017-kosovo.pdf>. Një hulumtim i kryer nga Këshilli i Mediave të shkruara ku të anketuarat femra pothuajse tërësisht (19%) nuk pajtohen mbi drejtësinë dhe barazinë e tyre në sistemin gjyqësor. Treguesit e Mediave 2015: Studim i thukët nga këndvështrimi i gazetarëve mbi lirinë dhe kushtet e mediave në Kosovë. KMSH: 2016, 32. <http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/05/Treguesit-e-Mediave-2015.pdf>

Shpifjes dhe Fyerjes (Nr. 02/L-65). Ky ligj gjithashtu nuk përfshin trajtim të mediave të reja. Gjithashtu, mungesa e njohurive për konceptet bazike të barazisë gjinore dhe raportimit përmes perspektivës gjinore është ende e theksuar në mesin e gazetarëve

Në vitin 2017 është aprovuar **Strategjia Kombëtare për Trashëgimi Kulturor 2017-2027**. Si politikë e rëndësishme e cila i ka munguar Kosovës, kjo strategji nuk e ka gjininë të integruar mirëpo përmban objektiva dhe masa ku gjinia mund të integrohet.

SHTYLLA III: Të Drejtat e Grave, Qasja në Drejtësi dhe Siguria

Gjendja aktuale

Pjesëmarrja politike e grave

Përfaqësimi politik i grave në kuvende legislative apo pozita vendimmarrëse mbetet më i ulët në krahasim me përfaqësimin e burrave. Pjesëmarrja politike e grave në Kosovë garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me anë të ofrimit të mundësive të barabarta për pjesëmarrje të grave dhe burrave përfshi edhe jetën politike (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 7.2). Kuota e pjesëmarrjes zgjedhore është përcaktuar në 30 përqind sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës si dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale.⁷³ Përkundër kuotës e cila garantohet me ligjet zgjedhore, përfaqësimi politik i grave në kuvende legislative apo pozita vendimmarrëse mbetet sfidë madhore si në nivelin ekzekutiv qendror ashtu edhe në nivelin komunal. Jo rrallë pabarazitë shoqërore, kulturore dhe ekonomike afektojnë gëzimin e të drejtave në realitet. Për shembull, në takimet me bazë në komunitet në zonat rurale, pjesëmarrja e grave vlerësohet të sillet rreth 5 deri në 10 përqind krahasuar me 90 deri 95 përqind pjesëmarrje të burrave në takimet e strukturave komunale apo edhe në takime të fshatit.⁷⁴

Përfaqësimi politik i grave në nivelin qendror është më i ulët në krahasim me burrat përkundër kërkesave eksplicite të Ligjit për Barazi Gjinore për pjesëmarrje të barabartë. Në legjislaturën e IV-të (2010-2014), Kuvendi i Kosovës nga 120 deputetë, ka numëruar 40 gra, që është më shumë se kuota e paraparë për 30 përqind. Në legjislaturën e IV-të, pa kuotë, në Kuvend kanë fituar ulëse 12 deputete më shumë. Mirëpo, rritja e numrit të grave të zgjedhura nuk ka ndikuar në rritjen e grave në vendimmarrje brenda Kuvendit. Në këtë legjislaturë gratë nuk kanë qenë të përfaqësuara në Kryesinë e Kuvendit (nga 6 anëtarë të gjithë ishin burra).⁷⁵ Vetëm 2 nga 13 komisionet e përhershme parlamentare (Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, të Pagjeturit dhe Peticione) kanë qenë të udhëhequra nga gratë. Në përgjithësi gratë përfaqësuan një të tretën e deputetëve në komisione parlamentare. Në legjislaturën e V-të, 39 deputete ishin gra. Nga 15 komisione parlamentare 7 janë kryesuar nga deputete gra.⁷⁶ Në legjislaturën e VI-të, janë zgjedhur 39 deputete gra.⁷⁷ Ndërsa 7 nga 13 komisionet parlamentare të Kuvendit udhëhiqen nga gra deputete, duke shënuar kështu një rritje në përfaqësimin e tyre nga legjislatura e kaluar.

Përfaqësimi politik në nivelin lokal është më i ulët për gratë në krahasim me pjesëmarrjen e burrave. Në zgjedhjet lokale të vitit 2009, të gjithë kryetaret e komunave ishin burra, ndërsa vetëm 8.4 përqind e nënkryetarëve ishin gra. Ndërsa në zgjedhjet për Kuvendet Komunale në zgjedhjet e 2010, 32,6 përqind ishin gra.⁷⁸ Në zgjedhjet lokale të mbajtura në vitin 2014, vetëm

73 Këto ligje përkatëse kërkojnë se në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30 %) janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30 %) janë femra; me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë. Shih Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073 dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Nr. 03/L-073. Shih në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2549>

dhe <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2544>

74 KIPRED për FRIDE, "Forcimi i të drejtave të grave në kontekstet e shtet-ndërtimit: Sektori i Sigurisë në Kosovë dhe Decentralizimi," 2010. Në http://fride.org/download/IP_Women_Citizenship_Kosovo_ENG_ag10.pdf

75 <http://abgj.rks.gov.net/Portals/0/ABGJ%20Pjesmarrja%20roli%20dhe%20pozitat%20e%20grave%20ne%20institucione%20qendrore%20lokale%20dhe%20parti%20politike.pdf>, fq. 19

76 <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,110>

77 <http://www.kqzks.org/Uploads/Documents/3.%20Ndarja%20e%20ul%C3%ABseve%20Kandidat%C3%ABt%20e%20zgjedhur%20sipas%20Subjekteve%20-%20Seat%20Allocation%20by%20Party%20and%20Elected%20Candidates> ckgritzexj.pdf.

78 <http://abgj.rks.gov.net/Portals/0/ABGJ%20Plani%20i%20Veprimt%C3%ABr%C3%AB%20Implementim%20t%C3%AB%20Rezolut%C3%ABs%20>

një grua është zgjedhur si kryetare komune në komunën e Gjakovës dhe dy gra u emëruan kryesuese të kuvendit komunal në Gjilan dhe Lipjan. Në Kuvendet Komunale kuota prej 30 përqind ka garantuar përfaqësimin e grave. Derisa në vitin 2007 rreth 20 gra murrën vota për këshilltare komunale, në vitin 2013 rreth 51 gra murrën vota të mjaftueshme për tu bë këshilltare komunale në mbarë Kosovën. Si rezultat pjesëmarrja e grave gjatë kësaj periudhe u rrit nga 30 përqind në 34 përqind të ulëseve.⁷⁹

Përfaqësimi i grave në pozitat udhëheqëse në nivelin qendror mbetet më i ulët në krahasim me përfaqësimin e burrave. Përfaqësimi i garantuar prej 30 përqind të grave me anë të rregullave zgjedhore, zbatohet më tutje minimalisht edhe në emërimet e grave në pozitat vendimmarrëse. Mungesa e vullnetit politik në emërimin e grave në pozitat vendimmarrëse si udhëheqëse ministre apo zëvendës-ministre është reflektuar në vazhdimësi në emërimet e fundit qeveritare. Edhe pse Kosova ka pasur Presidenten e parë grua (2011-2016), përfaqësimi i grave në pozita ekzekutive ka qenë i ulët.⁸⁰ Me krijimin e Qeverisë së Kosovës pas zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2014, Qeveria Mustafa në kabinetin qeveritar nga 20 ministra, kishte emëruar vetëm 4 prej tyre gra.⁸¹ Ndërsa 6 gra kanë qenë zëvendës ministre.⁸² Edhe ky përfaqësim ishte në kundërshtim me kërkesat e LBGJ për pjesëmarrjen prej 50 përqind për secilën gjini në jetën politike dhe atë publike (LBGJ: Neni 3, paragrafi 1.15). Në Qeverinë Haradinaj të formuar në shtator 2017, përkundrejt rritjes së numrit të dikastereve qeveritare ku numri i ministrive ka shkuar në 24 të tilla, vetëm një grua është emëruar ministre e cila udhëheq Ministrinë e Integrimit Evropian. Agjencia për Barazi Gjinore, po ashtu në vitin 2011 kishte raportuar se ndër arsyet e përqindjes më të ulët të grave në pozitat vendimmarrëse janë edhe mungesa e ofrimit të mundësive, dhe mungesa e përkrahjes nga strukturat udhëheqëse si faktor determinues në gati 70 përqind të rasteve të intervistuar, pasuar nga përgatitja profesionale, obligimet familjare dhe rrethana tjera.⁸³

Pjesëmarrja e burrave dhe grave në administratën publike dhe përfaqësimi në pozitat vendimmarrëse mbetet sfidë për gratë. Përfaqësimi i grave në nivelin qendror në administratën publike, sipas raportit hulumtues të ABGJ-së, evidenton që pjesëmarrja e grave në ministri ka një rritje të vazhdueshme ndër vite. Më 2015 gratë kanë përfaqësuar 41.8 përqind të të punësuarve, duke shënuar rënie në 40.6 përqind në vitin 2016⁸⁴ Mirëpo, rritja e numrit të përfaqësimit të grave në përgjithësi në administratën publike nuk është përcjell edhe në përfaqësimin e grave në pozitat vendimmarrëse në nivelin qendror. Kështu, sa i përket pozitave të larta drejtuese sikurse pozitat e sekretarëve të përhershëm, kryeshefave ekzekutiv si dhe drejtorëve ekzekutiv në qeveri. Në vitin 2015, përqindja e grave ishte vetëm 5.2 përqind. Përfaqësimi gjinor në krahasimi me vitin kaluar ka pësuar një ndryshim te vogël, duke ulur për 1 përqind përfaqësimin e grave në nivel lokal, ndërsa në nivel qendror dhe atë të përgjithshëm të shërbimit civil nga 40 përqind sa ishte në vitin 2016 tani kjo arrin në 43 përqind⁸⁵ Në administratën publike qendrore gratë në vitin 2016 sipas MAPL-së përbënin 40.6 përqind të të gjithë të punësuarve në shërbimin civil, prej tyre 27 përqind ishin në pozita vendimmarrëse (menaxheriale). Në nivelin komunal në gusht të vitit 2017, gratë mbanin 33 përqind të të gjitha pozitave të administratës publike komunale dhe vetëm 20 përqind të të gjitha pozitave drejtuese.⁸⁶

Përfaqësimi i grave në administratën e Kuvendit të Kosovës, në vitin 2016 ishte 44.2 përqind. Presidenca e Kosovës nën udhëheqjen e Sh.S Atifete Jahjaga, gjatë viteve 2013-2015 ka respektuar barazinë gjinore me rastin e emërimit të 8 këshilltarëve politik gjithsej, prej tyre ishin 4 burra
1325%20tre%20gjuh%20C3%AB.pdf, fq. 20

80 <http://abgj.rksgov.net/Portals/0/ABGJ%20Pjesmarrrja%20roli%20dhe%20pozitat%20e%20grave%20ne%20institucione%20qendrore%20lokale%20dhe%20parti%20politike.pdf>, fq. 19

81 <http://www.kryeministri-ks.net/?page=143>, qasur më 04 gusht 2017

82 http://www.kgscenar.net/wp-content/uploads/2015/05/Emens-participation-in-decision-making-in-Kosovo_ALB.pdf, fq.13

83 Raporti i Hulumtimit të Agjencisë për Barazi Gjinore (2011), "Gratë në procesin e punës dhe vendimmarrja në Kosovë." Shih në <http://abgj.rksgov.net/Portals/0/Raportit%20i%20hulumtimit%20Grat%C3%AB%20n%C3%AB%20procesin%20e%20punes%20dhe%20Vendimarrjes%20shqip%20A5%20-%202088%20faqe.pdf>

84 Shih ne, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, pjesëmarrja e grave në vendimmarrje në Kosovë http://www.kgscenar.net/Wp-content/uploads/2015/05/Emens-participation-in-decision-making-in-Kosovo_ALB.pdf, fq. 17

85 <https://map.rks-gov.net/getattachment/04cb9ad4-1452-4448-ac28-9f044de683e9/Raport-per-gjendjen-ne-sherbimin-civil-te-Republik.aspx>

86 Nga Analiza Gjinore e Kosovës, Rrjeti i Grave të Kosovës për zyrën e Bashkimit Evropian, fq.12. (2018)

dhe 4 gra. Ndërsa përfaqësimi gjinor i nëpunësve civil në Presidencë gjatë po të njëjtës periudhë ka qenë jo i barabartë ku përfaqësimi i burrave në Presidencë është 62.8 përqind kurse ai i grave 37.2 përqind.⁸⁷

Përfaqësimi i grave në nivel lokal në administratën publike është më i ulët në krahasim me burrat. Numri i përgjithshëm i grave të punësuar në komunat e Kosovës në vitin 2015 ishte 28 përqind gra,⁸⁸ dhe vetëm 10.1 përqind e pozitave drejtuese udhëhiqeshin nga gratë (14 komuna nuk kanë pasur asnjë grua në pozitë drejtuese).⁸⁹ Nuk ekzistojnë të dhëna sipas gjinisë, për pozitën në komisionet e rekrutimeve për shërbimin civil dhe nivelin ekzekutiv.

Përfaqësimi i grave në misionet e shërbimit diplomatik, përfaqësimi në pozitën e vendimmarrjes është më i ulët në krahasim me burrat. Pavarësisht kërkesave të LBGJ-së për kuotën prej 50 përqind në pjesëmarrje dhe përfaqësim në çdo organ dhe nivel vendimmarrës në jetën politike dhe publike, nga 26 misionet diplomatike që ka Kosova, janë emëruar 6 ambasadore gra në 24 misionet diplomatike.⁹⁰ Po ashtu në vitin 2015 ishin 11 gra konsuj të përgjithshëm në krahasim me 89 burra.

Pjesëmarrja e grave dhe burrave në Komisionin Qendror Zgjedhor, Komisionet Komunale Zgjedhore si dhe në Komisionet e Qendrave të Votimit është më e ulët në krahasim me burrat. Në zgjedhjet e vitit 2014, vetëm 20 përqind e stafit zgjedhor përbëhej nga gratë. Kjo ishte një ngritje e vogël nga zgjedhjet e nivelit lokal të vitit 2013, kur gratë përfaqësonin 17 përqind. Rekrutimi bëhet në bazë të propozimeve nga akterë të ndryshëm, duke përfshirë subjektet politike, OJQ-të dhe KQZ-në.⁹¹

Për zgjedhjet e fundit qendrore, të mbajtura në qershor të vitit 2017, përfaqësimi i grave në administratën zgjedhore ishte shumë i ulët. Në mesin e 11 anëtarëve të KQZ-së, vetëm kryetarja është grua dhe gratë përfaqësojnë vetëm 10.5 përqind të anëtarëve dhe kryetarëve të komisioneve komunale të zgjedhjeve. Gratë përfaqësonin 24 përqind të anëtarëve dhe 18 përqind të kryetarëve në qendrat e votimit të vizituara nga Misioni Vëzhgues Zgjedhor nga shtetet e BE-së (ENEMO).⁹² Gjithashtu gratë vetëm në 21 përqind të komisioneve zgjedhore kanë rolin e udhëheqëseve në raport me burrat të cilët në 79 përqind të komisioneve ushtrojnë pozitën e kryetarit.⁹³

Sfidat që duhet adresuar

Bazuar në analizën e gjendjes aktuale, *problemi* kryesor në fushën e **të Drejtave të Grave, Qasja në Drejtësi dhe Siguria** është **qasja e brishtë në realizimin e të drejtave pamundëson arritjen e barazisë gjinore.**

Ligjet zgjedhore që Kosova ka adoptuar në vitin 2008 si dhe rregullat e tanishme zgjedhore nuk janë në përputhje me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore të Kosovës (LBGJ) Nr. 05/L-020, aprovuar në vitin 2015. LBGJ ka kërkuar ndryshimin në përfaqësimin e grave brenda partive politike, që në mënyrë specifike partitë politike do të duhej të respektojnë parimin e barazisë ku sigurohet përfaqësimi prej 50 përqind për secilën gjini, në përputhje me nenet 5, 6 dhe 14 të Ligjit për Barazi Gjinore. Specifikisht LBGJ në nenin 14 parasheh që "Partitë politike me aktet e tyre *obligohen të zbatojnë masat* për promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të meshkujve dhe femrave në organet dhe trupat e partive, në pajtim me dispozitat e nenit 6 të këtij ligji." Për më tepër, Neni 6 i Ligjit për Barazi Gjinore parasheh qartë se "*Përfaqësimi i barabartë gjinor* në të

87 Shih, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, pjesëmarrja e grave në vendimmarrje në Kosovë, http://www.kgscenter.net/wp-content/uploads/2015/05/Womens-participation-in-decision-making-in-Kosovo_ALB.pdf, fq. 24

88 Shih ne, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, pjesëmarrja e grave në vendimmarrje në Kosovë, http://www.kgscenter.net/wp-content/uploads/2015/05/Womens-participation-in-decision-making-in-Kosovo_ALB.pdf, fq. 9

89 Po aty.

90 Për 2 misionet diplomatike në Republikën e Çekisë si dhe në Mbretërinë e Suedisë nuk ekzistojnë informatat në faqen zyrtare të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës. Shih faqen zyrtare të MPJ-së, në <http://www.mfa-ks.net/?page=149>.

91 D4D, Doracak për barazi gjinore në procesin zgjedhor, Fq. 14

92 https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/eu_eom_kosovo_2017_ps_en.pdf

93 <http://kdi-kosova.org/index.php?id=315> fq 2

gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike *arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50përqind) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse* (Neni 6, alinea 8). Po të njëjtën kërkesë e ka rekomanduar edhe Avokati i Popullit të Kosovës si dhe Agjencia për Barazi Gjinore, që partitë politike të zbatojnë kërkesat e LBGJ-së në zgjedhjet e përgjithshme të mbajtura me datën 11 qershor 2017.⁹⁴ Kjo kërkesë nuk është respektuar nga ana e Komisionit Zgjedhor të Kosovës, lidhur me certifikimin e partive politike për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Kosovës të mbajtur me datën 11 qershor 2017.

Mungesa e raportimit dhe analizës së statistikave nga perspektiva gjinore, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore, mbetet sfidë në Kosovë. Institucionet e Kosovës vazhdojnë ndër vite të sfidohen me mungesën e raportimit dhe analizës së statistikave nga perspektiva gjinore. Hulumtimet e fundit tregojnë se Ministria e Administratës Publike (MAP), në mes tjerash përgjegjëse për shërbimin civil, nuk pranon raporte të rregullta nga institucionet përkatëse në aspektin e ndarjes së të dhënave të shërbyesve civil bazuar në gjini, moshë, dhe ndarjen e të dhënave të institucioneve të agjencive të pavarura.

Pjesëmarrja e grave votuese në zgjedhje, si përqindje e përgjithshme e votuesve, ka pësuar rënie nga 51 përqind në zgjedhjet komunale të vitit 2013 në vetëm 36 përqind në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014. Kjo rënie prej 15 përqind përkethehet në më tepër se 125.000 gra, të cilat votuan në vitin 2013 por jo edhe në zgjedhjet e vitit 2014. ⁹⁵Përkundrejt faktit që KQZ tashmë ka publikuar një sërë statistikash lidhur me zgjedhjet lokale të mbajtura në qershor 2017 dhe zgjedhjet e parakohshme të përgjithshme të mbajtura në tetor 2017, KQZ nuk ka ofruar të dhëna të ndara në bazë gjinore për votuesit në këto dy zgjedhjet e fundit. KQZ ka evidentuar që në këto dy palë zgjedhje është respektuar kuota prej 30 përqind (e LBGJ të vitit 2004) të përfaqësimit në legjislativ në kundërshtim me Ligjin për barazi gjinore të 2015 që parashihet përfaqësim të barabartë prej 50përqind për secilën gjini. Vazhdojnë të ekzistojnë shqetësimet rreth praktikës së “votimit familjar”, ku një grup voton në të njëjtën kabinë votimi në të njëjtën kohë. Në raste të tilla, kryefamiljarët burra shpesh votojnë në emër të anëtarëve të familjes që janë gra. Në zgjedhjet e përgjithshme të qershorit 2017, kjo dukuri u raportua në 845 vendvotime (34përqind). Prevalenca ishte e ngjashme me zgjedhjet e vitit 2014.Kjo praktikë i pengon gratë që të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës së lirë dhe në mënyrë të pavarur.⁹⁶

Pjesëmarrja e grave dhe burrave në sektorin e sigurisë në Kosovë, përfaqësimi në vendimmarrje

Pjesëmarrja e burrave dhe grave në Forcën e Sigurisë të Kosovës (FSK) dhe në Policinë e Kosovës (PK) vazhdon të jetë sfidë për gratë brenda sektorit të sigurisë. Edhe pse është shënuar rritje në numrin e grave që janë regjistruar në FSK, më 2013, gratë përfaqësonin 8.13 përqind duke shënuar një rritje në 8.52 përqind në krahasim me vitin 2016. Në Policinë e Kosovës është shënuar ulje në përfaqësimin e grave nga 14.85 përqind në vitin 2013 në 14.01përqind në vitin 2016. Mirëpo, nuk është regjistruar progres në rritjen e pjesëmarrjes së grave në pozita vendimmarrëse në kuadër të PK-së dhe FSK-së.⁹⁷ Gratë përbëjnë 10 për qind të pozitave vendimmarrëse në Policinë e Kosovës dhe vetëm 6.3 për qind të pozitave vendimmarrëse në Forcat e Sigurisë së Kosovës.⁹⁸ Policia e Kosovës ka pësuar rënie në përqindjen e zyrtareve gra në uniformë, përkatësisht nga viti 2006, me 13përqind në 11.46përqind në vitin 2014. Rënie

⁹⁴ Shih deklaratën e Avokatit të Popullit të datës 19.05.2017 në <http://www.ombudspersonkosovo.org/sq/lajme/Dekarate-e-Avokatit-te-Popullit-Lidhur-me-Perfaqesimin-e-Barabarte-Gjinor-ne-Listat-e-Kandidateve-nga-Subjektet-Politike-1511>. Avokati i Popullit ka cek se se për të hequr hezitimet eventuale juridike rikujton Komisionin Qendror Zgjedhor të Kosovës si dhe partitë politike se “...[P]ër të siguruar barazinë mes burrave dhe grave dhe zbatueshmërinë e këtij standardi të të drejtave të njeriut, Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, i cili ka hyrë në fuqi në verën e vitit 2015, saktëson shprehimisht se “Çdo dispozitë, e cila është në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë sipas këtij ligji shfuqizohet.” (Neni 5, paragrafi 2)... Avokati i Popullit pret nga subjektet politike që marrin pjesë në këtë proces zgjedhor, ashtu siç edhe nga KQZ, që të respektojnë parimin e barazisë ku sigurohet përfaqësim prej pesëdhjetë % për secilën gjini, duke siguruar kështu respektimin e Ligjit nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.”

⁹⁵ Po aty, fq. 19

⁹⁶ Demokracia në Veprim, “Raport i vëzhgimit të zgjedhjeve”, 11 qershor 2017, 25, në: <http://kdikosova.org/wp-content/uploads/2018/01/132-dnv-raporti-perfundimtar-zgjedhjet-parlamentare-2017-alb.pdf>.

⁹⁷ Raporti i dytë Monitorues për Progresin e Implementimit të Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 “Gratë, Paqja dhe Siguria” 2013-2015, fq. 5

⁹⁸ Shih më lartë, fq. 44.

është shënuar në numrin e grave në Shërbimin Korrektues me 141 gra në vitin 2005, në 111 gra në vitin 2014⁹⁹. Sipas Raportit vjetor të punës së Policisë për vitin 2015, në trajnimin e kadetëve në Akademinë Kosovare për Sigurinë Publike (AKSP), kanë marr pjesë vetëm 5 përqind gra.¹⁰⁰ Ndërsa nga të punësuar në polici rreth 14 përqind janë gra (Policia e Kosovës, Raport Vjetor 2015).¹⁰¹

Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i burrave dhe grave në sistemin e drejtësisë mbetet me e ulët për gratë në krahasim me përfaqësimin e burrave. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) është organi më i lartë sa i përket hartimit të politikave gjyqësore në Kosovë. Sipas raportit Gratë dhe Burrat në Kosovë 2014-2015, në tabelën mëposhtme të dhënat. Gjykata Kushtetuese e Kosovës udhëhiqet nga një grua.

Tabela 9 : Përfaqësimi në sistemin gjyqësor

Viti	Gra (përqind)	Burra (përqind)
2012	28 %	72 %
2013	27 %	73 %
2014	28 %	72 %
2015	29 %	71 %

Burimi: ASK, 2018, Gratë dhe Burrat në Kosovë 2016-2017.

Sipas ligjit mandati i anëtarëve të KGJK-së është pesë vjeçar dhe janë gjithsej 13 anëtar. Në faqen zyrtare të KGJK-së, anëtar të Këshillit Gjyqësor në Kosovë janë 10, prej të cilëve 7 janë burra dhe 3 gra. Kryesuesi po ashtu është burrë.¹⁰² Ndërsa, Këshilli Prokurorial i Kosovës është përgjegjës për mbikëqyrjen e punës së prokurorëve ku 35.5 përqind ishin gra në vitin 2014.¹⁰³ KPK-ja sipas faqes zyrtare ka 9 anëtar prej tyre 6 janë burra dhe 3 gra, përfshi edhe përfaqësues të minoriteteve.¹⁰⁴

Pjesëmarrja dhe përfaqësimi në institucionet e pavarura mbetet me e ulët për gratë në krahasim me përfaqësimin e burrave. Numri i Agjencive të Pavarura që janë themeluar nga ana e Kuvendit të Kosovës deri më tani ka arritur në 31. Në vitin 2012 vetëm dy prej tyre udhëhiqeshin nga gratë.¹⁰⁵ Në mesin e të gjithë zyrtarëve të lartë të emëruar nga Kuvendi deri në vitin 2012, gratë përbënin 13 përqind nga numri i përgjithshëm.¹⁰⁶ Gjithashtu, raporti ka gjetur se emërimet e zyrtarëve të lartë shpesh janë shtyrë, ndërsa struktura e tyre udhëheqëse ende ballafaqohet me vështirësinë për të reflektuar përfaqësimin gjinor dhe atë të komuniteteve në tërësi.

Pjesëmarrja dhe përfaqësimi në sindikata mbetet me e ulët për gratë në krahasim me përfaqësimin e burrave. Në Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), në faqen zyrtare të saj, nga organogrami mund të evidentohet që në Kryesinë dhe Këshillin Drejtues të BSPK-së nuk ka asnjë grua.¹⁰⁷ Sipas statusit të BSPK-së sipas nenit 35 po ashtu edhe parashihet formimi i Rrjetit të gruas, brenda strukturave të BSPK-së, në mënyrë që të koordinohen aktivitetet, si dhe Kryetarja e rrjetit të gruas është anëtare e Këshillit Drejtues të BSPK-së.¹⁰⁸ Në përgjithësi, uniformiteti i të dhënave nuk ekziston si dhe ndarja në baza gjinore e shënimeve rrallë reflektojnë statistika të ndara në baza gjinore. Rrjedhimisht, kërkesat e LBGJ-së për paraqitjen e të dhënave nga aspekti gjinor edhe në institucionet private, nuk njihen.

99 Agjencia për Barazi Gjinore, Gazeta, "Gratë për sigurinë e Kosovës" Në dispozicion, <http://www.shgpk-ks.org/publikimet/revista-press> -artikuj

100 Raporti vjetor i punës së Policisë, http://www.kosovopolic.com/repository/docs/Raporti_vjetor_i_pun%C3%ABs_s%C3%AB_Policis%C3%AB_s%C3%AB_Kosov%C3%ABs_2016_-_SHQIP.pdf, fq. 13-14.

101 Po aty, fq. 6

102 Marrë nga Faqja Zyrtare e KGJK-së, në <http://www.gjyqesori-rks.org/sq/kjc/bio/list?type=judge>

103 Profili gjinor I vendit, analizë e dallimeve gjinore në të gjitha nivelet në Kosovë, fq. 10

104 Faqja Zyrtare e KPK-së, në <http://www.kpk-rks.org>

105 OSBE Misioni në Kosovë, "Gjendja e institucioneve të pavarura në Kosovë" (2012). Shih në <http://www.osce.org/sq/kosovo/92052?download=true>, fq. 13

106 Mu aty, fq. 15

107 Shih Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, në <http://www.bspk.org/rrethnesh.html#tab4>, qasur më 28 Korrik 2017.

108 Mu aty, qasur më 28 Korrik 2017.

Pjesëmarrja dhe përfaqësimi në bordet e institucioneve publike dhe private mbetet me e ulët për gratë në krahasim me përfaqësimin e burrave. Sa i përket përfaqësimit të grave në bordet e institucioneve publike nuk ka të dhëna të ndara në baza gjinore deri më tani. Kërkesat e LBGJ-së për paraqitjen e të dhënave nga aspekti gjinor edhe në institucionet private, nuk njihet dhe nuk ka uniformitet në paraqitjen e të dhënave në përgjithësi.

Pjesëmarrja dhe përfaqësimi në shoqatat e shoqërisë civile i grave dhe burrave është adekuat. Një karakteristikë dalluese e shoqërisë civile në Kosovë është rrjetëzimi i organizatave dhe OJQ-ve të grave, të cilat kanë punuar në mënyrë të koordinuar, duke ofruar kapacitetet e tyre njerëzore dhe lobuese për ngritjen e vetëdijes së grave për rolin e tyre në zhvillimin e shoqërisë. Një nga organizatat me përfaqësuese është Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RRGGK), i formuar në vitin 2000, i cili grupon mbi 135 organizata të grave. Gjithashtu, në vitin 2013 u themelua edhe Grupi G-7 nga shtatë gra udhëheqëse afariste duke krijuar më vonë edhe Odën Ekonomike të Gruas në mënyrë që të punohet në fuqizimin e gruas.¹⁰⁹ Koalicioni i strehimoreve gjithashtu përfshin një numër të organizatave të shoqërisë civile të fokusuara në ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në baza gjinore, në shumicë të udhëhequra nga gratë. Organizatat e tjera të shoqërisë civile (OSHC-të) në përgjithësi bashkëpunojnë edhe në çështjet e barazisë gjinore dhe ofrojnë hulumtime të rëndësishme nga sfera e barazisë gjinore.

Qasja në drejtësi dhe dhuna në familje

Kosova qysh në vitet 2004 kishte hartuar edhe pakon e parë të ligjeve për të drejtat e njeriut përfshi Ligjin për Barazi Gjinore dhe Ligjin Kundër Diskriminimit. **Zbatueshmëria e dobët e sanksioneve dhe mungesa e zbatimit dhe numri i vogël i kërkesave lidhur me rastet e diskriminimit në gjykatat e Kosovës,** ka shtyrë Bashkimin Evropian që në Udhërrëfyesin e Kosovës për Liberalizimin e Vizave,¹¹⁰ të kërkon nga institucionet e Kosovës, hartimin dhe ndryshimin e pakos të ligjeve për të drejtat e njeriut përfshi edhe Ligjin e ri për Avokatin e Popullit. Rrjedhimisht, në vitin 2015, institucionet e Kosovës hartuan dhe miratuan një pako të tillë të ligjeve për të mbrojtur dhe parandaluar gratë dhe burrat nga format e ndryshme të diskriminimit, për të garantuar barazinë gjinore si dhe për të specifikuar në detale dhe garantuar pavarësinë e Institucionit të Avokatit të Popullit.

Në veçanti, në qasjen efektive në drejtësi ekzistojnë arsyet e përgjithshme në funksionimin e sistemit gjyqësor në Kosovë, të cilat ndikojnë edhe në realizimin e të drejtave dhe ushtrimin efektiv të mjeteve juridike që janë në dispozicion. **Zvarritjet e procedurave në përgjithësi në vendosjen e lëndëve gjyqësore, shkalla e ulët e ekzekutimit të vendimeve si dhe njohuria e dobët e ligjeve nga kërkuesit e së drejtës,** janë çështje të cilat po ashtu i ka adresuar edhe Avokati i Popullit në raportin e fundit vjetor 2016.¹¹¹ Gjithashtu, duke marrë parasysh edhe pozitën më të pavolitshme të grave në raport me burrat sa i përket edhe mundësive të tyre financiare, kategoria e viktimave të dhunës po ashtu është paraparë si kategori e veçantë në ofrimin e ndihmës juridike falas në Kosovë.¹¹² Ndihma juridike falas, është edhe kategori kushtetuese,¹¹³ por mungesa e mjeteve buxhetore bën të pamundur ofrimin e ndihmës juridike falas në raport me kërkesat ekzistuese të qytetarëve.¹¹⁴

Dhuna në baza gjinore

Shoqëria Kosovare vazhdon të afirmon ose toleron dhunën si mënyrë e disiplinimit apo

109 Profili Gjinor i Kosovës, 2014, faqe 11.

110 Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave me Kosovë, Bashkimi Evropian në https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/visa_liberalisation_with_kosovo_roadmap.pdf

111 Shih Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave, Raporti Vjetor i Institucionit të Avokatit të Popullit, 2016. Në http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/Raporti_vjetor_per_vitin_2016_i_IAP_164298.pdf.

112 Ligji për Ndihmë Juridike Falas, Ligji Nr. 04/L-017 (2012). Shih në <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20ndihme%20juridike%20falas.pdf>

113 Shih Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 31, alinea 6.

114 Raporti Vjetor 2016, Avokati i Popullit, faqe 26. Në http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/Raporti_vjetor_per_vitin_2016_i_IAP_164298.pdf

rritjes së fëmijëve apo kontrollit dhe mbajtjes së grave në pozitën e tyre shoqërore.¹¹⁵Raporti i Rrjetit të Grave të Kosovës, ka treguar se shumica e responentëve pajtohen se është në rregull që “fëmijët të dispiplinohen” edhe pse nuk kishte pajtueshmëri lidhur me metodat që duhet përdorur. Më shumë gra se burra pajtohen se fëmijët duhet “rrahur me shuplakë” në mënyrë që të dispiplinohen, gjersa 41 përqind të responentëve gra dhe burra konsiderojnë se “Djemtë duhet të dispiplinohen më shumë se vajzat, sepse duhet bërë më të fortë,” gjersa “Vajzat kanë nevojë për më shumë se djemtë për disiplinë në mënyrë që të jenë moralisht në rregull” (RRGK, 2015).

Gratë në grupet minoritare dhe me aftësi të kufizuara po ashtu ballafaqohen me sfida më të theksuara ekonomike, sociale dhe kulturore. Sipas grave aktiviste, në veçanti gratë Rome, Ashkali dhe Egjiptase ballafaqohen me diskriminime të “trefishta,” meqë diskriminohen nga familjet e tyre, nga komunitetet e tjera në shumicë si dhe nga institucionet e nivelit qendror. Gratë me aftësi të kufizuara si dhe gratë lesbike, biseksuale dhe transgjinore po ashtu diskriminohen më shumë, meqë institucionet në vazhdimësi siç shihet nga analiza mëposhtme, vazhdojnë të sfidohen në zbatimin praktik të ligjeve dhe ofrimin e mjeteve juridike efektive përkundër kërkesave ligjore të garantuara edhe me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe LBGJ-në.¹¹⁶ Sipas Avokatit të Popullit, problemet tjera me të cilat zakonisht ballafaqohen personat LGBT në Kosovë, rrjedhin nga perceptimi i shoqërisë, e cila nuk pranon mjaftueshëm këtë komunitet.¹¹⁷ Avokati i Popullit ka propozuar edhe që qeveria e Kosovës të ndërmerr hapa konkret në mënyrë që në kuadër të sistemit të arsimit të përfshihet dhe informimi në lidhje me të drejtat e personave LGBT.

Gratë mbesin në numër të konsiderueshëm më të lartë, viktimat të dhunës në familje dhe formave tjera të dhunës në baza gjinore në Kosovë. Përkundër sfondit të begatshëm legjislativ dhe krijimit të një sërë të mekanizmave për adresimin e dhunës në baza gjinore, gratë mbesin në numër të konsiderueshëm më të lartë viktimat të dhunës në familje dhe formave tjera të dhunës në baza gjinore.¹¹⁸ Është e domosdoshme të përmirësohet bashkëpunimi në mes të institucioneve dhe të zbatimit të qasjes me viktimën në qendër, duke përfshirë edhe menaxhimin e rasteve. Në raportin e fundit të Këshillit të Evropës mbi dhunën ndaj grave në Kosovë,¹¹⁹ ndër të tjerash ceket se Konventa e Stambollit nuk konsideron dhunën ndaj grave si fenomen individual apo përvojë individuale, por duhet të kuptohet si mekanizëm strukturor me anë të cilit gratë mbahen në pozitë subordinuese në krahasim me burrat në shoqëri (Raporti i Këshillit të Evropës, 2017:5). Këto dispozita pra nuk zbatohen njëjtë për burrat, edhe pse është e njohur se edhe burrat janë viktimat të dhunës dhe përjetojnë abuzim si në jetën private po ashtu edhe në sferën publike, por në numër shumë më pak se gratë (Raporti i Këshillit të Evropës, 2017:5). Në rastet e *dhunës në familje* në Kosovë, ndër vite tregohen përafërsisht numër rreth 1,000 viktimat të dhunës familjare të raportuara në baza vjetore. Sipas Policisë së Kosovës në publikimin “Gratë dhe Burrat në Kosovë 2014/2015,” gjatë vitit 2013 kanë raportuar dhunën 869 gra dhe 220 burra (total 1,089 viktimat). Në vitin 2014 ishin 894 gra dhe 272 burra (total 1,166) dhe në vitin 2015 ishin 745 gra dhe 184 burra (total 929).¹²⁰ Shënimet e fundit nga Policia e Kosovës, tregojnë se në vitin 2016 ishin 1247 raste të raportuara dhe 1144 raste të raportuara gjatë vitit 2017. Mesatarisht gjatë dy viteve 80 përqind janë gra që e raportojnë dhunën. Si pasojë e dhunës në familje, në vitin 2018 4 gra janë vrarë nga burrat e tyre, numër i njëjtë është regjistruar dhe në vitin 2019-në një nga katër rastet, burri ka vrarë dy gra-gruan dhe nusen e djalit. Shërbimet e rehabilitimit të viktimave mungojnë, përfshirë shërbimet e shëndetit mendor.

115 KIPRED për FRIDE, “Forcimi i të drejtave të grave në kontekstet e shtet-ndërtimit: Sektori i Sigurisë në Kosovë dhe Decentralizimi,” 2010. Në http://fride.org/descarga/IP_Women_Citizenship_Kosovo_ENG_ag10.pdf.

116 Mu aty faqe 15.

117 Raporti Vjetor Avokati i Popullit, 2016. Fq. 57.

118 Ky raport përdor përkufizimin e Dhunës në Baza Gjinore, të aprovuar nga Komiteti i CEDAW (Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave) e cila në vitin 1992 ka përkufizuar në Rekomandimin e Përgjithshëm të CEDAW Nr. 19 mbi dhunën ndaj grave, duke përkufizuar dhunë në baza gjinore si forme të diskriminimit ndaj grave, specifikisht “Dhuna e cila ushtrohet ndaj gruas për arsye të është grua ose afekton gratë në mënyrë disproporcionale,” duke nënkuptuar që dhuna ndaj grave nuk është fenomen i cili ndodh rastësisht por i afekton gratë për shkak të gjinisë së tyre.

119 Raporti “Hartimi i shërbimeve të përkrahjes për viktimat e dhunës kundër grave në Kosovë,” Projekti i Këshillit të Evropës në Kosovë, Fuqizimi i luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Kosovë, Qershor 2017, në bashkëpunim me Agjencinë për Barazi Gjinore.

120 Shih Grafikun 42, Burimi: Policia e Kosovës, Drejtoria për Krime të Rënda, Agjencia e Statistikave të Kosovës, në “Gratë dhe burrat në Kosovë 2014/2015,” publikuar dhjetor 2016. Në <http://ask.rks-gov.net/media/2581/grate-dhe-burra-shqip-2014-2015.pdf>

Format e tjera të dhunës ndaj grave, sikurse *trafikimi me qenie njerëzore* e në veçanti edhe trafikimi i grave dhe vajzave për qëllim të eksploatimit të tyre seksual, mbulohet me dispozita të veçanta të Kodit Penal të Kosovës (Neni 171, Kodi Penal i Kosovës), mirëpo edhe në Ligjin e veçantë të hartuar në vitin 2015, Ligji për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, Nr. 04/L-218. Sfidat kryesore mbesin në zbatimin e tyre praktik. Duhet veçuar reagimin e dobët gjyqësor që vazhdojnë ndër vite të shqiptojnë sanksione të ulëta ndaj kryesve të dhunës së trafikimit ndaj grave dhe vajzave për qëllime të eksploatimit seksual. Në praktikë, në rastet edhe kur ekzistojnë dënimet ato vazhdojnë të jenë të ulëta.¹²¹ Në rastet e përndjekjeve penale zakonisht dënimet janë të rralla dhe rrallëherë zbatohen masat e konfiskimit të pasurisë nga vepra e kundërligjshme e trafikimit edhe kur ka dënime.¹²²

Përkundër që ngacmimi seksual është definuar në Kodin e ri Penal, identifikimi dhe trajtimi i rasteve të ngacmimit seksual mbetet sfida. Edhe pse ende nuk ka shënime zyrtare të mbledhura dhe raportuara rregullisht, hulumtimet e udhëhequra nga sektori jo-qeveritar tregojnë se rreth 64 përqind të grave dhe vajzave kanë përjetuar ndonjë formë të ngacmimit seksual gjatë jetës së tyre (Raporti i Këshillit të Evropës 2017: 4). Që nga 14 janari 2019, dhuna në familje dhe ngacmimi seksual janë vepra penale në Kosovë, të dënueshme në përputhje me Kodin Penal të Republikës së Kosovës të ndryshuar kohët e fundit, siç është cekur ne fillim. Për ngacmim, personat mund të dënohen me burgim deri në tri vjet ose me gjobë. Mbrojtje e veçantë nga shteti për viktimat e ndjeshme është paraparë edhe në Kodin Penal të Kosovës, mirëpo gati se kjo mbrojtje nuk është ofruar fare ndaj viktimave. Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, ka paraparë edhe Fondin për Kompensim të Viktimave. Në mungesë të zbatimit të këtij në praktikë, Ministria e Drejtësisë me përkrahjen e Ambasadës Amerikane ka hartuar Ligjin për Kompozimin e Viktimave të Krimit.¹²³ Deri më tani është themeluar Komisioni dhe Qeveria e Kosovës ka ndarë një shumë për zbatimin e këtij ligji. Mbetet të shihet në praktikë dhe të monitorohet zbatimi i ligjit në sa raste të viktimave të krimit janë ofruar kompensimet e parapara me ligj. Deri në Janar të vitit 2018, ishin vetëm dy raste të viktimave të krimit të kompensuar nga shteti një rast i vrasjes dhe një i trafikimit me qenie njerëzore (KIPRED; 2018).

Dhuna seksuale, duke përfshi dhunimin, i cili ndodh brenda apo jashtë familjes, rrallëherë raportohet nga viktimat e dhunës (Raporti i Këshillit Evropës 2017:4). Shumë shpesh viktimat rrethohen nga stigma dhe vendosin të mos raportojnë këto raste duke ndikuar edhe në izolimin e viktimës, shkurorëzimin apo edhe mendimin se dhuna seksuale e ushtruar ndaj tyre do të ndikon edhe në statusin e tyre martesor të ardhshëm.¹²⁴ Kjo stigmë përcillet edhe me njohjen e dobët të statusit të tyre nga autoritetet apo edhe kompensimin e tyre dhe ndikon në raportimin e dobët të rasteve. Kodi Penal i Kosovës parasheh dispozita të veçanta lidhur me dhunimin si dhe kryerjen e aktit seksual pa pëlqimin e personit tjetër, duke paraparë dënimin me burg prej 2 deri në 10 vite. Po ashtu përdorimi i forcës, kanosja me armë, apo kur kryesi është edhe në marrëdhënie familjare me viktimën, konsiderohen si rrethana rënduese dhe parashihet dënimi deri në 15 vite (Neni 230, Kodi Penal i Kosovës). Në praktikë, megjithatë rrallë herë raportohen rastet e dhunimeve në Kosovë për shkak të shkaqeve të dhëna më sipër. Policia ka mungesë të njohurive lidhur me ngacmimin seksual dhe dhunën seksuale. Ndonjëherë ata dështojnë t'i trajtojnë seriozisht rastet e dhunës seksuale ose t'i hetojnë ato siç duhet, gjë që mund të çojë në mos-dokumentim dhe adresim të pamjaftueshëm të këtyre rasteve. Në mënyrë të ngjashme, disa gjyqtarë kanë pak njohuri mbi ngacmimin seksual dhe dhunën seksuale, duke kontribuar në fajësimin e viktimave dhe jo në ndarjen e drejtësisë.¹²⁵

Dhuna në bazë gjinore gjatë luftës, mbetet po ashtu një formë e dhunës e cila nuk është raportuar mjaftueshëm. Ende nuk ka të dhëna të sakta zyrtare lidhur me numrin e viktimave

121 Raporti i Departamentit të Shtetit Amerikan, Trafikimit me Njerëz, 2017. Kapitulli mbi Kosovën. Shih në <https://www.state.gov/documents/organization/271343.pdf>.

122 Shih më lartë.

123 Shih Ligjin për kompensimin e Viktimave të Krimit, Nr. 05/L-036. Në <http://md.rks-gov.net/desk/inc/media/6DB494F4-9A82-4151-9D86-2CEC2B26E1C2.pdf>

124 Raporti i Këshillit të Evropës "Hartimi i shërbimeve të përkrahjes për viktimat e dhunës kundër grave në Kosovë," Projekti i Këshillit të Evropës në Kosovë, Fuqizimi i luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Kosovë, Qershor 2017. Kopja me Agjencinë për Barazi Gjinore

125 177 RrGK Nga fjalët në vepra?, f. 3.

gra dhe burra që kanë përjetuar dhunë në bazë gjinore gjatë luftës 1998-1999, edhe pse vlerësohet se ka pasur dhunë në shkallë të gjerë (Profili gjinor i Kosovës 2014:24). Dihet nga organizatat jo-qeveritare të cilat kanë asistuar viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës, se gratë dhe vajzat kanë qenë në shënjestër të dhunës seksuale, burrat dhe djemtë civil kanë përjetuar forma të tjera të dhunës përfshirë edhe dhunën seksuale, dhe vrasjen e qëllimshme në mënyrë më të lartë se gratë.

Qeveria e Kosovës ka filluar të adreson çështjen e një forme të reparacioneve për të mbijetuarat/it e dhunës seksuale gjatë luftës. Në vitin 2014 miratoi ndryshimet e Ligjit për Ndryshimin për dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të tyre.¹²⁶ku u përfshinë edhe statusi i personave të dhunuar gjatë luftës. Në Shkurt 2018 ka filluar punën zyrtarisht Komisioni Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e personave të dhunuar gjatë luftës. Sfidë mbetet qasja në drejtësi e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës. Në këtë periudhë po ashtu janë hapur 29 raste, ku shumica e këtyre rasteve janë në hetime preliminare, një numër i rasteve janë nën hetime, rastet tjera ose janë dërguar në gjykatë ose është hedhur kallëzimi penal.

Krimet e dhunës në emër të nderit [mbrojtjes së] nderit, tregojnë se ekzistojnë disa raste nga raportet e Policisë së Kosovës ku vëllezërit kanë rrahur motrat për sjellje “të pandershme”.¹²⁷Kjo temë vazhdon të mbetet e painformuar mjaftueshëm, meqë edhe është fushë e cila kërkon raportime zyrtare të hetuara mirë dhe duhet të hulumtohet në ta ardhmen. Po ashtu kërkesat e Konventës së Stambollit për kriminalizimin e këtyre rasteve mbeten ende të pa adresuara nga legjislacioni i Kosovës.

Prevalenca e rasteve të martesave të hershme ka vazhduar në komunitetet Rome, Ashkali dhe Egjiptas, mirëpo edhe në zonat rurale në përgjithësi. Po-ashtu një raport i Fondit për Popullsinë i Kombeve të Bashkuara,¹²⁸ ka treguar se *rastet e martesave të hershme* në Kosovë, përfshi të fëmijëve në përgjithësi, mbeten një fenomen i rrallë. Prevalenca e rasteve të martesave të hershme ka vazhduar në komunitetet Rome, Ashkali dhe Egjiptas, mirëpo edhe në zonat rurale në përgjithësi si dhe në diasporë. Përsëri, nuk ka statistika të mbledhura dhe të raportuara të sakta, meqë edhe shumë martesa nuk regjistrohen menjëherë meqë edhe martesa nën moshën 16 vjeçare në Kosovë konsiderohet vepër penale (Raporti i Këshillit të Evropës 2017:42017:4).

Për personat nga komunitet dhe në veçanti gratë që jetojnë në veri të Kosovës, ka më pak qasje në mbrojtje nga policia dhe gjykatat në përgjithësi. Për personat që jetojnë në veri të Kosovës, ka më pak qasje në mbrojtje nga policia dhe gjykatat në përgjithësi nga mos-besimi i komunitetit në Veri ndaj institucioneve si dhe raportimi i ulët i dhunës (Ibid 2014:7).

Sfidat që duhet adresuar

Rastet e raportimit të diskriminimit në baza gjinore mbesin minimale përfshi këtu edhe rastet e ngacmimeve seksuale. Mbledhja e statistikave në baza gjinore kërkuar edhe në nenin 5 të LBGJ-së, mbetet sfidë e vazhdueshme për institucionet e Kosovës. Në vitin 2016, Rrjeti i Grave të Kosovës, ka raportuar se nuk ka mundur të gjejë asnjë rast në praktikën administrative apo juridike ku punonjësit apo shkelësit janë dënuar me gjoba për shkeljet e Ligjit kundër Diskriminimit apo Ligjit për Barazi Gjinore specifikisht në rastet e ngacmimit seksual.¹²⁹ Në raport, Prokuroria e Shtetit ka deklaruar vetëm tri raste për periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2014.

126 Shih Ligjin NR. 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/l-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të ushtrisë çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale të luftës, viktimave civile dhe familjarëve të tyre. Në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9436>.

127 Marrë nga Profili Gjinor i Kosovës, ABGJ/EU/SIDA 2014. https://abgj.rksgov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ/Profili%20Gjinor%20i%20Vendit_2014%20-ALB.pdf

128 Shih UNFPA Raportin Martesat e Fëmijëve në Kosovë, 2014. Në <http://eeca.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/unfpa%20kosovo%20overview.pdf>

129 Rrjeti i Grave të Kosovës, Raporti Hulumtues “Ngacmimi Seksual në Kosovë” (2016), financuar nga Agjencia Zhvillimore Austriake. Shih në <http://www.womensnetwork.org/documents/20160224112147815.pdf>.

Mbetet sfidë raportimi i rasteve mbi dhunën në baza gjinore, ndarja e shënimeve sipas gjinisë dhe analiza e tyre e detajuar nga aspekti i marrëdhënieve familjare në përputhje me ligjin aktual. Në përgjithësi vazhdon të mbetet sfidë raportimi në baza të rregullta nga institucionet e mandatuara që u ofrojnë ndihmë viktimave të dhunës në baza gjinore. Ekziston një përmbledhje e shënimeve statistikore nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, gati në baza të rregullta vjetore njohur si publikimi “Gratë dhe Burrat në Kosovë,” mirëpo edhe këto publikime janë të limituara nga shënimet institucionale ekzistuese dhe nuk ofrojnë analiza të tillë të fenomenit të dhunës në baza gjinore, në përputhje tani me kërkesat e Konventës së Stambollit. Së fundi, edhe Koordinatori nacional kundër dhunës në familje ka ndërmarrë iniciativën për krijimin e data bazës për viktimat e dhunës në familje.

Mungesa e një mekanizmi përcjellës për monitorimin e rasteve të dhunës në baza gjinore përfshi edhe rastet e diskriminimit mbetet sfidë në Kosovë. Kërkesat për mbledhjen e shënimeve dhe statistikave në të gjitha nivelet institucionale në raportin e fundit të Progresit për Kosovën (2016) të hartuar nga BE-ja konfirmon këtë sfidë. Kjo çështje është adresuar më tutje edhe në mendimin juridik të Avokatit të Popullit të Kosovës, lidhur me trajtimin e homofobisë dhe transfobisë drejtuar në rolin e ‘mikut të gjykatës’, Gjykatës Themelore në Prishtinë.¹³⁰ Rrjedhimisht, Avokati i Popullit këtë shkelje të drejtave të njeriut garantuar edhe me ligjet e Kosovës, konsideron se edhe Gjykatat në asnjërën nga procedurat e saja nuk kanë lëshuar vendime të shpalljes së fajësisë apo pafajësisë për personat apo grupet të cilat kanë ushtruar dhunë ndaj komunitetit LGBT, për shkak të orientimit të tyre seksual dhe jo në përputhje me kërkesat e Neni 17 të Ligjit për Mbrojtje kundër Diskriminimit¹³¹. Në mbështetje të UN Women, në vitin 2018, Zyra e Koordinatorit nacional Kundër Dhunës në Familje, ka filluar procesin e krijimit të bazës së të dhënave për rastet e dhunës në familje.

Në raportin vjetor 2016 të Avokatit të Popullit (AP), po ashtu paraqitet edhe ndarja gjinore e ankuesve pranë institucionit të AP-së, prej të cilëve ishin 22 përqind gra dhe 78 përqind burra. Edhe pse specifikohen rastet e trajtuara nga ana e AP nga aspekti gjinor lidhur me gjininë e ankuesve, nuk ka ndarje tjera të statistikave në baza gjinore për rastet e trajtuara nga institucioni si dhe specifikat e rasteve të trajtuara nga njësitet përkatëse të AP.

Shtyrja në zbatimin dhe lëshimin e urdhrave mbrojtës në rastet e dhunës në familje si dhe lëshimi nga gjykatat e dënimeve të buta ose fare përfshi edhe për rastet e recidivistëve të dhunës në familje mbeten sfidë për qasje në drejtësi për gratë në Kosovë. Sfidë tjetër e identifikuar për qasjen e grave në drejtësi është edhe shtyrja në zbatimin dhe lëshimin e urdhrave mbrojtës në rastet e dhunës në familje, lëshimin nga gjykatat e dënimeve të buta ose fare për rastet e recidivistëve të dhunës në familje, lëshimin e limituar të vetëm disa masave të parapara sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje Nr. 03/L-182. Po ashtu prokuroritë kanë vazhduar të mos ndërmarrin hetime dhe lëshime të aktakuzave për rastet që kërkojnë ndjekje sipas detyrës zyrtare (ex officio) për rastet e lëndimeve të lehta trupore të viktimave të dhunës në familje. Në rastet tjera lëndët parashkruhen apo në rastet kur arrijnë në gjykata, dënimet e lëshuara nga gjykatësit janë shumë të ulëta. Përkundër një kornize ligjore mjaft gjithëpërfshirëse, koordinimi ndërmjet institucioneve vazhdon të jetë i pamjaftueshëm me planet e veprimit të cilat nuk zbatohen në tërësi dhe shpesh mungojnë zotimet financiare nga ana e qeverisë. Në Kosovë ende ekzistojnë sfida edhe në aspektin legjislativ për të i përputhur ligjet dhe mekanizmat ekzistues me kërkesat e reja të Konventës së Këshillit të Evropës e ashtuquajtur Konventa e Stambollit, për luftë kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Në Kodin e ri Penal të aprovuar në vitin 2018, dhuna në familje është vepër penale. Sipas Raportit Vlerësues mbi Dhunën në Familje, gjykatat dhe prokuroritë konsiderojnë bashkimin familjar si qëllimin kryesor dhe shpesh viktimat fajësohen apo edhe turpërohen nga sistemi.¹³²

¹³⁰ Shih mendimin juridik të Avokatit të Popullit, në cilësinë e mikut të gjykatës, për Gjykatën Themelore në Prishtinë, lidhur me gjendjen e homofobisë dhe transfobisë. Në http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/689-2017,_Amicus_Curia_458487.pdf.

¹³¹ Ky nen parasheh që “...Shkeljet e dispozitave të këtij Ligji, në rastet kur përbëjnë vepra penale, dënohen sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës...” (Ligji kundër Diskriminimit, Neni 17).

¹³² Mu aty, faqe 55.

Si qasje më efektive duhet kuptuar se siguria e viktimës është më e rëndësishme sesa bashkimi i familjes me çdo kusht (Raporti Vlerësues mbi Dhunën në Familje, 2015:55). **Shkelja e urdhrave mbrojtës është akt kriminal, që konsiderohet vepër penale.** Mirëpo siç janë të dizajnuara ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Kodi Penal, ndarjet e tilla në procedurat e ndryshme dhe kuptohet nga organet përgjegjëse se dhuna në familje është çështje civile dhe pjesë e procedurave të gjykatave civile e nuk konsiderohet si vepër penale e kryer në familje. Ky organizim ligjor po ashtu ndikon në minimizimin e rëndësisë së dhunës. Strategjia e re e hartuar nga Qeveria e Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2016-2020 gjithashtu ka adoptuar këtë qasje të analizës duke tentuar të adresojë trajtimin e dhunës në familje në sistemin e drejtësisë penale.

Në përgjithësi, mungesa e kodifikimit të të drejtave të shumta të mbrojtura në një procedurë të veçantë, duke lënë disa të drejta të përkufizuara në dispozitat ligjore civile sikurse Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje apo të drejtat e tjera të ofruara në procedurat penale, mbetin sfida në ofrimin e mbrojtjes adekuate viktimave të dhunës në familje. Kjo qasje e limituar vjen edhe si rrjedhojë e mungesës së një perspektive më sensitive gjinore dhe duhet dhënë vëmendje të veçantë në mënyrë që shoqëria të tregojë se nuk do të tolerojë një dhunë të tillë në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror.¹³³

Shërbimet për kryesit e dhunës në familje, mbetin të limituara përkundër legjislacionit dytësor që parasheh edhe masa të trajtimi psiko-social. Shërbimet për kryesit e dhunës në familje ofrohen nga disa organizata joqeveritare mirëpo në mënyrë sporadike (Profili Gjinor i Kosovës, 2014:24). Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (PSV-të),¹³⁴ dukshëm kanë përmirësuar qasjen në ofrimin e ndihmës dhe mbrojtjes viktimave (Ibid, 2014:4). Në 11 komuna janë themeluar Mekanizmat Lokal Kundër Dhunës në Familje, të përbërë nga përfaqësuesit e institucioneve relevante që merren me parandalimin, mbrojtjen dhe mbështetjen e rasteve të dhunës në familje. Megjithatë, ende vazhdojnë shqetësimet lidhur me ko-koordinimin dhe kuptimin e plotë të ndihmës duke u përqendruar në nevojat e viktimave. Qendrat për Punë Sociale, asistojnë në rastet kur rrezikohen familjet dhe kur viktimat janë fëmijë, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare si dhe Ligjin mbi Familjen. Për këto Qendra, përballen me sfida lidhur me kapacitetet e tyre, përfshirë këtu burimet financiare, njerëzore dhe teknike.

Shpesh mungesa e burimeve të nevojshme, paragjykimet dhe kuptimi i dhunës gjinore si dhe qasja e ofrimit të ndihmës deri në “ndërmjetësimin” e rastit dhe kthimin e viktimës në ambientin familjar, janë sfida evidente në zbatimin e ligjeve kundër dhunës në familje (Profili Gjinor i Kosovës, 2014:24). Vullneti i pamjaftueshëm politik, fondet e pamjaftueshme në ofrimin e shërbimeve nga ana e strehimoreve si dhe kapacitetet institucionale vazhdojnë të mbetin sfida për zbatimin e kornizës ligjore sa i përket dhunës në familje (Profili Gjinor i Kosovës, 2014:4).

¹³³ Shih më lartë, përmbledhja e rekomandimeve nga Raporti i Vlerësimit.

¹³⁴ Shih Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhunë në Familje, Agjencia për Barazi Gjinore e Kosovës, 2013. Në <http://abgj.rksgov.net/Portals/0/Procedurat%20Standarte%20t%C3%AB%20Veprimit%20p%C3%ABr%20Mbrojtje%20nga%20Dhuna%20n%C3%AB%20Familje.pdf>

4. Objektivat e Programit Kombëtar për Barazi Gjinore

Qëllimi i Programit të Kosovës për Barazi Gjinore synon të sigurojë që barazia gjinore është në qendër të proceseve transformuese në Kosovë, në kuadër të të gjitha strukturave, institucioneve, politikave, procedurave, praktikave dhe programeve të qeverisë, agjencive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit të donatorëve

SHTYLLA: FUQIZIMI EKONOMIK DHE MIRËQENIA SOCIALE

Objektivi strategjik 1: Krijimi i mundësive të barabarta për të kontribuar në dhe përfituar nga zhvillimi ekonomik gjithëpërfshirës dhe përmirësimin e mirëqenies sociale. Ky objektivi ka për qëllim të siguroj avancoj fuqizimin ekonomik dhe përmirësim të mirëqenies sociale të grave, duke përmirësuar shpërndarjen e barabartë të fondet publike dhe pjesëmarrjen e grave në menaxhimin e burimeve. Objektivi strategjik do të realizohet me ndihmën e dy objektivave specifik të mëposhtëm:

- **Rritja e punësimit të grave dhe vajzave**

Synimi kryesor i këtij objektivi specifik është të sigurohen mundësi për rritjen e aktivizimit të grave në tregun e punës dhe rritjen e shkallës së punësimit të tyre. Për të arritur këtë objektivi, aktivitetet do të kryhen në drejtimet në vijim:

- Ngritja e shkathtësive të grave, në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke u fokusuar edhe në fushat deficitare;
- Adresimin e diskriminimit në punësim, përmes ndryshimit të Ligjit të Punës, për të garantuar pushimin prindëror, pushimin e lehonisë dhe pushimin atësor, në pajtim me direktivën e BE-së për balancë të jetës dhe punës;
- Ofrimi i qasjes në shërbime sociale dhe familjare cilësore, qendra rezidenciale për përkujdesje ditore për të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara, duke lehtësuar kështu mundësitë e grave për tu aktivizuar në tregun e punës; dhe
- Ofrimin e mbështetjes financiare, qasja në programe mikrokreditore dhe financimi përmes bashkimeve kreditore, janë planifikuar për të rritur angazhimin e grave në ndërmarrësi dhe rritjen e bizneseve në pronësi të grave.
- **Sigurimi/avancimi i qasjes së barabartë në të drejta, liri, vendimmarrje, burime dhe shërbime.** Synimi kryesor i këtij objektivi specifik është të sigurohet që gratë kanë qasje të barabartë në të drejta, burime dhe shërbime. Më specifikisht ky objektivi synon të sigurojë shpërndarje të barabartë në fondeve publike, financa dhe shërbime. Aktivitetet do të kryhen në këto drejtime:
 - Zhvillimit të kornizës ligjore, udhëzuesve, dhe ngritjes së kapaciteteve për të mundësuar zbatimin e plotë dhe të saktë të Ligjit për Barazi Gjinore, në nivelin qendror dhe lokal si dhe konventave dhe standardeve ndërkombëtare për barazi gjinore, siç është Konventa CEDAW, Konventa e Stambollit, Platforma e Pekinit për Veprim dhe Agjenda 2030. Këtu përfshihet edhe hartimi i aktit ligjor dhe ngritja e kapaciteteve për mënyrën e zbatimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor; Zhvillimi i treguesve të matshëm, të cilët duhet raportuar në intervale të rregullta kohore, për të përcjellë progresin dhe pengesat në arritjen e barazisë gjinore;
 - Integritet të perspektivës gjinore në politikat publike, shpërndarjes së informatave, dizajnit të shërbimeve dhe mbështetjes në përputhje me kërkesat dhe nevojat e të dy gjinive.
 - Zgjerimi dhe zhvillimi i Masave Aktive të Punësimit, duke iu përshtatur nevojave dhe kërkesave edhe të grave;
 - Realizimi i të drejtës në pronë dhe trashëgimi; dhe

- Uljen e informalitetit dhe përmirësimit të kushteve në vendin e punës.

Për Objektivën e 1-rë Strategjike janë përcaktuar synimet e mëposhtme:

		Vlera bazë 2017/18	Synimi 2021- 2022	Synimi 2024
1	Objektivi strategjik 1: Krijimi i mundësive të barabarta për të kontribuar në dhe përfituar nga zhvillimi ekonomik gjithëpërfshirës dhe përmirësimin e mirëqenies sociale			
1	Shkalla e punësimit tek gratë (%)	12.3% ¹³⁵	17%	20%
2	Shkalla e varfërisë (%)	17.6% ¹³⁶	15%	13%
	Objektivi specifik 1.1: Rritja e punësimit të grave dhe vajzave			
3	Shkalla e pjesëmarrje së grave në tregun e punës (%)	19.4% ¹³⁷	30%	40%
4	Pjesëmarrja e grave si pronare të bizneseve (%)	11%	15%	18%
5	%ja e të rinjve as të punësuar, as në arsim e as në trajnim (NEET) (%)	30.1% F: 30.0; M: 30.2%	24%	20%
6	Shkalla e regjistrimit të pronës shtëpi/banesë në emër të grave (%)	12	18	25
	Objektivi Specifik 1.2 Sigurimi/avancimi i qasjes së barabartë në të drejta, liri, vendimmarrje, burime dhe shërbime			
7	% e politikave publike me perspektivë gjinore të integruar (%)	Nuk ka të dhëna	100% e politikave të reja publike me perspektivë gjinore të integruar 30% e politikave publike të MPMS-së, MTI-së, MZHE, MBPZHR dhe MIN ekzistuese me perspektivë gjinore	100% e politikave të reja publike me perspektivë gjinore të integruar 70% e politikave publike të MPMS-së, MTI-së, MZHE, MBPZHR dhe MIN ekzistuese me perspektivë gjinore
8	Shkalla e pjesëmarrjes së grave në fondet publike dhe ndihmës ndërkombëtare (në vlerën monetare të fondeve të ofruara)	Nuk ka të dhëna për të gjitha institucionet	30%	40%

¹³⁵ ASK, 2019. Anketa e Fuqisë Punëtore 2018: <http://ask.rks-gov.net/media/4671/anketa-e-tregut-te-punes-2018.pdf>

¹³⁶ Bazuar në kufirin e varfërisë (2015): 1.82 EUR në ditë për ekuivalentin për të rritur. Llogaritur me të dhënat e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. KAS (Prill, 2017). Marrë nga: <http://ask.rks-gov.net/media/3186/stat-e-varferise-2012-2015.pdf>

¹³⁷ ASK, 2019. Anketa e Fuqisë Punëtore 2018: <http://ask.rks-gov.net/media/4671/anketa-e-tregut-te-punes-2018.pdf>

9	Norma e punësimit joformal, përjashtuar sektorin e bujqësisë (%)	14% ¹³⁸	10%	8%
10	Shkalla e mbulueshmërisë së familjeve të varfëra nga Skemat e Ndihmës Sociale ¹³⁹ (%)	45% ¹⁴⁰	50%	70%

SHTYLLA II: Zhvillimi Njerëzor dhe Rolet dhe Marrëdhëniet Gjinore

Objektivi strategjik 2: Avancimi i barazisë gjinore, përmes arsimit dhe shëndetësisë cilësore, gjithë përfshirjes, dhe shfrytëzimit të kapaciteteve njerëzore si kontribuues në zhvillimin e qëndrueshëm njerëzor dhe zhdukjen e pabarazive dhe stereotipeve gjinore. Ky objektivi ka për qëllim të kontribuojë në avancimin e zhvillimit njerëzor me anë të gjithëpërfshirës sociale, politike dhe ekonomike të vajzave dhe grave në arsim, kujdes dhe edukim shëndetësor, dhe transformimit të strukturave shtypëse gjinore me qëllim të avancimit të barazisë dhe demokracisë shoqërore. Kjo do të realizohet përmes identifikimit të vazhdueshëm të pabarazive gjinore në arsim, shëndetësi, media, sport, kulturë, në institucionet dhe relacionet publike dhe private, për të prodhuar dhe gjeneruar politika dhe praktika të cilat përkrahin dhe krijojnë mundësi të shfrytëzimit gjithëpërfshirës dhe zhvillim të kapaciteteve njerëzore.

• Barazia gjinore trajtohet si kusht për arsim cilësor, gjithëpërfshirës

Arsimi formal dhe jo-formal ka rol kyç dhe formësues në krijimin e vlerave mbi barazinë shoqërore dhe relacionet e barabarta gjinore. Arsimi cilësor mundëson hapësirën për ndërtimin e një shoqërie demokratike të bazuar në gjithë përfshirje të kapaciteteve, shfrytëzim dhe avancim të potencialit njerëzor të saj. Qëllimi i këtij objektivi është të rritet pjesëmarrja e vajzave në arsim, adresimin e ndarjes së profesioneve në baza gjinore, avancimin e qasjes së vajzave dhe grave në grante hulumtuese dhe zhvillim profesional akademik rritja e pjesëmarrjes së grave në pozita vendimmarrëse në institucionet e arsimit dhe eliminimin e stereotipeve gjinore nga plan programet dhe tekstet mësimore. Aktivitetet do të kryhen në drejtimet si në vijim:

- o Monitorimit të vazhdueshëm të braktisjes së shkollimit; dhunës në baza gjinore/ seksuale në shkolla; diskriminimit gjinor në përmbajtjen dhe praksat e sistemit arsimor (institucioneve arsimore dhe qeveritare);
- o Organizimin e aktiviteteve vetdijësuese dhe politika publike për t'i kontribuar parandalimit të braktisjes së shkollimit;
- o Krijimin e mundësive dhe qasjes në shërbime për kujdesin e fëmijëve dhe të moshuarve;
- o Integrimin e studimeve gjinore në sillabuset e lëndëve dhe zhvillimi i lëndëve nga studimet gjinore në IAL;
- o Krijimin e skemave mbështetëse për vajzat dhe gratë për t'u angazhuar dhe avancuar në punë (bursa, institucione të kombinuara/ alternative për ofrimin e kujdesit parashkollor, aftësim profesional);
- o Eliminimin e stereotipeve gjinore, gjuhës dhe praktikës pedagogjike diskriminuese nga plan programet dhe tekstet mësimore;
- o Ngritjen e kapaciteteve të sistemit arsimor për ti zbatuar mekanizmat ekzistues për arritjen e barazisë gjinore; dhe
- o Rritjen e pjesëmarrjes së grave në pozita vendimmarrëse, në planifikim dhe menaxhim, mësimdhënie dhe kërkim shkencor.

138 ASK, 2019. Anketa e Fuqisë Punëtore 2018: <http://ask.rks-gov.net/media/4671/anketa-e-tregut-te-punes-2018.pdf>.

139 E parashikuar në Strategjinë Sektoriale 2018-2022, të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

140 Llogaritur duke pjesëtuar numrin e përfituesve të Skemës së Ndihmës Sociale (25,943 familje në vitin 2015) – (10% që supozohet se janë përfitues por nuk janë familje të varfëra) me numrin total të familjeve që jetojnë nën kufirin e varfërisë së skajshme. Numri i familjeve që jetojnë nën kufirin e varfërisë së skajshme është llogaritur duke shumëzuar shkallën e varfërisë së skajshme për vitin 2015 (5.2%) me numrin total të ekonomive familjare në Kosovë në bazë të Regjistrimit të Popullsisë (2011), përafërsisht 295,000 familje. Përderisa të dhënat mbi shkallën e varfërisë së skajshme janë marrë nga raportit i fundit i Varfërisë në Konsum 2012-2015 (KAS, 2017), të dhënat për numrin e përfituesve të Skemës së Ndihmës Sociale janë marrë nga të dhënat administrative të DPSF-së.

- **Krijimi i mjedisit të favorshëm për realizimin e të drejtave, kapaciteteve dhe potencialeve njerëzore**

Ky objektiv synon të kontribuoj në avancimin e barazisë gjinore duke theksuar të drejtën themelore për mundësi të papenguar në realizimin e kapaciteteve dhe potencialeve të vajzave dhe grave, eliminimin e praktikave diskriminuese shoqërore (në bazë të gjinisë, etnisë, moshës, dhe aftësisë) dhe krijimin e politikave të cilat përkrahin dhe avancojnë pjesëmarrje të barabartë të grupeve të marginalizuara. Avancim të pjesëmarrjes së grave dhe standardeve/njohurive profesionale-etike për t'i luftuar stereotipet dhe diskriminimin gjinor në media. Ky objektiv synon rritjen e përfshirjes së vajzave dhe grave në sport, përfaqësimin adekuat të imazhit të grave në media. Aktivitetet do të kryhen në drejtimet si në vijim:

- o Monitorimin dhe vlerësimin i implementimit të Ligjit për Barazi Gjinore, vendimmarrjen dhe përfshirjen e perspektivës gjinore në institucione, organizata dhe ndërmarrje;
 - o Përkrahje financiare për avancim profesional, infrastrukturë dhe ndërgjegjësim publik për ngritjen e pjesëmarrjes së vajzave grave në sport;
 - o Hartimi i politikave të reja, përplotësuese, për përfaqësim të barabartë gjinor në organizata mediatike dhe politika editorial;
 - o Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere, përmirësim/krijim të infrastrukturës dhe legjislacionit, trajnimit profesional, krijim të mundësive për avancim profesional dhe në karrierë, duke e synuar krijimin e vullnetit të qëndrueshëm politik për arritjen e barazisë gjinore dhe shfrytëzimit të potencialeve njerëzore;
 - o Krijim i sistemit monitorues dhe raportues për imazhin e grave në media;
 - o Hartimin dhe akreditimin e programit të trajnimit për gazetarë në fushën e barazisë gjinore dhe luftimit të ekstremizmit të dhunshëm;
 - o Aktivitete vetëdijësuese për organizatat mediale mbi LBGJ dhe Ligjin Kundër Diskriminimit;
 - o Hulumtime mbi hapësirat publike, trashëgiminë kulturore, dhe gjininë; dhe
 - o Krijimi dhe avancimi i programeve për punë praktike në fusha inovative dhe/apo deficitare është kyç për zhvillimin e mundësive për vajzat dhe gratë dhe integrimin e tyre ekonomik dhe shoqëror.
- **Gjithë përfshirja në kujdesin cilësor shëndetësor dhe edukimi shëndetësor i popullatës mbi barazinë gjinore, planifikimin familjar dhe shëndetin riprodhues.**

Politikat shëndetësore dhe arsimore janë themel për zhvillim të qëndrueshëm njerëzor. Kjo objektivë thekson nevojën për përkushtim politik dhe profesional të institucioneve dhe punëtorëve shëndetësor ndaj grupeve vulnerable të cilat ballafaqohen me barriera të ndryshme në shërbimet shëndetësore (gratë dhe vajzat, personat me aftësi të kufizuar dhe banorët e zonave rurale, minoritetet etnike dhe seksuale). Aktivitetet e identifikuar mund të përmbledhen në tri fusha të veprimit: a) Parandalimi, Mjedisi dhe Edukimi; b) Qasja në shërbime me fokus zonat rurale dhe grupet e marginalizuara; dhe c) Shëndeti riprodhues dhe planifikimi familjar. Aktivitetet do të kryhen në drejtimet si në vijim:

- o Monitorimi dhe vlerësimi në të tri fushat duke përfshirë: integrimin e të dhënave personale në SISH për shëndetin e gruas, nënës dhe fëmijës (duke përfshirë edhe dhunën);
- o Përmirësimin e cilësisë së metodologjisë për mbledhjen e të dhënave dhe raportimit për shtatzënat dhe lehonat;
- o Hulumtime mbi praktikën e planifikimit familjar (abortit selektiv, qasja në dhe vendimmarrja mbi përdorimin e kontraceptivëve, etj.);
- o Amendamenti i akteve ligjore ekzistuese (amendamentim të definicionit ekzistues të abortit, përfshirja e mjeteve kontraceptive dhe abortit në Ligjin për Sigurime Shëndetësore, etj.);

- o Hartimi i programeve edukative dhe vetëdijesuese, veçanërisht në vendbanimet rurale, me fokus të veçantë shëndetin riprodhues;
- o Hartimi i udhërrëfyeseve dhe protokolleve për trajtim dhe monitorim të indikatorëve të cilësisë, përmirësimi i qasjes në shërbime në vendet rurale, dhe transferimi i kompetencave tek profesionistët në kujdesin parësor;
- o Ngritja e kapaciteteve profesionale (të punëtorëve shëndetësor, mësimdhënësve, mediave, OJQ-ve) për promovim dhe edukim shëndetësor, përfshirë shëndetin riprodhues dhe nevojat specifike shëndetësore të femrave dhe meshkujve;
- o Organizimi i aktiviteteve vetëdijesuese për shëndetin mendor (bullizmi, ngacmimi seksual, bulimia, anoreksia, seksualitetin, etj.);
- o Prodhimi dhe distribuimi i materialeve për informim, edukim dhe komunikim për shëndetin riprodhues dhe seksual, numri i shtuar i trajnimeve, si dhe mjekëve dhe psikologëve në shkollë;
- o Harmonizimi me trajnimin e mësimdhënësve në shkollat promovuese për informim, edukim dhe komunikim për shëndetin riprodhues dhe seksual;
- o Zgjerimi i vizitave mjekësore në shtëpi për nëna dhe fëmijë, si dhe përfshirja e shtuar e nënave dhe fëmijëve të komuniteteve Rome, Ashkali dhe Egjiptase;

Për Objektivin e 2-të Strategjik janë përcaktuar synimet e mëposhtme:

		Vlera bazë 2017/18	Synimi 2021-2022	Synimi 2024
	Objektivi Strategjik 2. Avancimi i barazisë gjinore, përmes arsimit dhe shëndetësisë cilësore, gjithë përfshirjes, dhe shfrytëzimit të kapaciteteve njerëzore si kontribuues në zhvillimin e qëndrueshëm njerëzor dhe zhdukjen e pabarazive dhe stereotipeve gjinore			
	Cilësia e rritur e arsimit, shëndetësisë dhe fuqizimi i rolit të gruas në sport dhe kulturë ¹⁴¹			
	Objektivi specifik 2.1 Barazia gjinore trajtohet si kusht për arsim cilësor, gjithëpërfshirës			
1	%ja e grave drejtore në shkollat e arsimit parauniversitar (%)	13	30	50
2	%ja e teksteve shkollore të redaktuara për qasje gjinore (eliminim i stereotipave) (%)	0	50	100
3	%ja e fëmijëve në institucione parashkollore-shkalla bruto e regjistrimit (%)	3	4.5	6
4	%ja e vajzave/grave të moshës 25-64 vjeçare që kanë përfunduar arsimin e lartë (%)	8	15	30
5	%ja e fëmijëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas në sistemin e arsimit (%)	85.3% në arsimin fillor, 85% dhe 50% në atë të mesëm të ulët dhe mesëm të lartë respektivisht	Rritet për 10% në arsimin fillor, Në arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë për 20%	Rritet për 10% në arsimin fillor, Në arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë për 20%

141. Për shkak të natyrës ndërsektoriale, për këtë indikator nuk është e mundur të caktohet një indikatorë i përbashkët. Progresi do të matet përmes indikatorëve specifik, për secilin objektiv specifik.

6	Numri i programeve në kurrikulat e arsimit të lartë që kanë të integruar perspektivën gjinore (numri)	7	10	15
Objektivi specifik 2.2 Krijimi i mjedisit të favorshëm për realizimin e të drejtave, kapaciteteve dhe potencialeve njerëzore				
7	Krijimi i sistemit monitorues dhe raportues për imazhin e grave (reprezentimet gjinore) në media	0	Sistemi i krijuar dhe funksional	6 hulumtime
8	Përfshirja e vajzave dhe grave në sport (%)	Nuk ka të dhëna	3 klube të udhëhequra nga vajzat/gratë 50% e buxhetit për sport i dedikuar aktiviteteve sportive të vajzave	6 klube të udhëhequra nga gratë 50% e buxhetit për sport i dedikuar aktiviteteve sportive të vajzave
Objektivi specifik 2.3 Gjithë përfshirja në kujdesin cilësor shëndetësor dhe edukimi shëndetësor i popullatës mbi barazinë gjinore, planifikimin familjar dhe shëndetin riprodhues				
9	Integrimi i të dhënave personale në SISH për shëndetin e gruas, nënës dhe fëmijës (duke përfshirë edhe dhunën në baza gjinore) (% e të dhënave)	Sistemi nuk është funksional	Sistemi i funksionalizuar	50% e të dhënave të regjistruara në sistem
10	Përmirësimi i qasjes në shërbime për lehonat dhe foshnjat (% e lehonave foshnjave të vizituara në shtëpi)	Nuk ka të dhëna	10% e lehonave të vizituara në shtëpi	30% e lehonave të vizituara në shtëpi
11	Avancimi i edukimit dhe vendimmarrjes tek vajzat, djemtë, gratë dhe burrat për shëndetin seksual dhe riprodhues (%)	Mungon	Zbatimi i programit në të gjitha nivelet dhe institucionet (100%)	Zbatimi i programit në të gjitha nivelet dhe institucionet (100%)
12	Numri i lindjeve tek adoleshentët 10-14 dhe 15-19 vjeçare (numri i rasteve)	761	380	190

Objektivi strategjik 3: Avancimi i realizimit të të drejtave në vendimmarrje, paqe, siguri dhe drejtësi garantues i arritjes së barazisë gjinore

Ky objektivi ka për qëllim të sigurojë, përmirësojë dhe rrisë zbatimin e qasjes në drejtësi vendimmarrje, paqe dhe siguri duke promovuar specifikuat barazinë gjinore në sektorin e drejtësisë dhe sigurisë në mënyrë që të arrihet stabiliteti shoqëror dhe siguria e përgjithshme. Kjo do të realizohet përmes integrimit të perspektivës gjinore në ligje dhe politika, fuqizimit të mekanizmave institucional për qasjen në drejtësi, kërkohet pjesëmarrje e barabartë për gratë me burrat në përputhje me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore, krijimit të një ambienti të sigurt dhe jo diskriminues për gratë dhe burrat në sektorin e sigurisë si dhe ngritjen e pjesëmarrjes së grave në proceset e negociatave, paqes dhe pajtimit. Objektivi strategjik do të realizohet me ndihmën e dy objektivave specifik të mëposhtëm:

- **Fuqizimi i mekanizmave institucional dhe ngritja e vetëdijes shoqërore për qasjen në drejtësi**

Synim kryesor të këtij objekti specifiku ka rritjen e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, politike -bërje, procesin e ndërtimit të paqes dhe qasjen në drejtësi duke adresuar boshllëqet ligjore ku synohet harmonizimi ligjor si dhe rishikimi i legjislacionit sekondar me atë primar me Ligjin për barazinë gjinore veçanërisht, në përkufizimin e dhunës në familje, ngacmimit seksual të drejtës në pronë dhe trashëgimi, reformën zgjedhore dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në parti politike. Aktivitetet do të kryhen në drejtimet si në vijim:

- o Zbatimit adekuat të ligjeve, ndryshimit dhe hartimit të ligjeve dhe politikave të reja në realizimin e të drejtave;
- o Harmonizimit të kornizës ligjore, përmes përfshirjes së normave jo diskriminuese gjinore në kuadrin ligjor të përgjithshëm të vendit, në përputhje me kërkesat e Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të) të Kombeve të Bashkuara dhe në përputhje me Acqui e BE-së për Barazi Gjinore;
- o Caktimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të profilizuar të cilët merren me raste familjare, të dhunës në familje, të dhunës seksuale gjatë luftës, konteksteve pronësore dhe të trashëgimisë.
- o Trajnime të gjyqtarëve, prokurorëve, dhe policëve sa i përket definicioneve të reja dhe të sapo adoptuara në Kodin Penal të Kosovës, me theks të veçantë dhunën në familje dhe ngacmimin seksual. Përmirësimit të të dhënave për viktimat dhe kryesit e dhunës në familje;
- o Sensibilizimit shoqëror për përmbushjen e të drejtave të grave të cilat janë të parapara me ligje por dhe luftimi i fenomeneve negative siç është dhuna në familje, stereotipet gjinore, mentaliteti patriarkal;
- o Përgatitjes së analizave të situatës për ta kuptuar më qartazi situatën e vajzave dhe grave të ndaluara në sistemin korrektues, respektivisht të burgosura, përfshirë qasjen e tyre në shërbimet e shëndetit riprodhues,
- o Ofrimi i informacioneve dhe trajnimeve për vajzat dhe gratë në sistemin korrektues dhe në burgje lidhur me të drejtat e tyre, përfshirë të drejtën në rehabilitim dhe në re integrim
- o Fuqizimin e kapaciteteve të Komisionit qeveritar për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës dhe organizatave të licencuara në kuadër të këtij procesi për të rritur qasjen e grave në drejtësi.

- **Rritet pjesëmarrja dhe përfaqësimi i barabartë në procesin e vendimmarrjes në përputhje me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore**

Synimi i këtij objekti specifiku është të ngritën kapacitetet për monitorimin e zbatimit të Ligjit për barazi gjinore brenda institucioneve publike, duke qenë se këto të fundit kanë obligime dhe përgjegjësi qoftë në politik- bërje që garanton barazinë gjinore por dhe në zbatimin e tyre. Aktivitetet do të kryhen në drejtimet si në vijim:

- o Harmonizimin dhe plotësimin e ligjeve: me fokus tek ligji për zgjedhje, ligji për financimin e partive politike si dhe vet rregullorja e punës së Kuvendit të Kosovës në mënyrë që të jenë në përputhje me ligjin për barazi gjinore, mbi të gjitha të garantohet pjesëmarrja e barabartë gjinore në vendimmarrje;
- o Zbatimin e masave afirmative nga institucionet publike përfshirë ato të sigurisë, në funksion të zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore që gratë të përfaqësojnë 50% të të punësuarve në të gjitha nivelet
- o Mbështetja e grave të cilat tashmë janë pjesë e institucioneve publike për të garantuar

avancimin e tyre profesional me anë të ofrimit të bursave si dhe trajnimeve të nevojshme për leadership për avancimin e tyre në pozitat vendimmarrëse qoftë në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal;

- o Organizimin e fushatave ndërgjegjëse dhe aktiviteteve mbi transparencën dhe alokimin e barabartë të fondeve për gratë dhe burrat në parti politike; dhe
- o Fuqizimit i grave asambleiste me anë të aktiviteteve ndërgjegjëse dhe vetëdijesuese për barazinë gjinore, si dhe fuqizimi i grave deputete ne përgjithësi konsiderohet i rëndësishëm.
- **Krijimi i një mjedisi të sigurt dhe jo diskriminues për gratë dhe burrat në sektorin e sigurisë**

Ky objektivi specifik synon të adresoj krijimin e një mjedisi të sigurt dhe jo diskriminues në sektorin e sigurisë në radhe të parë duke rritur përqindjen e grave të punësuar në sektorin e sigurisë. Ky objektivi synohet të arrihet me anë të një numri të aktiviteteve të cilat do të identifikojnë mënyrat më adekuate në përmbushjen e objektivës. Aktivitetet do të kryhen në drejtimet si në vijim:

- o Një analizë e gjendjes është e nevojshme me anë të një hulumtimi mbi format e diskriminimit dhe mjedisit në sektorin e sigurisë si aktivitet i paraparë, ndërsa nisur edhe nga praktikata e kaluara vlerësohet si i rëndësishëm krijimi i një bordi këshillues për gratë, paqen dhe sigurinë brenda institucioneve të sigurisë për integritet më të mirë të perspektivës gjinore në këtë sektor.
- o Rishikimi dhe avancimi i kurrikulës së institucioneve të sigurisë nga perspektiva gjinore dhe në përputhje me ligjin për barazinë gjinore;
- o Organizimi i fushatave vetëdijesuese për të inkurajuar gratë për tu bërë pjesë e sektorit të sigurisë.
- **Ngritja e pjesëmarrjes së grave në proceset e negociimit, paqes dhe pajtimit, përfaqësive diplomatike dhe misioneve jashtë vendit**

Ky objektivi synon lobimin dhe avokimin për përfshirjen e grave në proceset e paqes, të negociimit dhe pajtimit përfshirë në mekanizmat qeveritar apo dhe të komisioneve për ballafaqimin me të kaluarën duke përfshi edhe pjesëmarrjen e grave nga etnitë e ndryshme. Po ashtu duhet adresuar edhe çështja e reparacionit për të mbijetuarat e dhunës seksuale në mënyrë që proceset e dialogut përfshirë edhe dialogun e tanishëm ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të diskutohet edhe çështja e krimeve të luftës dhe dhunës seksuale të ushtruara ndaj grave në periudhën e luftës në Kosovë 1998-1999. Aktivitetet do të kryhen në drejtimet si në vijim:

- o Krijimit të bazës së shënimeve për gratë të cilat janë pjesëmarrëse në aktivitete emergjente dhe humanitare jashtë vendit;
- o Lobimi dhe avokimi lidhur me përfshirjen e grave në procesin e negociimit, paqes dhe pajtimit;
- o Organizimi i debateve publike për përfaqësimin e grave në proceset e negociimit, paqes dhe pajtimit.

Për Objektiven e 3-të Strategjike janë përcaktuar synimet e mëposhtme:

	Vlera bazë 2017/18	Synimi 2021-2022	Synimi 2024
Objektivi Strategjik 3: Avancimi i realizimit të të drejtave në vendimmarrje, paqe, siguri dhe drejtësi garantues i arritjes së barazisë gjinore			

1	Shkalla e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave në institucione publike ¹⁴²	Nuk ka të dhëna	30	40
2	%ja e rasteve të dhunës në familje që trajtohen nga gjyqësori	Nuk ka të dhëna	70	100
Objektivi Specifik 3.1 Fuqizimi i mekanizmave institucional dhe ngritja e vetëdijes shoqërore për qasjen në drejtësi				
3	Numri i masave afirmative të reja të ndërmarra për promovimin e barazisë gjinore dhe parimeve jo-diskriminuese (numri)	3	1	1
4	Rishikimi i Politikës Ndëshkimore për zbatimin adekuat të sanksioneve për kryesit e dhunës në baza gjinore, përfshi edhe dënimet adekuate për rastet e trafikimit me qeniet njerëzore (numri)	Miraturar	Të rishikohet	Kompletuar
5	%ja e aplikacioneve të vlerësuara nga Komisioni për Verifikim, brenda afatit ligjor		70	100
6	%ja e vajzave dhe grave që kanë përjetuar dhunë fizike dhe psikologjike	Nuk ka të dhëna ¹⁴³	n/a	n/a
Objektivi Specifik 3.2 Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të barabartë në procesin e vendimmarrjes në përputhje me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore				
6	Shkalla e përfaqësimit të grave në pozita drejtuese dhe të larta drejtuese në ministri dhe agjenci ekzekutive në nivelin qendror (%)	27	28	30
7	Shkalla e përfaqësimit të grave në pozita drejtuese dhe të larta drejtuese në nivelin komunal (%)	20	25	30
8	Shkalla e përfaqësimit të grave në Kuvend qe Kosovës (%)	32	50	50
9	Shkalla e përfaqësimit të grave në Kuvende Komunale (%)	33.4	50	50
Objektivi Specifik 3.3 Krijimi i një mjedisi të sigurt dhe jo diskriminues për gratë dhe burrat në sektorin e sigurisë				
10	Shkalla e përfaqësimit të grave brenda FSK-së (%)	9	12	15
11	Shkalla e përfaqësimit të grave brenda Policisë së Kosovës (%)	14.2	18	20
12	Shkalla e përfaqësimit të grave gjyqtare në sistemin e drejtësisë (%)	45	50	50
Objektivi Specifik 3.3 Ngritja e pjesëmarrjes së grave në proceset e negociimit, paqes dhe pajtimit, përfaqësive diplomatike dhe misionëve jashtë vendit				
13	Shkalla e përfaqësimit të grave në misionet diplomatike jashtë vendit në përputhje me kërkesat e LBGJ-se duke përfshirë përfaqësimin e barabartë gjatë emërimit të atashëve ushtarak dhe policore (%)	31	40	50

142 Për shkak të natyrës ndërsektoriale të këtij indikator, synimi është llogaritur si mesatare e përfaqësimit të grave në sektorë të ndryshëm. Progresi do të matet përmes indikatorëve specifik për secilën objektivë specifike

143 Në mungesë të vlerave bazë, nuk mund të përcaktohet indikator. Në vitin 2020, do të realizohet një studim, dhe bazuar në gjetjet do të caktohen indikatorët synuar.

5. Aranzhimet e zbatimit, monitorimit dhe raportimit:

Institucioni udhëheqës për koordinimin e zbatimit të strategjisë është Agjencia për Barazi Gjinore/Zyra e Kryeministrit të Kosovës. Agjencia do të përcaktojë procedura më të detajuara të zbatimit, monitorimit dhe raportimit për institucionet pjesëmarrëse në baza vjetore, duke ndjekur parimet kryesore të mëposhtme:

- Raporti vjetor i progresit për arritjen e objektivave të PKBGJ-së dhe zbatimin e planit të veprimit do të hartohet në baza vjetore dhe do të paraqitet tek trupi Koordinues ndërministror I cili do të përbëhet nga përfaqësuesit e (1) ABGJ (2) institucioneve që zbatojnë dokumentin strategjik (3) Ministrisë së Financave (4) Zyrës së Planifikimit Strategjik (5) organizatave të shoqërisë civile (6) institucioneve të tjera relevante, për diskutim dhe për fillimin e veprimeve të mëtejshme, nëse është e nevojshme. Organi koordinues ndërministror do të kryesohet nga ABGJ
- ABGJ do të organizoj takime të rregullta për të koordinuar dhe bashkërenduar aktivitetet me institucionet, SHC dhe donatorët për të zbatuar, monitoruar dhe raportuar për PKBGJ
- Raporti vjetor i progresit do të japë informacione mbi progresin kundrejt objektivave dhe zbatimin e aktiviteteve. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet analizës së pengesave, sfidave dhe rreziqeve në lidhje me zbatimin e Programit.

Institucionet pjesëmarrëse do t'i japin informacione mbi progresin dhe sfidat institucionit udhëheqës e që në këtë rast është ABGJ-ja pas udhëzimit të lëshuar nga institucioni udhëheqës.

Funksionet kryesore të ABGJ-së në procesin e monitorimit dhe raportimit janë si në vijim:

- do të iniciojë krijimin e organit koordinues ndër-ministrior në përputhje me kërkesat e monitorimit dhe raportimit dhe të sigurojë funksionimin e tij.
- Të mbledh informacion nga ministritë pjesëmarrëse për zbatimin e dokumentit strategjik dhe planit të tij të veprimit.
- Të përgatis raportet e rregullta vjetore mbi zbatimin e dokumentit strategjik dhe raportin gjashtëmujor për zbatimin e planit të veprimit.
- Të organizojë punën e trupës ndërministrorë të koordinimit, për të cilin ato ofrojnë funksione të sekretariatit.
- Të nis diskutimet për çështje problematike, nëse është e nevojshme.
- Të publikojë raporte të rregullta në faqen e internetit të ministrisë pas miratimit të tyre nga organi përkatës.

Rolet kryesore të organit Koordinues ndërministror në procesin e zbatimit të PKBGJ janë si në vijim:

- Në mënyrë të rregullt takohet dhe diskuton progresin në zbatimin e objektivave, treguesve dhe veprimeve të dokumentit përkatës strategjik.
- Identifikon sfidat dhe pengesat për zbatimin e suksesshëm dhe propozon masat korrigjuese që duhet të ndërmerren nga institucionet zbatuese.
- Diskuton dhe miraton raporte të rregullta që do të dorëzohen në KPS.

Organi koordinues ndërministror do të takohet të paktën dy herë në vit për të diskutuar progresin. Nëse është e nevojshme, do të organizohen takime shtesë. ABGJ-ja si institucioni udhëheqës do të jetë sekretariat i organit ndërministror dhe do të mbështesë thirrjen e takimeve dhe përgatitjen e materialit për t'u diskutuar

Raporti vjetor përgatitet për të dhënë një llogari në zbatimin e dokumentit strategjik. Ai përgatitet deri në fund të tremujorit të parë të vitit vijues.

Raporti vjetor i monitorimit do të përshkruaj progresin e bërë drejt zbatimit të secilit objektiv të dokumentit strategjik. Do të paraqiten informacione se a janë arritur objektivat e treguesit dhe do të prezantohet progresi i përgjithshëm në zbatimin e aktiviteteve në kuadër të secilit objektiv si dhe resurset buxhetore. Do të prezantohen rezultate për reformat kyçe të zbatuara si dhe arsyet për çdo dështim për të arritur objektivat. Do të paraqitën mangësitë dhe sfidat, bashkë me rekomandimet për tejkalimin e mangësive dhe sfidave si dhe do të paraqiten edhe veprimet prioritare për të përmirësuar performancën. Në raportin monitorues do të vlerësohet çdo rrezik për zbatimin e PKBGJ-së dhe do të propozohen hapat për adresimin e rreziqeve të identifikuara. Rreziqet e tilla mund të lidhen me kapacitetin institucional, kapacitetin financiar, mjedisin rregullator, partneritetin dhe angazhimin e institucioneve të tjera, si dhe faktorët e tjerë të jashtëm të PKBGJ-së.

Përveç monitorimit të rregullt vjetor, PKBGJ-ja do t'i nënshtrohet vlerësimit të përkohshëm në vitin 2021 për të vlerësuar efektivitetin dhe efikasitetin e zbatimit. Vlerësimi përfundimtar do të bëhet në vitin 2023. Të dy vlerësimet do të jenë të pavarura (të jashtme) dhe Agjencia për Barazi Gjinore do të kërkojë mbështetje të jashtme.

6. Ndikimi buxhetor dhe zbatimi i PKBGJ-së

Zbatimi i planit të veprimit për 3 vitet e para do të kërkojë mjete financiare siç tregohet në tabelën më poshtë në milionë euro (MSH- mallra dhe shërbime, P- pagat, K - kapital, SG - grantet dhe subvencionet).

Tabela 10: Kostoja e Planit të Veprimit për periudhën 2020-2022, në mijëra (000) Euro.

Objektivat	2020				2021				2022			
	MSH	P	K	SG	MSH	P	K	SG	MSH	P	K	SG
Total	567	-	40	2,776	1,125	-	40	3,511	656	-	-	5,011
Krijimi i mundësive të barabarta për të kontribuar dhe përfituar në /nga zhvillimi ekonomik, rritjen e gjithë përfshirjes dhe përmirësimin e mirëqenies sociale	252	-	-	2,766	431	-	-	3,441	236	-	-	4,941
Avansimi i barazisë gjinore, përmes arsimit dhe shëndetësisë cilësore, gjithëpërfshirjes, dhe shfrytëzimit të kapaciteteve njerëzore si kontribuues në zhvillimin e qëndrueshëm njerëzor dhe zhdukjen e pabarazive dhe stereotipave gjinore	221	-	40	10	375	-	40	70	253	-	-	70
Avancimi i realizimit të të drejtave në vendimmarrje, paqe, siguri dhe drejtësi garantues i arritjes së barazisë gjinore	94	-	-	-	320	-	-	-	167	-	-	-
Totali:	3,383				4,676				5,668			
Totali 2020-2022	13,727											

Plani i Veprimit 2020-2022 të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 ka kosto buxhetore në vlerë prej 13,726,638 Euro. Kostoja buxhetore në vlerë prej 2,596,350 Euro do të financohet nga Buxheti i Kosovës, ndërsa shuma prej 11,140,288 Euro do të mbulohet nga donatorët. Donatorët kryesorë që pritet të mbështesin zbatimin e Planit të Veprimit të PKBGJ-së për periudhën 2020-2022 janë: Komision Evropian, SIDA, Agjencitë e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, dhe partnerët e tjerë ndërkombëtar.

Referencat

Instituti GAP, 2017, DISKRIMINIMI NË TREGUN E PUNËS Ndikimi i konkurseve në pabarazinë gjinore, http://www.institutigap.org/documents/48043_Raporti-Final%20analize%20punesimi%20i%20grave.pdf

ASK, 2013-2018, Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore 2012-2017: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/sociale/tregu-i-punes>

ASK, 2015, Regjistrimi i Bujqësisë 2014 - Rezultatet përfundimtare: <http://ask.rks-gov.net/media/1374/rezultatet-perfundimtare.pdf>

ASK, 2016, Varfëria në Konsum në Republikën e Kosovës 2012-2015: <http://ask.rks-gov.net/media/3186/stat-e-varferise-2012-2015.pdf>

ASK, 2016 Gratë dhe Burrat në Kosovë 2014/2015: [http://ask.rks-gov.net/media/2581](http://ask.rks-gov.net/media/2581/grate) / gratë

ASK, 2017, Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare 2016: <http://ask.rks-gov.net/media/3343/abef-2016-shqip.pdf> dhe <http://ask.rks-gov.net/media/3343/burra-2016-shqip.pdf>

MASHT, 2016, Statistikat e Arsimit në Kosovë 2015/16: <http://masht-smia.net/0a.pdf>

MASHT, 2016, Raport vjetor statistikor me tregues arsimorë 2015/16: <http://masht-smia.net/28.pdf>

Stephan Müller and Angela Mattli, Society for Threatened Peoples (STP). Të mbërthyer në rrethin e egër. Riatdhesimi dhe Migrimi i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve Ballkanikë nga Kosova. Studi Emigrazione, LIII, n. 204. Switzerland. 2016. f.647.: https://assets.gfbv.ch/downloads/se_204_mullermattli_trapped_in_a_vicious_circle.pdf

Pupovci, D, 2015, Të arriturat dhe sfidat e arsimit të lartë në Kosovë (kontribut për vlerësimin e Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016).

Banka Evropiane për Investime, 2016, Vlerësimi i Nevojave Financuese për NVM-të në vendet e Ballkanit Perëndimor: Raporti për Kosovën: http://www.eib.org/attachments/efs/assessment_of_financing_needs_of_smes_kosovo_en.pdf

Banka Botërore, 2011, World Development Report 2012: Gender Equality and Development: <https://doi.org/10.1596/978-0-8213-8810-5>

